بسم الله الرحمن الرحيم

**ME EMRIN E ALLAHUT**
**TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT**

FONDACIONI I KUR'ANIT
SHQIPËRI

# DRITA E KUR'ANIT

## REVISTË SHKENCORE E HULUMTIMEVE DHE E STUDIMEVE KUR'ANORE

# THE LIGHT OF QUR'AN

## SCIENTIFIC JOURNAL OF QUR'ANIC RESEARCHES AND STUDIES

TIRANË, 2015

**Drejtor:** H. Vullnet MERJA

**REDAKSIA:**

Prof. dr. Hajri SHEHU ***(kryeredaktor)***
Sabrie FEZA ***(zëvendëskryeredaktore)***

Prof. dr. Bedri BYLYKU ***(anëtar)***
Prof. dr. Feti MEHDIU ***(anëtar)***
H. Jetmir ÇELA ***(anëtar)***
H. Sulejman efendi REXHEPI ***(anëtar)***
H. Selim STAFA ***(anëtar)***

**Redaktore:** Liseda RAMAJ

**Korrektura teknike:** Vjollca KARAJ

**Përkthyesit:** Mentor ÇADRI, Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Fondacioni i Kur'anit

Del katër herë në vit.

Viti VIII, 2015, Nr. 4 (35)

Shtypur në Shqipëri, në shtypshkronjën "LILO"

**ISSN 2309-3668**

**Adresa e redaksisë:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com
E_mail: f_quran114@yahoo.com & quranfondation114@gmail.com

**Director:** Haji Vullnet MERJA

**EDITORIAL BOARD:**

| | |
|---|---|
| Prof. Dr. Hajri Shehu | **Editor-in-chief** |
| Sabrie FEZA | **Vice-Editor-in-chief** |
| | |
| Prof. Dr. Bedri BYLYKU | **Member** |
| Prof. Dr. Feti MEHDIU | **Member** |
| Haji Jetmir ÇELA | **Member** |
| Haji Sulejman ef. REXHEPI | **Member** |
| Haji Selim STAFA | **Member** |

**Editor:** Liseda RAMAJ
**Proofreader:** Vjollca KARAJ
**Translators:** Mentor ÇADRI,  Jetmir ÇELA, Bledar SHEHU

©: Foundation of Qur'an – Albania

A Quarterly Journal

Vol 4, issue 35, 2015

Printed in Albania by "LILO" Printing House

**ISSN 2309-3668**

**Address of the Editorial Board:**
Fondacioni i Kur'anit
Rruga "Hoxha Tahsin", Nr.168, Kutia Postare: 8272
Tel & Fax: 00355 4 2377311 Tirana – Albania
Website: www.fqurani.com
E_mail: f_quran114@yahoo.com &  quranfondation114@gmail.com

## PASQYRA E LËNDËS

**Selim Stafa**
HAZRETI MUHAMEDI- PROFETI I MBARË NJERËZIMIT...9
**Ahadollah Gholizadeh Barandagh**
DISA VIRTYTE TË PROFETIT MUHAMED............................20
**Vullnet Merja**
MESIHU - BIRI I MERJEMES NË KUR'AN..............................26
**Robin Scott**
BIBLA DHE KUR'ANI...................................................................37
ARGUMENTE PSE NUK ËSHTË KRYQËZUAR HAZRETI ISAI...40
**Abdu Daim Kahiil**
ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI X.....................46
**Qani Banaj**
PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ...................................................55
**Fatme Chehab**
VENDE, POPUJ, NJERËZ E NGJARJE QË PËRMENDEN NË KUR'AN: XHAMIA "EL AKSA"..........................................59
**Nasir Mekarim Shirazi**
DHJETË URDHËRESA - KOMENTIMI I AJETEVE 151-153, TË SURES "EN'AM"...........................................................................65
**Muhsin Keraeti**
TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN..................................................76
**Ali Muhamed Ali Duhajjil - Dehili**
HISTORI E PROFETËVE - Historia e profetit Musa dhe Harun...84
**Vullnet Merja**
FJALOR KUR'ANOR: **Ringjallja** *(El Ba'thu)*..................................96
15 VJET NË SHËRBIM TË KUR'ANIT.......................................106
VEPRIMTARI KUR'ANORE.........................................................115
VEPRIMTARI KUR'ANORE NDËRKOMBËTARE................120
PËRMBLEDHJET NË GJUHËN ANGLEZE..........................128
PËRMBLEDHJET NË GJUHËN ARABE.................................136

## TABLE OF CONTENTS

**Selim Stafa**
HAZRAT MUHAMMAD - Prophet of Humanity..........................9
**Ahadollah Gholizadeh Barandagh**
SOME VIRTUES OF PROPHET MUHAMMAD.......................20
**Vullnet Merja**
THE MESSIAH, SON OF MARYAM (MARY) IN THE QUR'AN....26
**Robin Scott**
THE BIBLE AND THE QUR'AN..................................................37
ARGUMENTS WHY HAZRAT ISA/JESUS WAS NOT CRUCIFIED.........................................................................40
**Abdu Daem Kaheel**
SCIENTIFIC ARGUMENTS FROM THE QUR'AN X...........46
**Qani Banaj**
THERE IS A REMEDY FOR EACH DISEASE..........................55
**Fatme Chehab**
PLACES, NATIONS, PEOPLE AND EVENTS MENTIONED IN THE QUR'AN: "Al-Aqsa" MOSQUE .....................................59
**Nasir Mekarim Shirazi**
TEN COMMANDMENTS...............................................................65
**Muhsin Keraeti**
TO FURTHER RECOGNIZE THE QUR'AN.............................76
**Ali Muhamed Ali Duhajjil - Dehili**
STORIES OF THE PROPHETS- Prophets Moses and Harun...84
**Vullnet Merja**
QUR'ANIC GLOSSARY: Resurrection.......................................196
15 YEARS SERVING TO THE QUR'AN..................................106
QUR'ANICACTIVITIES...............................................................115
INTERNATIONAL QUR'ANIC ACTIVITIES..........................120
SUMMARIES IN ENGLISH..........................................................128
SUMMARIES IN ARABIC............................................................136

# المحتويات


**الحاج سليم لصطافى**

حضرة محمد صل الله عليه و آله رسول البشرية........٩

**دكتور احد الله قلى زاده**

بعض من فضائل النبى (صل الله عليه و آله)........٢٠

**الحاج الشيخ ولنت مريا**

المسيح بن مريم فى القرآن........٢٦

**روبين سكوت**

تورات و القرآن........٣٧

الأدلة على عدم صلب عيسى عليه السلام........٤٠

**عبد الدائم الكحيل**

الادلة العلمية من القرآن........٤٦

**تشاني باناى**

لكل داء دواء........٥٥

**فاطمة شهاب**

الاماكن و الاقوام و الاحداث المذكورة فى القرآن المسجد الاقصى........٥٩

**ناصر مكارم الشيرازى**

الآوامر العشرة........٦٥

**محسن قرائتي**

نتعرف اكثر على القرآن- دروس من سورة البقرة........٧٦

**على محمد على الدحيل**

قصص الانبياء – النبى موسى و النبى هارون (عليهما السلام)........٨٤

**الحاج الشيخ وُلنَت مَريَا**

القاموس القرآنى – البعث........٩٦

١٥ سنة فى خدمة القرآن الكريم........١٠٦

نشاطات قرآنية........١١٥

نشاطات قرآنية العالمية........١٢٠

ملخص بالغة الانجليزية........١٢٨

ملخص بالغة العربية........١٣٦

**Selim Stafa**

# HAZRETI MUHAMEDI
## PROFETI I MBARË NJERËZIMIT

*(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*[1]

**Abstrakt**

*Profeti Muhamed, ky burrë i zgjedhur prej Allahut, do të ndriçonte mendjet e nxira nga padija e idhujtarisë, do ta lartësonte dhe do ta vinte personalitetin e njeriut në misionin që Allahu, me Mëshirën e Tij, ia ka caktuar ta kryejë në këtë botë - për të adhuruar Krijuesin Fuqiplotë dhe për të qenë sundues i denjë në Tokë. Prandaj të gjithë i jemi borxhlinj të Dërguarit të Allahut. Prandaj ditëlindja e të Dërguarit të Allahut, Profetit të Islamit, Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është ngjarje e rëndësishme në historinë e njerëzimit. Dhe duke përkujtuar ditëlindjen e tij, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse i bëjmë thirrje vetes që të njihemi sa më shumë me jetën e Profetit tonë. Dhe vetëm duke e njohur figurën e pastër të Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahtu qofshin mbi të!) dhe duke i vënë vetes detyrë të zbatojmë urdhrin e Allahut për ta pasur model në jetën tonë jetën e Profetit, do të bëhemi më njerëzorë dhe me lejen e Allahut, do të jemi myslimanë të vërtetë.*

Ditëlindja e të Dërguarit të Allahut, Profetit të Islamit, hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* është ngjarja më e rëndësishme në të gjithë historinë e njerëzimit. Me këtë burrë, i Madhi Zot derdhi mëshirën e

1 Me rastin e përvjetorit të ditëlindjes së Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, më 12 të muajit Rebij'ul-eu'uel.

Tij mbi të gjitha botët: **"Ty të kemi dërguar mëshirë për të gjitha botët."** (Surja "Enbija", ajeti 107.) Ky burrë i zgjedhur prej Allahut do të ndriçonte mendjet e nxira nga padija e idhujtarisë, do të lartësonte dhe do të vinte personalitetin e njeriut në misionin që Allahu, me Mëshirën e Tij i ka caktuar të kryejë në këtë botë: për të adhuruar Krijuesin Fuqiplotë dhe për të qenë sundues i denjë në Tokë. Profeti Muhamed erdhi në këtë jetë me datën 12 të muajit rebijul-eu'uel, ditën e hënë të vitit 571 të e.r. Biografët e të Dërguarit të Allahut, duke u bazuar në suren "El Fijl" dhe në hadithet e sakta profetike argumentojnë se i Dërguari i Allahut ka lindur në "Vitin e elefantit", 40 ditë pas asgjësimit të ushtrisë së "elefantit". Kjo ishte njëra nga ndodhitë e jashtëzakonshme që paraprinë lindjen e të Dërguarit të Allahut. Nga historia mësojmë se ajo ushtri ishte nisur me qëllim që të shembte Qabenë, faltoren e parë të ndërtuar mbi Tokë për të adhuruar Krijuesin. Komandanti mendjeprishur i "Ushtrisë së Elefantit", Ebrehe, ishte përgatitur ta zhdukte njëherë e përgjithmonë ritualin e Haxhit, që bëhej çdo vit në këtë Shtëpi të nderuar dhe që ekzistonte qysh nga koha e profetit Ibrahim *(Paqja qoftë mbi të!)*. Ka edhe shumë tregime të tjera të vërtetuara plotësisht që flasin edhe për ndodhi të tjera të jashtëzakonshme që paraprinë lindjen e hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*.

Në Kur'an ka shumë ajete që tregojnë se edhe disa nga profetët e mëparshëm, me urdhrin e Allahut kanë demostruar mrekulli të ndryshme. Për Allahun asgjë nuk është e pamundshme, ashtu siç njofton ajeti 82 i sures "Jasin": **"Kur Allahu dëshiron një send, Ai i thotë atij sendi 'Bëhu!' dhe sendi bëhet".** Në Kur'an tregohen disa nga mrekullitë, me të cilat erdhën profetët e mëdhenj, të tilla si hapja e detit për profetin Musa *(Paqja qoftë me të!)*, shndërrimi i shkopit të tij në gjarpër, dalja e burimit të ujit prej shkëmbit të fortë kur profeti

Musa *(Paqja qoftë me të!)* me urdhrin e Allahut goditi shkëmbin me shkopin e tij dhe pinë ujë benij israilët që u ndodhën në shkretëtirë, ngjallja e të vdekurit me urdhër të Allahut nga profeti Isa *(Paqja qoftë mbi të!)*, shërimi i të verbërve dhe i lebrozëve, zbritja e ushqimit të gatshëm për hazreti Merjemen, mbartja e fronit të mbretëreshës Belkis, zjarri me urdhrin e Allahut nuk e djeg hazreti Ibrahimin *(Paqja qoftë mbi të!)*, ngjarja e djemve besimtarë të shpellës, të cilët braktisën vendin e postet dhe u strehuan në shpellë për të ruajtur fenë e vërtetë, besimin në Zotin Një e të Vetëm etj. Kurse hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, përveç disa mrekullive të kësaj natyre, erdhi me mrekullinë më të madhe, me mrekullinë e papërsëritshme, erdhi me Kur'ani Kerimin, me Librin e fundit qiellor, që u flet dhe do t'u flasë breznive të njerëzimit me fjalën më të përsosur, më të bukur e më të kuptueshme për të Vërtetën më të madhe: **Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut.**

Edhe nëna e nderuar e të Dëguarit të Allahut, zonja e nderuar Emine tregon se ajo nuk i pati vështirësitë e barrës si të gjitha gratë. Ishte sigurisht e kuptueshme që ajo zonjë e nderuar të ishte e privilegjuar, sepse prej saj do të lindte udhëheqësi i mbarë njerëzimit. Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* vinte nga një familje e pastër, si nga e ëma, ashtu edhe nga i ati. Në lidhje me preadhjen e tij të pastër hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* ka thënë: *"Unë kam ardhur nga martesa me kurorë dhe jo nga lidhje jashtëmartesore, qysh nga Ademi (Paqja qoftë mbi të!)… dhe mua nuk më ka prekur asgjë nga ndyrësitë e kohës së injorancës para Islamit"*. I Dërguari i Allahut e ka përshkruar veten edhe me këto fjalë: **"Unë jam lutja e babait tim Ibrahimit, jam përgëzimi që dha Isai dhe ëndrra që pa nëna ime".** Imam Sujuti (Allahu e mëshiroftë!) shpjegon se të gjitha nënat e Profetëve të Allahut

kanë parë ëndrra në lidhje me ata që do të lindin prej tyre.

Ndodhitë e jashtëzakonëshme e kanë shoqëruar hazreti Muhamedin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* gjatë gjithë jetës së tij, të bekuar dhe të mbushur vetëm me mirësi. Është shumë kuptimplotë fakti i mirësive të shumta që pa dhe që gëzoi familja e Halimesë, qysh nga çasti kur e mori këtë fëmijë jetim dhe të varfër. Ajo nuk mund të pretendonte të kishte përfitme për rritjen e tij në mjediset e fshatit. Për këto mirësi të shumta që pati, Halimeja tregon: Sapo e mora në prehër, gomari im, i dobët nga ushqimi i paktë, i parakaloi kafshët e shëndosha të shoqeve të mia që kishin zbritur në qytet dhe që kishin marrë udhën e kthimit shumë kohë përpara meje. Edhe bashkëshorti i Halimesë u habit kur nga deveja e tij e vjetër, që nuk kishte asnjë pikë qumësht, mori aq qumësht sa u ngopën të gjithë pjesëtarët e familjes. Sipas jetëshkrimit të Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, të shkruar nga Ibni Hishami, Halimeja tregon: "Sapo e vura në prehër këtë fëmijë, ndjeva se në gjoksin tim më vërshoi qumështi me shumicë, aq sa u ngop ai dhe vëllai i tij prej qumështi. Të dy fëmijët i zuri gjumi dhe bashkë me ta fjeta edhe unë me bashkëshortin tim, pasi kishim disa ditë që nuk flinim nga të qarat e fëmijës tonë të vogël, të cilin nuk e zinte gjumi nga uria". Nga mirësitë që po shikonte me ardhjen e kësaj fëmije të uruar në shtëpinë e tij, bashkëshorti i Halimesë i tha asaj: "Dije mirë o Halime dhe të betohem në Zotin se ti ke marrë një njeri të bekuar. Të betohem edhe një herë në Zotin se me këtë fëmijë unë shpresoj mirësi të mëdha e të shumta"[2].

Pasi ndërroi jetë gjyshi i tij i nderuar dhe më vonë, pas vdekjes së nënës së tij, Muhamedi u rrit nën kujdesin e xhaxhait të tij të dashur, Ebu Talibit. Edhe pse ishte në gjendje të keqe ekonomike dhe i përballonte me vështirësi nevojat e familjes

2 Siretu ibn Hisham.

së tij madhe, për nipin e tij Muhamedin, të cilin e kishte marrë amanet prej gjyshit të Profetit - Abdul-Mut'talibit, ai gjithmonë ndante për të ushqimin më të mirë, veshjen më të përshtatshme dhe gjithnjë e mbante pranë vetes, madje edhe në kuvendet që kryesonte, si prijës i fiseve të Mekës. Janë të shumta rastet kur kanë ardhur mirësitë nga prania e hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*. Ibni Asakiri, në librin e tij për jetëshkrimit e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tregon: "Në një vit thatësire të madhe, kurejshët nuk po vendosnin se cilit idhull t'i drejtoheshin që të luteshin për të rënë shi dhe iu drejtuan Ebu Talibit, i cili iu përgjegj ftesës së tyre. Kur u nis për të shkuar në Qabe bashkë me të tjerët, mori me vete edhe djaloshin Muhamed. Ebu Talibi e mbështeti nipin e tij me shpinë në murin e Qabes. Ndërkaq, djali ngriti gishtin në drejtim të qiellit, ku nuk shihej asnjë re. Përnjeherësh filluan të mblidheshin retë aty-këtu dhe nuk vonoi të binte shi i mjaftueshëm për të shtuar pjellorinë e luginës dhe barin e kullotave për bagëtinë. I Dërguari i Allahut, hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, qysh në moshë shumë të re, asnjëherë nuk iu qas idhujve, asnjeherë nuk i pëlqeu konkurset e vjershërimit që organizoheshin në kohën e injorancës, përpara Islamit. Në konkurse, vjershëtorë të dëgjuar u thurrnin lavde idhujve dhe krerëve të fiseve me poezitë e tyre. Ai asnjëherë nuk shfaqi interes për veprimet e kohës së injorancës që bënin bashkëqytetarët e tij. Ai kurrë nuk hëngri nga mishërat që idhujtarët bënin fli për idhujt. Ai kurrë nuk vuri në gojë pije alkoolike - aq shumë të përhapura në mesin e popullit të tij. Ai kurrë nuk u bë pre e epsheve e nuk u njollos me llumin e veseve të ulëta - aq të zakonshme në mjedisin që e rrethonte. Këto nuk mund të ndodhnin në personin e hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, sepse ai e kishte edukatën dhe moralin të pastër, të dhuruar prej Allahut dhe do të përgatitej për të qenë mbajtësi

i Mesazhit të fundit e më të plotësuar që Allahu me mëshirën e Vet do të shpallte nëpërmjet tij për të gjitha botët. Edukata e tij e veçantë, cilësitë e tij të bukura dhe pajisja e tij me vetitë morale më të plotësuara - të gjitha këto bënë që ai djalë i ri të fitonte një respekt të veçantë dhe të gëzonte dashamirësinë e të gjithë bashkëqytetarëve të vet. Ata shikonin tek ai djalë vetëm mirësinë dhe begatinë. Jetëshkruesit e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tregojnë se ai edhe përpara se të ngarkohej me detyrën e Shpalljes së Allahut, kur ishte adoleshent dhe kulloste bagëtinë e të tjerëve; gjithmonë ka qëndruar larg të gjitha veseve dhe mëkateve. Sepse ai përgatitej, me urdhrin e Allahut për të qenë modeli i vetëm që duhej të ndiqej në të gjitha veprimet që bënte e në të gjitha fjalët që nxirrte nga goja e tij e bekuar.

Ishin të shumtë burrat e shquar bashkëkohës që vlerësonin vetitë e rralla e të çmuara që shihnin tek ai djalë i ri. Ata e thërrisnin me nderim "Muhamedi Besnik" (Muhamed el Emin), sepse të gjithë ishin të bindur dhe të sigurt se Muhamedi ishte i vetmi person tek i cili mund të linin për ruajte edhe sendet më të çmuara që kishin. Është e mjaftueshme të ilustrohet ky respekt e vlerësim që gëzonte hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* me fjalët që i tha xhaxhai i tij, Ebu Talibi zonjës së nderuar Hatixhe ditën e fejesës së saj me atë, që më vonë do të ishte Profeti i fundit i Allahut. Zonja Hatixhe e kishte provuar ndershmërinë e atij djali fisnik me pasurinë e saj, por ajo u gëzua edhe më shumë kur i dëgjoi ato fjalë, me të cilat Ebu Talibi ia përshkroi nipin e vet: "Pastaj, duhet të dish se me këtë djalin e vëllait tim, Muhamedin, nuk mund të barazohet asnjë burrë, as nga ndershmëria, as nga bujaria dhe as nga virtyti, edhe pse ai ka pak pasuri. Por dihet se pasuria edhe mund të pakësohet, ose edhe mund të mbetesh fare pa pasuri." Pas pak shtoi: "Betohem në Zotin se me këtë

djalë do të ndodhë diçka shumë e rëndësishme dhe e paparë ndonjëherë.”.

Urtësia, maturia dhe gjykimi i drejtë i të Dërguarit të Allahut, kur ishte ende djalë i ri, shfaqeshin në çdo punë që ai bënte, në çdo fjalë që thoshte dhe në çdo mendim, që i kërkohej të jepte. Por gjatë gjithë jetës së tij, ai kurrë nuk ua ka imponuar të tjerëve mendimet e veta për çështje që kishin të bënin me interesa të kësaj bote. Të gjithë bashkëqytetarët e tij kishin një bindje mbushamendëse se nuk mund të arrinin mendim më të arsyeshëm sesa ai që do të jepte Muhamed Besniku dhe kurrë nuk do të merrnin vendim më të drejtë e më të pranueshëm pa gjykimin që do të jepte Muhamedi.

Qysh përpara se të ngarkohej me detyrën e profetësisë, hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* në asnjë rast nuk ka qëndruar larg problemeve shoqërore; por gjithmonë ka qenë pjesëmarrës aktiv në zgjidhjen e të gjitha problemeve shoqërore dhe sa herë që i kërkohej mendim për zgjidhjen e ndonjë problemi tepër të vështirë që i dilte përpara shoqërisë së kohës së tij, gjithmonë mendimi i tij merrej në konsideratë dhe zgjidhja realizohej ashtu siç kishte sugjeruar Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*. Është më se e mjaftueshme të përmendet urtësia, me të cilën Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* e zgjidhi problemin e vendosjes së **Gurit të Zi** në murin e Qabes. Falë urtësisë e maturisë së tij, u shmang një gjakderdhje e sigurt në mes fiseve.

Vlerat dhe virtytet e të Dërguarit të Allahut, Profetit tonë, hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* nuk ishin të panjohura as për rabinët çifutë dhe as për prift-ërijtë e krishterë, sepse Librat e tyre të shenjtë - Teurati dhe Ungjilli, i përshkruajnë qartë cilësitë e të Dërguarit të fundit. Nga shenjat që shikonin ata, e kuptonin se ishte afruar koha

për ardhjen e Profetit të pritshëm. Ata filluan të flisnin për cilësitë e Profetit që pritej të vinte. Dhe, pavarësisht nga shtrembërimet që ata kanë bërë në librat e tyre gjatë shekujve, asnjëherë nuk kanë mundur ta fshijnë plotësisht shpalljen për ardhjen e këtij Profeti.

Po afrohej koha kur i Dërguari i Allahut do të merrte Shpalljen e parë. Gjendja e tij shpirtërore e nxiste të përgatitej për ta përballuar plotësimin e asaj detyre të rëndë e të veçantë, detyrë, e cila do të kërkonte sakrifica të mëdha. Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* nuk ndiente qetësi në atë mjedis idhujtarie. Zemra e tij vuante kur shikonte se injoranca kishte pllakosur mendjet dhe shpirtërat e popullit të tij. Ai vuante me tërë qënien e vet, kur vërente padrejtësitë që u bëheshin të pafuqishmëve e të varfërve dhe gjithnjë u dilte krah atyre, i mbronte dhe i ndihmonte me sa kishte mundësi. Në këtë gjendje vuajtjesh të brendshme për popullin e tij, hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* largohej nga shtëpia dhe mbyllej në shpellën e malit Hira, e vazhdimisht meditonte. Dhe ja, në një çast meditimi i shfaqet meleku Xhibril dhe e urdhëron: **"Lexo! Me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Ai e krijoi njeriun prej një cope gjaku të mpiksur. Lexo me emrin e Zotit tënd që është më bujari, i Cili e mësoi njeriu të shkruajë me laps".** (Surja "El Alek", ajetet 1-5).

I Dërguari i Allahut i përgjigjet Xhibrilit se nuk dinte të lexonte. Pasi e rimerr veten nga tronditja e ballafaqimit të parë me melekun e dërguar nga Allahu, ashtu, siç ishte, kthehet në shtëpi dhe i thotë zonjës Hatixhe: "Mbulomë sa më parë!" Por, edhe ashtu i mbuluar, dëgjon përsëri zërin e Xhibrilit t'i thoshte: **"O ti që je i mbuluar! Ngrihu dhe paralajmëro! Dhe Zotin tënd madhëroje!..."** (Sure "El Mudeth'thir",

ajetet 1-3). Urdhri për të shpallur Thirrjen erdhi dhe Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* pa u vonuar fton në Teuhid njeriun që ka më pranë, bashkëshorten e tij të nderuar, zonjën Hatixhe. Ajo, pa nguruar beson në thirrjen që i bëhet dhe vë në dispozicion të kësaj thirrjeje tërë pasurinë saj që ka trashëguar dhe që e ka shtuar me anë të tregtisë. Kështu, zonja Hatixhe është myslimani i parë që iu përgjigj thirrjes së Profetit të Allahut për të besuar me zemër dhe për të pohuar me gojë pa asnjë lloj imponimi frazën që e regjistron njeriun në librin e atyre që besojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut: "Là ilàhe il'le-ll'llàh, Muham'medun resùlu-ll'llàh". **"Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguar i Allahut".** Thirrjen e të Dërguarit të Allahut e pranojnë shoku i ngushtë i Profetit, Ebu Bekri, imam Aliu e kështu me radhë, të gjithë sahabët e nderuar.

Qysh nga fillimet e Thirrjes dhe deri në fund të zbritjes së Kur'ani Kerimit, jeta e hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* është modeli i përsosur, që duhet të ndiqet nga të gjithë. Në personin e tij të bekuar, myslimani gjen devotshmërinë, bindjen e thellë në rrugën e Allahut, kryerjen e adhurimeve me përkushtim, modelin e mësuesit të palodhur, të babait të dashur e të dhembshur, kryefamiljarin që punon pa u lodhur për mbajtjen e familjes dhe për edukimin e të gjithë pjesëtarve të saj me normat e moralit të pastër islam, udhëheqësin shpirtëror, që u mëson me durim të gjithëve besimin e vërtetë dhe edukatën e lartë islame, udhëheqësin që mendon ditë e natë për të mirën e popullit. Në personin e tij të bekuar, myslimani gjen komandantin e urtë e trim, që qëndron në vijën e parë të betejës – komandantin, të cilin askush nuk e dallonte dot nga ushtari i thjeshtë, gjen trimin e paepur që lufton me besim të plotë për triumfin e së vërtetës e të drejtësisë, gjykatësin

më të drejtë në zbatimin e ligjit, që nuk nguron të zbatojë ligjin deri në një edhe kur në gjykim është njeriu më i dashur për të. Në personin e tij të bekuar, myslimani gjen adminstratorin më nikoqir dhe qeveritarin më të gatshëm për të qenë sa më afër shqetësimeve të popullit të thjeshtë, nëpunësin më të palodhur të shtetit, i cili e kryen detyrën shoqërore me përkushtim, me përgjegjësi dhe në përputje të plotë me ligjin e me logjikën. Në personin e tij të bekuar, myslimani gjen njeriun e fundit në pretendime dhe të parin në sakrifica, njeriun më të përkorë në jetë, shokun e udhëtimit, kolegun dhe shokun e betejës më të gatshëm për të ndihmuar të tjerët. Në personin e hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* gjejmë burrin që më parë shikon shokun, bashkëluftëtarin, bashkëpuntorin e bashkudhëtarin dhe pastaj veten, ose e thënë ndryshe, njeriun e vërtetë, njeriun e plotësuar, për të cilin ka ardhur Islami, myslimanin e vërtetë, i cili kurrë dhe në asnjë rast e për asnjë interes vetjak nuk i ndan fjalët nga veprat. Ai është hazreti Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* modeli i përsosurisë njerëzore, i qytetarit të nderuar që mbron vetëm të vërtetën. Ai është qytetari që bën vetëm të mirën, urdhëron vetëm të mirën dhe ndalon të ligën e të dëmshmen. Ai është qytetari i devotshëm, që nuk nguron të ndalojë të keqen me dorën e me fjalën e tij, pa marrë parsysh se mund ta pësojë. Te Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* gjen qytetarin e ndershëm e të drejtë që punon dhe kujdeset të vjelë frytet e punës së tij vetëm me rrugë të ndershme e ligjore, myslimanin e devotshëm që nuk merr nga të mirat e kësaj bote më shumë sesa ka nevojë. Në personin e tij të uruar gjen myslimanin e vërtetë besimtar që shpenzon vetëm në rrugën, që ka urdhëruar Allahu të shpenzohet dhe për bamirësi. Në personin e nderuar të Profetit tonë *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* gjen myslimanin që mbështetet vetëm në Allahun, myslimanin e vetëdijshëm, i cili gjithmonë mban parasysh se të ardhmen e

ka vetëm tek Allahu. Hazreti Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjithmonë ka zbatuar urtësinë e urdhëruar në Kur'an për të ndihmuar të varfrit, jetimët, të pafuqishmit dhe ata që janë në fatkeqësi. Në personin e tij të uruar gjen besimtarin e dashur e njeriun e mëshirshëm, gjen besimtarin e përulur, që nuk mund të ndihet i qetësuar në shtëpinë e tij pa menduar më parë për nevojat e fqinjit e të të afërmit të tij, gjen modelin e atij besimtari që nuk shtrihet të flerë pa e pyetur veten nëse i ka plotësuar detyrat e ditës ndaj Krijuesit, ndaj familjes, ndaj bashkëqytetarëve dhe ndaj vendit të tij.

Të gjithë janë borxhlij ndaj të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*. Duke përkujtuar ditëlindjen e tij, nuk bëjmë gjë tjetër, veçse i bëjmë thirrje vetes që të njihemi sa më mirë me jetën e Profetit tonë. Vetëm duke njohur figurën e pastër dhe të uruar të hazreti Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* dhe duke i vënë vetes detyrë të zbatojmë urdhrin e Allahut për të pasur model në jetën tonë vetëm jetën e Profetit tonë, të bëhemi më njerëzorë dhe me lejen e Allahut, myslimanë të vërtetë - njerëz të bindur me vetëdije për të kaluar jetën në përputhje me urdhrat e Kur'ani Kerimit dhe sipas porosive të Dërguarit të Tij. Përkujtimi i ditëlindjes së të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* ka shërbyer e shërben jo vetëm për të njohur sa më shumë detaje nga jeta e Profetit tonë, por edhe që të na rrënjoset thellë në zemrat tona dashuria e veçantë për hazreti Muhamedin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* dhe për të zbatuar urdhrin e Allahut për të kënduar "salavatin sherif" sa herë që përmendim a dëgjojmë emrin e të Dërguarit të Allahut.

**Ahadollah Gholizadeh Barandagh**

# DISA VIRTYTE TË PROFETIT MUHAMED

*(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*

**Abstrakt**

*Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), edhe pse në prag të vdekjes, tha fjalë madhështore. Fjalët e tij janë madhështore për të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes. Në vazhdim të fjalëve të tij, Profeti i Islamit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Gjithnjë ta kujtoni Allahun dhe mos lejoni që prapa dyerve të pushtetit tuaj të fuqishmit të shtypin të dobëtit dhe mos lejoni që të pasurit të nëpërkëmbin të varfrit." Më tej, Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Shoqëria ku shkelen të drejtat e të dobtëve dhe të të varfërve përballë të fuqishmëve dhe të pasurve, nuk është islame." Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) përpiqej të krijonte një shoqëri fetare, ku kjo botë të ishte në shërbim të Botës Tjetër.*

## Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, ishte shumë i sëmurë dhe shumë afër vdekjes. Si gjithnjë, ai tha fjalë madhështore. Janë madhështore për të drejtat e njeriut dhe lirinë e shprehjes, të cilat sot perëndimorët po mundohen të na i mësojnë. Në hytben e lamtumirës me popullin, ai tha:

*"Kujtdo, që i kam hyrë në hak, sot le ta thotë dhe të shlyhemi, të më falë, të më gjykojë ose ta shtyjë gjykimin deri në Ditën e Gjykimit!"* Në mesin e njerëzve që ishin të pranishëm, u ngrit një njeri dhe tha: *"Një herë deshët të godisnit devenë tuaj. Por duke e goditur atë kamxhiku më ciku mua dhe për këtë tani dua t'ju gjykoj."* Dhe Pejgamberi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, i cili ishte në kulmin e fuqisë dhe të pushtetit, u shpreh i gatshëm që të dënohej me po atë kamxhik. Në atë çast, u ngritën Hasani dhe Hysejni dhe kërkuan nga njeriu që në vend të gjyshit të tyre, ta vuanin dënimin ata. Por njeriu nuk pranoi dhe Pejgamberi u paraqit për të vuajtur dënimin. Njeriu tha: *"Kur më keni goditur mua, isha i zhveshur dhe tani ju duhet ta zhvishni krahërorin me qëllim që drejtësia të shkojë në vendin e duhur."* Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* veproi ashtu siç i tha njeriu. Të pranishmit e tjerë filluan të qanin. Njeriu jo që nuk e goditi të Dërguarin e Allahut, por e puthi krahërorin e tij të zhveshur.

Në vazhdim të fjalëve të tij, Profeti i Islamit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tha: *"Gjithnjë ta kujtoni Allahun dhe mos lejoni që prapa dyerve të pushtetit tuaj të fuqishmit të shtypin të dobëtit dhe mos lejoni që të pasurit të nëpërkëmbin të varfrit."*. Më tej Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tha: *"Shoqëria ku shkelen të drejtat e të dobtëve dhe të varfërve përballë të fuqishmeve dhe të pasurve, nuk është islame."*

Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* përpiqej të krijonte një shoqëri fetare, ku kjo botë të jetë në shërbim të Botës Tjetër dhe afrimi me Allahun të mos jetë në kundërshtim me punët e tjera të shoqërisë, si martesa, ekonomia, etj. dhe çdo gjë të kryhet për Allahun e të bëhet shkak për afrimin me Allahun. Shoqëria ideale që e kërkonte i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* nuk gjendet; ajo krijohet dhe për krijimin e saj duhet të mundohemi të gjithë së bashku.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* thoshte

se myslimani është vëlla i myslimanit dhe nuk duhet ta braktisin njëri-tjetrin. Myslimanët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin në ekonomi, në kulturë dhe në çdo aspekt tjetër.

Në qeverisjen e tij, Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* nuk kishte parti dhe klasa politike. Në mesin e gjithë atyre njerëzve dhe pleqve që ishin rreth tij, në krye të ushtrisë së tij vendosi komandant një nëntëmbëdhjetëvjeçar, të quajtur Usama. E ky Usama udhëhoqi ushtrinë islame kundër Perandorisë Romake. Edhe, kur e çliroi Mekën vendosi në krye të saj një të ri njëzetvjeçar, të quajtur Attab Bin Esid.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* kujdesej për të varfrit dhe theksonte se çdokush që fle i ngopur derisa fqinji i tij është i uritur, nuk është prej nesh dhe nuk ka besuar në Ditën e Kiametit.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* vazhdimisht kërkonte që ta njoftonin për zërin e atyre, të cilët nuk mund të arrinin deri tek ai dhe të njihej me gjendjen e tyre. Dhe thoshte se çdo njeri, që gjendej pranë njerëzve të tjerë, kur kanë probleme dhe shqetësime, për të ishte i respektuar dhe i dashur.

Ai thoshte hani, por jo vetëm. Në logjikën e tij nuk ekzistonte parimi që në njërën anë të qytetit një njeri ta kishte shtëpinë disakatëshe e në anën tjetër, dikush të mos kishte shtëpi. Ai kishte respekt të madh sidomos për ata që punonin punë të rënda. Por, ai kritikonte gjithashtu edhe ata të varfër që nuk bënin as përpjekjen më të vogël për të punuar. Pra, ai ishte kundër përtacisë dhe pohonte se individi që nuk punon për t'i shërbyer shoqërisë dhe që përfiton nga të mirat e shoqërisë, është i mallkuar.

Një herë, kur po ktheheshin nga lufta e Tebukut, njerëzit kishin dalë për t'i pritur Profetin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* dhe ushtrinë e tij. Në mesin e tyre i Dërguari i

Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* pa një plak me duart të rrudhura. E pyeti pse i kishte duart aq të forta dhe të rrudhura. Plaku ia ktheu: *"O i Dërguar i Allahut, unë me këto duar ushqej familjen time."* Atëherë, njeriu më i fuqishëm, pra Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, para të gjithëve ia puthi duart plakut dhe tha se betohej në Allahun se ato duar nuk do t'i digjte zjarri i Xhehenemit.

Muhamedi *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* ishte profet i mëshirës. Në kohën kur çliroi Meken, dëgjoi se disa nga shokët e tij flisnin për hakmarrje ndaj mekasve. Megjithëse për 13 vjet me radhë kishte qenë objekt i dhunës dhe i keqtrajtimeve të mekasve, i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tha: *"Sot nuk është dita e hakmarrjes, por është dita e mëshirës."* Në këtë mënyrë, ai i fali të gjithë armiqtë e tij. Sigurisht që keni dëgjuar për tregimin e atij çifutit. Sa herë që i Dërguari i Zotit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* kalonte pranë shtëpisë së çifutit, ai ia derdhte mbi kokë koshin e plehrave. Një ditë prej ditëve, Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* kaloi pranë shtëpisë së tij dhe pa se çifuti nuk ia hodhi lëmishtet mbi kokë dhe pyeti *"Ku qenka ky miku ynë sot?"* I thanë se ishte i sëmurë. Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* tha *"Duhet të shkojmë për vizitë tek ai."* Çifuti, me të dëgjuar ardhjen e Profetit, nga turpi e futi kokën nën batanije. Pas largimit të Profetit, pranoi fenë islame.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* kishte sjellje shumë të mira me gratë dhe thoshte: *"Më i mirë nga ju është ai, që sillet mirë me gruan e tij."*

Megjithë këtë mëshirë dhe modesti, Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* ishte shumë i vendosur, edhe kur ishte fjala për vlerat a për ndonjë veprim antivlerë. Për të nuk ishte me rëndësi se kush qëndronte përballë tij. Prandaj gjithnjë merrte anën e vlerave dhe ishte shumë i prerë ndaj sjelljeve që krijonin antivlera. Kur një grup njerëzish i thanë

se ishin të gatshëm të besonin në të, por me kusht që të mos e falnin namazin, ai nuk i pranoi ata, megjithëse në atë kohë kishte nevojë shumë të madhe për njerëz. Kur një grua nga një fis tjetër bëri një gabim dhe shkeli ligjin, e dënoi pa ngurruar fare ndaj reagimeve të fisit të saj. Disa nga shokët i thanë se nëse e dënonte atë grua, do të reagonte fisi i saj, i cili i kishte ndihmuar deri atëherë dhe propozuan që të mos e dënonin. Por ai nuk pranoi dhe i pyeti shokët e tij: *"Sikur një gabim të tillë ta kishte bërë një njeri i varfër, a thua do të më kishit bërë propozime të tilla?"* Për të nuk dallonte i pasuri nga i varfri dhe ligjet e Allahut i zbatonte në mënyrë të prerë.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* qe i vendosur dhe qëndrestar. Nga uria në bark pati vënë një gur dhe në këtë gjendje punonte për përgatitjen e luftës në Hendek. Gjatë punës, kazma i hasi në një gur dhe guri shkrepi një xixë. Ai tha: *"Fitoren ndaj Persisë dhe Romës e shoh në shkrepjen e kësaj xixe."* Disa nga ata që qenë aty, filluan të qeshnin dhe thanë: *"Njeriu, i cili nga uria ka vënë gurë në bark, synon fitoren ndaj Persisë dhe Romës!"* Në ato çaste u shkroi letër mbretërve të Persisë dhe të Romës dhe i ftoi ata të pranonin Islamin dhe nuk u tha ejani të dialogojmë dhe të shohim se cili nga ne e ka mirë e cili është gabim. Në mënyrë të prerë u shkroi atyre: *"Pranoje Islamin, që të jeshë i sigurtë. Nëse reziston, atëherë përgjegjësia e njerëzve mbetet mbi supet tuaja"*. Pra, edhe kushtet e vështira të rrethimit nuk e penguan atë që të tregonte as tolerancën më të vogël ndaj armiqve të tij.

Ajo që kishte rëndësi për të, ishte zbatimi i urdhrave të Allahut dhe theksonte se përballë asaj që ishte duke bërë, nuk kërkonte asgjë nga populli dhe nuk ishte në kërkim të përkrahësve dhe të ithtarëve. Kur i vdiq djali, Ibrahimi, ndodhi eklipsi i Diellit. Disa filluan të thoshin se një gjë e tillë ka ndodhur për shkak të pikëllimit të Profeti për djalin e tij. Por ai doli kundër një gjëje të tillë dhe megjithëse mund të ishte

në interes të tij, nuk e pranoi dhe tha se eklipsi i Diellit nuk kishte të bënte me pikëllimin e tij. I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* theksoi se eklipsi i Diellit ishte punë e Allahut dhe sa herë të ndodhë një gjë e tillë, duhet të falim namazin e dukurive të frikshme (salatul ajat) dhe t'i lutemi Allahut.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* kishte respekt të madh për njerëzit. Shokët e tij thoshin se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* i dëgjonte fjalët tona me aq seriozitet dhe kujdes, sa që ne mendonim se ai nuk dinte asgjë dhe po mësonte nga fjalët tona.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)* ka folur për çdo gjë që sjell lumturinë e njerëzimit, duke filluar nga martesa, shkurorëzimi, çështjet sociale, moralin, edukatën, ekonominë, luftën e deri për mënyrën e shkuarjes në tualet. A e dini pse? Sepse për të ishte e rëndësishme çdo nevojë e njerëzimit. Ai ishte dërguar për ne. Ai nuk ishte dërguar të na i shtonte detyrimet dhe përgjegjësitë tona, por për të na mësuar për mënyrën dhe metodën e të jetuarit. Megjithatë vendimi final është për ne, që ta pranojmë ose jo këtë mënyrë jetese. Nuk duhet të harrojmë se ai nuk ka nevojë aspak për ne, por jemi ne ata që kemi shumë nevojë për të.

**Vullnet Merja**

# MESIHU
# BIRI I MERJEMES NË KUR'AN

**Abstrakt**

*Një prej të dërguarve e profetëve të mëdhenj të Allahut është edhe Isai, biri i Merjemes (Paqja qoftë mbi të dhe mbi nënën e tij!). Në Kur'an, emri i hazreti Isait përmendet 25 herë. Allahu i Plotfuqishëm e krijoi profetin Isa pa baba. Në Kur'an thuhet:* **"***(Kujto)* **kur melekët thanë: 'O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një** *(djalë që do të lindë me një)* **Fjalë prej Tij. Emrin do ta ketë Mesih - Isai, biri i Merjemes do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në Botën Tjetër dhe një nga të afërmit e Allahut. Ai do t'u flasë njerëzve qysh i vogël në djep, edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.'"** *Mrekullitë janë treguesi më i mirë i qenies së Isait (Paqja qoftë mbi të!) profet. Mrekullitë ishin: ringjallja e të vdekurve dhe shërimi i të verbërve, sigurisht me lejen e Allahut. Por, Kur'ani dëshmon dhe vërteton se Mesihu ishte njeri si të gjithë njerëzit e tjerë. U krijua në barkun e së ëmës. Kaloi fazën e embrionit në mitër dhe lindi nga barku i Merjemes (Paqja qoftë mbi të!).*

Islami na mëson të besojmë në të gjithë profetët e Allahut. Myslimanët besojnë në të gjithë të dërguarit e profetët e Allahut. Sipas Kur'anit të Shenjtë, ata nuk bëjnë dallim mes të dërguarve dhe profetëve: **"...Të gjithë besojnë në Allahun,**

**melekët e Tij, librat e Tij dhe të dërguarit e Tij** (duke thënë)**: 'Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të dërguarve të Tij...'"**[1]

Një prej të dërguarve e profetëve të mëdhenj të Allahut është edhe Isai, biri i Merjemes (Paqja qoftë mbi atë dhe nënën e tij!). Ai është një prej të dërguarve të Vendosmërisë së Lartë (Ulul Azmi). Kush ka qenë ky i dërguar e profet i madh? Këtë do ta parqesim duke përmendur ajete nga Kur'ani i Shenjtë, Libri epokbërës, të cilin Allahu e zbriti për mbarë njerëzimin dhe me të cilin e përmbylli zbritjen e librave qiellorë.

Në Kur'anin e Shenjtë emri i hazreti Isait përmendet 25 herë. Allahu i Madhëruar ka caktuar që njeriu të lindë nga babai dhe nëna. Por kjo nuk do të thotë që Allahu i Plotfuqishëm nuk mund ta krijojë një njeri pa baba, apo pa nënë, apo pa praninë e asnjërit prej tyre. Ai e krijoi babanë e njerëzimit, hazreti Ademin *(Paqja qoftë mbi të!)* pa baba e pa nënë. Allahu e krijoi profetin Isai pa baba. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"**(Kujto) **kur melekët thanë: 'O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një** (djalë që do të lindë me një) **Fjalë prej Tij. Emrin do ta ketë Mesih - Isai, biri i Merjemes do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në Botën Tjetër dhe një nga të afërmit e Allahut. Ai do t'u flasë njerëzve qysh i vogël në djep, edhe si njeri i rritur dhe do të jetë nga më të mirët.'"**[2]

Melekët e përgëzuan Merjemen se Allahu do t'i dhuronte asaj një fëmijë dhe ai nuk do të ishte si gjithë të tjerët. Ai nuk do të ishte si gjithë të tjerët sepse do të ishte i mbushur me dhunti të larta, do të ishte shumë i zgjuar e punëmirë dhe do të kishte pozitë të lartë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Kur dëgjoi përgëzimin e melekëve, Merjemja e bekuar tha: **"Zoti im! Qysh do të kem unë fëmijë, kur nuk më ka**

1 Sure "Bekare", ajeti 285.
2 Sure "Ali Imran", ajetet 45 - 46.

**prekur askush…?!"**[3] Asaj i erdhi përgjigjja: Ky është vendim i Allahut të Plotfuqishëm dhe kur Ai dëshiron diçka, vetëm i thotë "bëhu" dhe ajo bëhet: **"Kështu – tha** (meleku) **- Allahu krijon ç'të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të: 'Bëhu!' - dhe ajo bëhet."**[4]

Në atë kohë në mesin e bijëve të Izraelit pritej një djalë që do të ishte i dërguar tek ata pas profetit Musa *(Paqja qoftë mbi të!)*.

Në ato momente Merjemja *(Paqja qoftë mbi të)* u shqetësua sepse e dinte qëndrimin e popullit të saj. Ata do ta akuzonin me akuzat më të poshtra. Në krye të të cilave ishte imoraliteti. Por, ndërkohë ajo është modeli i pastërisë dhe i ndershmërisë. Ajo mendonte se si do ta shfajsonte veten kur ta shihnin me fëmijë në krahë. Mirëpo Allahu i Madhëruar i tregoi asaj rrugën e shpëtimit. Dhe ajo rrugë ishte heshtja. Pra, ajo nuk duhej të fliste asnjë fjalë. Në Kur'anin e Shenjtë thuhet: **"…Nëse vëren ndonjë njeri, i thuaj: 'Unë jam betuar në të Gjithëmëshirshmin se do të agjëroj, prandaj sot nuk do të flas me askënd.'"**[5] Ajo nuk do të fliste sepse mbrojtësi i saj do të ishte ai djalë i sapolindur. Ai do të fliste dhe do ta mbronte pastërtinë dhe ndershmërinë e së ëmës. Kjo është mrekullia nga Allahu, për të vërtetuar se ky fëmijë nuk ishte i zakonshëm. Ai ishte mrekullia e Krijuesit të Plotfuqishëm.

Ajo që shqiptoi hazreti i Isai (Mesihu) i poraslindur nuk ishte vetëm mbrojtje për nënën e tij. Ishte edhe përgëzimi për atë që prisnin bijtë e Izraelit: ai ishte i dërguari i Allahut. Në Kur'an lexojmë: "**Ajo bëri me shenjë nga i biri. Ata thanë: 'Si t'i flasim ne fëmijës që është në djep?!' Ai** (Isai në djep) **tha: 'Unë jam rob i Allahut'. Ai më ka dhënë Librin** (Ungjillin)**, më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar**

3 Sure "Ali Imran", ajeti 47.
4 Sure "Ali Imran", ajeti 47.
5 Sure "Merjem", ajeti 26.

**kudo që të jem. Ai më ka porositur që të falem e të jap zekat sa të jem gjallë dhe që të jem i mirë ndaj nënës sime dhe nuk më ka bërë të ashpër dhe të padëgjueshëm. Le të jetë paqja e shpëtimi mbi mua, ditën që kam lindur, ditën që do të vdes dhe ditën që do të ringjallem!"**[6]

Lind pyetja: A ka qenë Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* profet që në lindjen e tij apo me thënien e tij **"më ka bërë profet"** donte t'i bënte me dije për të ardhmen? Në pamje të parë të ajetit duket se Isai (Mesihu) ishte profet, kur foli në djep. E kanë pyetur imam Sadikun *(Paqja qoftë mbi të!)*: *"A ka qenë argument për njerëzit e kohës së tij fjala e Isait, birit të Merjemes në djep?"* Imami është përgjigjur: "*Atë ditë ai ka qenë profet dhe argument i Allahut. A nuk e ke dëgjuar thënien e Allahut:* **"…Unë jam rob i Allahut. Ai më ka dhënë Librin** (Ungjillin)**, më ka bërë profet dhe më ka bërë të bekuar kudo që të jem…"?**

Mrekullitë janë treguesi më i mirë i qenies së Isait *(Paqja qoftë mbi të!)* profet. Allahu i dha Isait *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* disa mrekulli. Ato mrekulli ishin të habitshme në kohën e Isait. Askush nuk mund të vepronte atë që bënte ai. Mrekullitë ishin: ringjallja e të vdekurve dhe shërimi i të verbërve, sigurisht me lejen e Allahut. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani, i cili thotë: **"Dhe do ta caktojë atë të Dërguar te bijtë e Izraelit** (të cilëve do t'u thotë)**: 'Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj** (që vërtetojnë profetësinë time)**: Bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e Allahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht, tek të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë.'"**[7] Nga ky ajet kuptojmë se të dërguarit e Allahut mund t'i thyejnë ligjet e natyrës, por gjithmonë me lejen e

6 Sure "Merjem", ajetet 29 – 33.
7 Sure "Ali imran", ajeti 49.

Allahut Fuqiplotë dhe se ata nuk kanë pavarësi në vetetvete për veprime të jashtëzakonshme. Këtë e thotë edhe ajeti: **"… me lejen e Allahut…"**

Intriga te bijtë e Izraelit pati mbetur ashtu siç pati qenë edhe në kohën e profetit Musa (Moisiu). Ata i tronditi lindja e Isait, ndërkohë që e prisnin lindjen e tij. Mirëpo kur e panë Isanë në krahë të së ëmës, Merjemes, e akuzuan atë me akuzat më të shëmtuara, deri në imoralitet, siç thotë edhe Kur'ani i Shenjtë: **"Dhe u kthye te populli i vet, duke mbajtur fëmijën. Ata i thanë: 'O Merjeme, ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit! Babai yt nuk ka qenë njeri i keq, as nëna jote nuk ka qenë grua e shthurur.'"**[8]

Kur'ani e kundërshton hyjnizimin e Isait *(Paqja qoftë mbi të!)* nga të krishterët.

Kjo thuhet në disa ajete të tij. Kur'ani e quan të pavlefshëm besimin në hyjnizimin e njeriut. Sipas Kur'anit të Shenjtë profeti Isa (Mesihu) nuk i ka ftuar njerëzit të adhuronin atë, por të adhuronin Allahun e Vetëm e të Pashoq. Në Kur'an thuhet: **"Pastaj Allahu do të thotë** (Ditën e Gjykimit)**: 'O Isa, biri i Merjemes! Ti ishe ai që u the njerëzve 'Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut'?! Isai do të thotë: 'Qofsh i Lartësuar dhe i Lavdëruar!' Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë. Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, kurse unë nuk e di çfarë ka në Veten Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar Ti: 'Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!' Kam qenë dëshmitar, për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe Mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për gjithçka."**[9] Dhe: **"Mesihu nuk do ta**

8 Sure "Merjem", ajetet 27-28.
9 Sure "Maide", ajetet 116-117.

**përbuzte kurrë që të ishte rob i Allahut as edhe melekët më të afërm. Ata që e shpërfillin dhe e nënçmojnë me arrogancë adhurimin e Allahut, Allahu do t'i sjellë të gjithë para Vetes."**[10]

Nëse hazreti Isai do të ishte zot, siç besojnë të krishterët, atëherë ai duhej të ishte në gjendje të shpëtonte veten e tij nga çdo e keqe dhe nga shkatërrimi. Po ashtu, ai do të vepronte me gjithësinë si të dëshironte. Këtë gjë e kundërshton Kur'ani i Shenjtë kur thotë: "**Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë 'Allahu është Mesihu, biri i Merjemes!' Thuaj: 'Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron t'i zhdukë Mesihun, birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë?' Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve, Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Ai krijon çfarë të dojë dhe është i Plotfuqishëm për çdo gjë."**[11]

Sigurisht, Zoti nuk mund të ketë cilësitë dhe vetitë e njeriut. Profeti Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte cilësitë dhe vetitë e njeriut. Ai hante e pinte që të vazhdonte ekzistencën e tij; Zoti nuk ka nevojë për ushqim e për të pirë sepse Ai është i Vetmjaftueshëm. Edhe këtë çështje e vërteton Kur'ani i Shenjtë kur thotë: **"Mesihu, biri i Merjemes, është vetëm një i dërguar. Edhe para tij kanë kaluar të dërguar. Nëna e tij përherë ka qenë e drejtë. Që të dy, hanin ushqim. Shiko si ua shpjegojmë atyre shpalljet tona dhe shih si largohen nga e Vërteta!"** (Sure "Maide", ajeti 75.)

Zoti është Ai, në dorën e të Cilit janë çështjet e njerëzve. Në Kur'an thuhet: **"Thuaju** (o Muhamed)**: 'Si mundet vallë, që ju adhuroni në vend të Allahut, atë që nuk është në gjendje t'ju sjellë as dëm e as dobi, ndërkohë që Allahu**

10 Sure "Nisa", ajeti 172.
11 Sure "Maide", ajeti 17.

**dëgjon dhe di çdo gjë?!"'**[12]

Disa prej të krishterëve e kanë quajtur Isanë (Jezu Krishtin) birin e Zotit. Kur'ani i përgjigjet kësaj, duke e pastruar Allahun nga blasfemi të tilla. Ai thotë: **"Ata thonë: 'Allahu ka bërë një fëmijë'. I Lavdëruar dhe i Lartësuar qoftë Ai! Përkundrazi, Atij i përket çdo gjë që gjendet në qiej e në Tokë dhe Atij i nënshtrohet gjithçka."**[13]

Të krishterët besojnë në Trininë. Kur'ani u përgjigjet duke vërtetësuar monoteizmin dhe mohimin e ortakësisë tek Allahu i Madhëruar. Në Kur'an thuhet: **"O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij** (e Allahut), **të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt nga Ai. Pra, besojuni Allahut dhe të dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: 'Tre zota!' Hiqni dorë sepse është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot - qoftë Lavdëruar Ai! Ai është shumë i Lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë."**[14] Atëherë, përderisa çdo gjë në Tokë e në qiej i takon Allahut të Plotfuqishëm, kurrë nuk mund të ketë zot tjetër përveç Tij.

Në gjashtëmbëdhjetë vende të ndryshme Kur'ani dëshmon dhe vërteton se Mesihu është Isai, biri i Merjemes që do të thotë se ai është njeri si të gjithë njerëzit e tjerë. U krijua në barkun e nënës së tij. Kaloi fazën e embrionit në mitër dhe lindi nga barku i Merjemes *(Paqja qoftë mbi të!),* ashtu siç lindin njerëzit e tjerë nga barku i nënave të tyre. Ai kaloi periudhën e gjidhënies dhe u edukua në prehrin e nënës së tij. Kjo vërteton se ai ka të gjitha cilësitë njerëzore. Vallë, si është e mundur që të

12 Sure "Maide", ajeti 76.
13 Sure "Bekare, ajeti 116
14 Sure "Nisa", ajeti 171.

jetë Zot - i pari, pa fillim dhe i fundit, pa mbarim?! Monoteizmi i vërtetë e mohon hyjnizimin, sepse monoteizëm do të thotë të besosh në Zotin e Vetëm e të Pashoq, në Emrat e në Atributet e Zotit. Kur'ani i Shenjtë thotë: **"Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s'ka asnjë zot tjetër; përndryshe, çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i Lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!"**[15]

Nëse do të kishte zot tjetër, atëherë do të kishte konflikt mes tyre dhe gjithësia nuk do të ishte e qëndrueshme. Nuk do të ekzistonte sistemi i përkryer në gjithësi që ne shohim. Këtë çështje Kur'ani na e përshkruan kështu: **"Vallë, a mos i kanë marrë zotat prej dheu, që të ishin në gjendje t'i ngjallnin të vdekurit? Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i Lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i Lartësuar mbi çka ia veshin Atij!"**[16]

Është e përhapur në mesin e të krishterëve se hazreti Isai (Jezu Krishti) u flijua për mëkatet e njerëzve. Sipas Kur'anit ky është një mendim krejt i gabuar sepse askush nuk mbart gjynahet e tjetrit dhe se çdo njeri do të japë llogari për punët dhe veprat që ka bërë. Për këtë Kur'ani thotë: **"Askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit dhe njeriu do të ketë vetëm atë, për të cilën ka punuar dhe përpjekjet e tij do të shihen."**[17]

Për ta sqaruar më mirë të vërtetën e hazreti Isait *(Paqja qoftë mbi të!)* Kur'ani i Shenjtë na e shpalos shumë bukur dialogun mes Allahut dhe atij në Ditën e Ringjalljes:

**"Allahu do të thotë: 'O Isa, biri Merjemes, kujtoje mirësinë Time ndaj teje dhe nënës sate: se si të forcova ty**

15 Sure "Mu'minun", ajeti 91.
16 Sure "Enbija", ajetet 21-22.
17 Sure "Nexhm", ajetet 38-40.

**me Shpirtin e Shenjtë** (Xhebrailin)**, kështu që ti u predikoje njerëzve, kur ishe foshnjë në djep dhe i rritur; se si të mësova Librin dhe Urtësinë, Teuratin dhe Ungjillin; se si me vullnetin Tim krijoje një figurë shpendi prej balte, pastaj fryje në të dhe ajo bëhej zog me vullnetin Tim; se si me vullnetin Tim i shëroje të lindurit të verbër e të lebrosurit; se si me vullnetin Tim i ngjallje të vdekurit; se si i pengova sulmet e izraelitëve kundër teje, atëherë kur u solle atyre prova të qarta e mohuesit në radhët e tyre thanë 'Kjo është vetëm magji e kulluar!'; dhe se si kur i urdhërova dishepujt: 'Besomëni Mua dhe të Dërguarit Tim!' - ata u përgjigjën: 'Ne besojmë, prandaj dëshmo se Ty të jemi dorëzuar!' Kujto kur dishepujt thanë: 'O Isa, biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na zbresë një sofër prej qielli?' Ai tha: 'Kijeni frikë Allahun, nëse jeni besimtarë të vërtetë!' Ne dëshirojmë të hamë nga ajo, – thanë ata –, që të na qetësohen zemrat dhe ta dimë se na ke thënë të vërtetën dhe për atë të jemi dëshmitarë. O Allah, o Zoti ynë!, – tha Isai, biri i Merjemes – Zbritna një sofër nga qielli, që të jetë festë për ne, për të parin dhe të fundmin tonë dhe të jetë mrekulli prej Teje dhe na jep mirësi, se Ti je Dhuruesi më i mirë! Allahu u përgjigj: 'Unë do t'jua zbres sofrën. Por cilindo nga ju, që nuk beson pas kësaj, do ta dënoj, ashtu siç nuk kam dënuar askënd në botë. Pastaj Allahu do të thotë** (Ditën e Gjykimit)**: 'O Isa, biri i Merjemes!' Ti ishe ai që u the njerëzve 'Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut?!' Isai do të thotë: 'Qofsh i Lartësuar dhe i Lavdëruar!' Mua nuk më takon të them diçka, për të cilën nuk kam aspak të drejtë! Po ta kisha thënë ndonjëherë, Ti me siguri do ta dije. Ti e di çfarë ka në shpirtin tim, kurse unë nuk e di çfarë ka në Veten Tënde. Vetëm Ti i di të gjitha të fshehtat. Unë nuk u kam thënë asgjë tjetër, përveç asaj që më ke urdhëruar**

**Ti: 'Adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj!' Kam qenë dëshmitar për sa kohë që kam jetuar midis tyre dhe qëkurse më more mua, vetëm Ti ishe Mbikëqyrës i tyre. Ti je Dëshmitar për çdo gjë. Nëse Ti i dënon ata - robtë e Tu janë, e nëse i fal ata, me të vërtetë, vetëm Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Allahu thotë: 'Kjo është Dita, kur të sinqertëve u sjell dobi sinqeriteti i tyre. Atyre u takojnë kopshtet, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është fitorja e madhe. Allahut i takon sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që ato përmbajnë. Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.'"[18]**

Kur'ani i Shenjtë sqaron se profeti Isai as nuk është vrarë e as nuk është kryqëzuar. Ai është i gjallë dhe do të vijë kur të urdhërojë Allahu i Plotfuqishëm. Në Kur'an thuhet: **"**(I mallkuam ata) **për shkak të mosbesimit të tyre** {ndaj Isait *(Paqja qoftë mbi të!)*} **për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes dhe për fjalët e tyre: 'Ne e vramë Mesihun – Isanë, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut'. Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur asgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur. Të gjithë ithtarët e Librit do t'i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe, Ditën e Gjykimit, ai do të jetë dëshmitar kundër tyre."[19]**

Ky është Isai, biri i Merjemes sipas Kur'anit të Shenjtë. Kur'ani thotë: **"Ky është Isai, biri i Merjemes. Kjo është**

18 Sure "Maide", ajetet 110-120.
19 Sure "Nisa", ajetet 156-159.

**fjala e vërtetë, për të cilën ata dyshojnë dhe diskutojnë. Allahu nuk ka mbetur të marrë dikë për bir. Qoftë i Lavdëruar Ai! Kur vendos diçka, Ai vetëm thotë për të 'Bëhu!' dhe ajo bëhet.** (Isai tha): **'Vërtet, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj; prandaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.'"**[20]

20 Sure "Merjem", ajetet 34-36.

**Robin Scott**

# BIBLA DHE KUR'ANI

**Abstrakt**

*Të krishterët dhe myslimanët janë më shumë të ngjashëm sesa të ndryshëm. Në artikull do të njiheni me disa prej ngjashmërive mes tyre, si p.sh.: Jezusi mësoi se ka vetëm një Zot dhe vetëm Zoti duhet të adhurohet, siç mësohet te Ligji i Përtërirë/6:4, Marku/12:29. Myslimanët, gjithashtu besojnë, siç urdhërohet në Kur'an/4:171; Jezusi ka përshëndetur me fjalët "Selam alejkum" (Paqja qoftë me ju!) në Gjoni/20:21. Myslimanët, gjithashtu e përshëndesin njëri-tjetrin në këtë mënyrë etj.*

Të krishterët dhe myslimanët janë më shumë të ngjashëm sesa të ndryshëm. Ju lutem lexoni këtë që kam zbuluar.

1.Jezusi mësoi se ka vetëm një Zot dhe vetëm Zoti duhet të adhurohet, siç mësohet te Ligji i Përtërirë/6:4, Marku/12:29. Myslimanët, gjithashtu besojnë, siç urdhërohet në Kur'an/4:171.

2. Jezusi nuk ka ngrënë mish derri, siç mësohet në Levitiku/11:7 dhe as myslimanët nuk hanë siç urdhërohet në Kur'an/6:145.

3. Jezusi ka përshëndetur me fjalët "Selam alejkum" *(Paqja qoftë me ju!)* në Gjoni/ 20:21. Myslimanët, gjithashtu e përshëndesin njëri-tjetrin në këtë mënyrë.

4. Jezusi gjithmonë thoshte "Me vullnetin e Zotit (insha'Allah)".

Edhe myslimanët thonë kështu gjithmonë, siç urdhëron Kur'ani/18:23-24.

5. Jezusi lau fytyrën, duart dhe këmbët para se të lutej. Myslimanët bëjnë të njëjtën gjë (marrin abdes).

6. Jezusi dhe profetët e tjerë të Biblës u lutën me kokën e tyre në tokë (shih Mateu, 6:39). Myslimanët (në sexhde) bëjnë të njëjtën gjë, siç shkruhet në Kur'an/3:43.

7. Jezusi kishte mjekër dhe vishte xhybe. Është traditë, synet për burrat myslimanë të bëjnë të njëjtën gjë.

8. Jezusi ka pasuar Ligjin dhe besonte në të gjithë profetët (shih Mateu 5:17). Myslimanët bëjnë, gjithashtu siç urdhëron Kur'ani/3:84 dhe 2:285.

9. Nëna e Jezusit, zonja Merjeme, është veshur me modesti, duke e mbuluar plotësisht trupin e saj dhe ka mbajtur shami, siç shkruhet në Bibël - në 1 të Timoteut/2:9, Zanafilla/24:64-65 dhe Korintasve/11:6. Femrat myslimane mbajnë veshje të njëjta modeste, siç urdhërohet në Kur'an/33:59.

10. Jezusi dhe profetët e tjerë të Biblës kanë agjëruar deri në 40 ditë (shih Eksodi/34:28, Daniel/10:2-61, Mbretërve/19:8 dhe Mateu/4:1. Myslimanët e bëjnë këtë gjatë muajit të Ramazanit. Myslimanët janë të detyruar të agjërojnë, siç urdhëron Kur'ani/2:183. Ka edhe një agjërim shtesë prej gjashtë ditësh për të rritur shpërblimet e tyre.

11. Jezusi i mësoi të thonë *Paqe,* kur hynte në shtëpi (shih Bibla, Luka/10:5), dhe ka përshëndetur njerëzit në shtëpi me *Paqja qoftë mbi ju!.* Myslimanët bëjnë pikërisht atë që e bëri Jezusi dhe siç këshillonte ai. Kur hyjnë në shtëpitë e tyre dhe në shtëpitë e të tjerëve, thonë *Bismilah* dhe përshëndesin me përshëndetjen

*Es-selamu alejkum (Paqja qoftë mbi ju!)*, siç urdhërohet në Kur'an/24:61.

12. Jezusi qe bërë synet. Synetia (rrethprerja) është traditë për djemtë. Sipas Biblës, në Luka/2:21, Jezusi ishte tetë ditësh, kur u bë synet. Në Bibël, Allahu i ka shpallur Profetit Abraham *(Paqja qoftë mbi të!)* se kjo (rrethprerja) është besëlidhje e përjetshme (shih Bibla, Zanafilla/17:13). Sipas Kur'anit (16:123), myslimanët janë të detyruar të ndjekin fenë e Hazreti Ibrahimit.

13. Jezusi ka folur në gjuhën aramaike dhe e thërriste Zotin *Elah*, e cila është fjalë e njëjtë si Allah. Aramaikishtja është gjuhë e lashtë, është gjuhë biblike. Ajo është një nga gjuhët semite, ku përfshihen edhe hebraishtja, arabishtja, etiopianishtja, asirianishtja dhe akadianishtja. Fjala Elah në gjuhën aramaike është njëlloj si fjala *Allah* në arabisht.

Emri i Zotit, *Elah* në gjuhën aramaike e ka prejardhjen nga arabishtja – *Allah*. Allah në arabisht do të thotë Zoti, Zoti i Plotfuqishëm, Zoti Suprem.

Tani e keni më të lehtë të shihni ngjashmërinë në shqiptimin e fjalëve *Elah* – Allah. Dhe kështu, mund të arrihet në përfundimin se Zoti i Jezusit është edhe Zoti i myslimanëve, i gjithë njerëzimit dhe i të gjitha gjallesave që ekzistojnë.

# ARGUMENTE PSE NUK ËSHTË KRYQËZUAR HAZRETI ISAI

*(Paqja qoftë mbi të!)* [1]


## Abstrakt

*Çifutët, bashkë me tërë botën e krishtere, besojnë se Isai u kryqëzua. Përkundrazi, myslimanët besojnë se Isai (Paqja qoftë mbi të!) nuk është kryqëzuar. Në Kur›anin e Shenjtë thuhet:* **«›Ne e vramë Mesihun – Isanë, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut, -** *(thonë çifutët)***'. Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur asgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur.** *(Kur'an, "Nisa", ajetet, 157,158). Si argumente kundër pikëpamjeve të tyre dhe për të provuar të vërtetën e verdiktit islam, sjellim këtë artikull me pyetje, duke u mbështetur në Librin e Mateut dhe në Dhiatën e re të Biblës (kapitujt 29 dhe 27).*


Bibla vërtetëson faktin se Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* njihej nga çifutët. Ai predikonte në Tempullin e Solomonit, në Jerusalem. Atëherë, nuk ishte e nevojshme të paguhej një çifut

1 Marrë nga *Interpretation of the Meanings of the Noble Qur'an in the English Language*, "Maktaba Darus Salam", Riyadh, 1994. Titulli është i redaksisë. Titulli origjinal është: *Finality on Proofs on the Fabrication of the Story of the Cross.* E përktheu nga gjuha angleze: H. Shehu.

për tridhejtë monedha argjendi që t'i çonte ata tek ai, siç thuhet te Mateu.

Thuhet se një nga dymbëshjetë dishepujt, i quajtur Juda Iskarioti , u pagua për t'i çuar çifutët tek Isai. Pastaj, ata e dënuan Isanë *(Paqja qoftë mbi të!)* me vdekje. Por Juda u turpërua shumë. Prandaj u shkëput nga akti i tyre dhe pastaj u vetëvra. E gjitha kjo paska ndodhur brenda njëzet e katër orëve. Kontradiktat janë të qarta.

Prova më e qartë, e cila, edhe veçmas është e mjaftueshme për ta diskredituar këtë histori është kur çifutët e morën vendimin për vdekjen e Isait dhe donin të merrnin miratimin e guvernatorit, Pont Pilatit. Te Mateu, (27:11-14) thuhet: "Jezusi qëndroi më këmbë përpara guvernatorit, kur ky e pyeti: 'A je ti mbreti i judenjve?' Jezusi ia ktheu: 'Ti vetë e thua.' Por, ndërsa krerët e priftërinjve dhe pleqtë e akuzonin, ai nuk kthente asnjë përgjigje. Atëherë, Pilati e pyeti: 'A nuk e dëgjon sa shumë gjëra po dëshmojnë kundër teje?' Mirëpo ai nuk iu përgjigj dhe nuk tha asnjë fjalë. Guvernatori u habit shumë."

Të krishterët i interpretojnë këto vargje kështu: Jezusi donte të vdiste i kryqëzuar për hir të njerëzimit dhe për faljen e mëkateve të njerëzimit. Atëherë, po të jetë kështu, përse Isai kërkoi t'ia largonin kupën (domethënë, vdekjen)? Përse bërtiti ai ndërkohë që po kryqëzohej (siç mëtojnë ata)? "O Zot, psërse më ke braktisur mua?" Si mund të rrinte ai i heshtur, kur po përballej me të vërtetën? Ai njihej për predikimet e tij që frymëzonin shpirtin, duke sfiduar rabinët e ditur çifutë. Asnjë njeri me mendje të shëndoshë nuk mund ta besojë këtë. Atëherë, vetë themeli mbi të cilin mbështetet Krishtërimi, shembet.

Myslimanët besojnë se Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk është kryqëzuar nga çifutët, siç shpallet në Kur'anin e Shenjtë nga Allahu në mënyrë të qartë si drita e diellit: **"'Ne e vramë**

**Mesihun – Isanë, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut** (thonë çifutët)**'. Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur.'"** (Kur'an, 4:157,158)[2]

Vetë çifutët, bashkë me tërë botën e krishtere, besojnë se ai u kryqëzua. Si argumente kundër pikëpamjeve të tyre dhe për të provuar të vërtetën e verdiktit islam nëpërmjet Biblës, kemi përgatitur grupin e mëposhtëm të pyetjeve, duke u mbështetur në Librin e Mateut dhe në Dhiatën e re të Biblës (kapitujt 29 dhe 27):

1- Ata që e kapën Isanë *(Paqja qoftë mbi të!)* (sipas hamendësimit të tyre), a e njihnin atë personalisht, apo nuk e njihnin?
Mateu vërtetëson se ata nuk e njihnin atë.

2- U kap ditën apo natën?
Mateu thotë se u kap gjatë natës.

3- Kush qe ai që i çoi tek Isai *(Paqja qoftë mbi të!)*?
Mateu thotë: Ai ishte një nga dishepujt e tij, me emrin Juda Eskarioti.

4- I çoi ai ata pa pagesë apo me një pagesë të caktuar, posaçërisht për të?

2 Shih edhe:
është tek Allahu, 3:55;
zbret para Kiametit, 43:61;
nuk u mësoi të tjerëve adhurim të rremë, 5:116 - 118;
çfarë beson myslimani për Isanë, 3:45 - 47, 49, 59; 4:157;
myslimani e mbron Isanë, 3:42, 43, 59, 60, 199; 4:156 - 158, 172; 19:30 - 36; 21:91; 28:51 - 54; 43:59, 63, 64; 66:12 *(shënim i përkthyesit).*

Mateu thotë: I çoi ata tek ai me një pagesë të caktuar prej tridhjetë monedha argjendi.

5- Si ishte gjendja e Isait *(Paqja qoftë mbi të!)* gjatë natës?

Mateu thotë: Ai kishte frikë dhe lutej, duke thënë: "O Zot, në qoftë se Ti ke mundësi ta largosh këtë kupë (vdekje) nga unë, largoje!" Është e pabesueshme që të tilla fjalë të dalin nga një besimtar në Zotin, lëre më, nga një profet i Zotit, kur të gjithë besimtarët besojnë se Zoti ka fuqi mbi gjithçka.

6- Cila ishte gjendja e njëmbëdhjetë dishepujve?

Mateu thotë: I kaploi gjumi atë natë bashkë më mësuesin e tyre (sipas hamendësimit të tyre) nga frika.

7- A ishte i kënaqur Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* me gjendjen e tyre?

Mateu (në vargjet 20-46) thotë: Ai nuk ishte i kënaqur. Vinte tek ata t'i zgjonte, duke u thënë: "Rrini syhapët dhe lutuni, që të mos bini në tundim! Shpirti do, vërtet, por trupi është i dobët." Pastaj ai do të vinte përsëri e përsëri do t'i gjente në gjumë dhe përsëri do t'i zgjonte e do t'u thoshte të njëjtën gjë. Kjo dobësi nuk mund të zihej me gojë nga nxënësit e përkushtuar, madje, edhe po të ishin nxënës të një mësuesi të përkushtuar të zakonshëm, lëre më dishepujt e Isait *(Paqja qoftë mbi të!)*, birit të Merjemes.

8- A e ndihmuan ata kur rrufjanët e kapën?

Mateu thotë: Ata e braktisën atë dhe ikën me të shpejtë.

9- A kishte besim Isai *(Paqja qoftë mbi të!)* te dishepujt e tij atë natë?

Mateu thotë: Jezusi i njoftoi se ata të gjithë do ta braktisnin atë. Pastaj Jezusi u tha tri herë: "Vërtet, po ju them se këtë natë, përpara se të këndojë këndesi, ju do të më mohoni mua." Pjetri i tha: "Unë duhet të vdes me ty, e megjithatë, unë nuk do të të mohoj." Po kështu, thanë të gjithë dishepujt. Dhe kështu ndodhi.

10- Si e kapën rrufjanë atë?

Mateu thotë: Ata erdhen tek Ai me shpata dhe shkopinj, pasi i pati drejtuar një çifut. Pastaj e kapën, siç përshkruhet në vargun 27: "Dhe ata që e kishin kapur Jezusin, e çuan te Kaiafasi, kryeprifti, ku qe mbledhur paria."
Atje ata morën vendimin për ta ekzekutuar. Rrufjanët e morën pastaj tutje, e zhveshën dhe e veshën me një mantel të kuq të ndezur. Pastaj i vunë mbi kokë një kurorë me gjemba dhe e shëtitën poshtë e lart, duke e ngacmuar dhe duke e përqeshur, duke e pështyrë në fytyrë dhe duke e goditur me shkop. Ata i thanë: "Ti je mbreti i Izraelit, ë!» Ata e poshtëruan tepër shumë.

11- Atëherë, kush vendosi më në fund ta zbatojë vendimin e ekzekutimit?
Mateu thotë: Ai ishte Pont Pilati, një romako-grek, që në atë kohë ishte guvernator i Palestinës.

12- Kur rrufjanët e prunë atë njeri përpara guvernatorit dhe i thanë se prifti i çifutëve kishte vendosur dënimin me vdekje, duke e kryqëzuar sipas Ligjit të tyre (Teuratit), a u besoi ai (Isai)/ *(Paqja qoftë mbi të!)* atyre pa e shqyrtuar më tej?
Mateu thotë: Ai nuk u besoi atyre, por e pyeti atë njeri: "A është e vërtetë ajo që kanë thënë ata?" Ai ndenji i heshtur. Pyetja u bë përsëri dhe ai përsëri ndenji i heshtur. Ai ndenji i heshtur përballë së vërtetës. (Ishte thelbësore për të, edhe sikur të mos ishte Profet që ta qartësonte të vërtetën dhe të mohonte akuzimin e rremë të çifutëve. E shoqja e guvernatorit shkoi tek i shoqi dhe i tha: "A nuk ke të bësh fare ti me atë njeri të mirë, sepse kam vuajtur shumë gjëra në ëndërr për hir të tij?" Bibla thotë se Jezusi ka mbajtur predikime të gjata përpara çifutëve, duke i qortuar dhe paralajmëruar ata deri në përgojim. Atëherë, përse ndenji i heshtur atë ditë? Synimi i guvernatorit për pyetjen që i bëri, qe që të dilte e vërteta.

13- Si u kryqëzua ai sipas hamendësimit të tyre?
Mateu thotë: Atë e kryqëzuan bashkë më dy vjedhës - njëri në të djathtë e tjetri në të majtë të tij. Ata që kalonin pranë, shanin

dhe thoshin: "Shpëto veten, nëse je i vërtetë!"
14- Ajo qe një gjëmë e madhe. Çfarë tha ai ndërkohë që (sipas hamendësimit të tyre) po kryqëzohej?
Mateu (27:46) thotë: "Jezusi thërriti me zë të lartë: "Éli, Éli, láma sabahtháni?" (Zoti im, Zoti im, përse më ke braktisur)?"
Sipas të gjitha autoriteteve teologjike, ky është një deklarim zhurmëmadh mosbesimi. Sipas feve të shpallura, kushdo që ia atribuon atë një Profeti, është jobesimtar.

**Në Kur'an, Allahu i Gjithëfuqishëm i paralajmëron jehudinjtë dhe të krishterët për blasfeminë e tyre - se Isai** *(Paqja qoftë mbi të!)* **qenka mishërimi i Zotit, ose se qenka bir i Zotit, ose duke e mohuar atë krejtësisht, ose duke mos besuar në të si i Dërguari i Allahut. Në Kur'an (Surja 4, ajeti 159) thuhet: "Të gjithë ithtarët e Librit do t'i besojnë Isait para se ai të vdesë dhe Ditën e Gjykimit, ai (Isai) do të jetë dëshmitar kundër tyre."**

**Abdu Daem Kahiil**

# ARGUMENTE SHKENCORE NGA KUR'ANI[1] X

**Abstrakt**

*Artikulli është në vazhdën e rubrikës "Argumente shkencore nga Kur'ani" së revistës "Drita e Kur'anit". Ai na njeh me disa argumente shkencore nga Kur'ani, të tilla, si: gjumi pastron trurin; peshku i tejdukshëm; urtësia e therjes së bagëtive sipas Islamit; shkenca konstaton se njeriu është krjuar nga dheu dhe uji etj.*

## Cila është urtësia e therjes së bagëtive sipas Islamit?

Profeti fisnik (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i therte bagëtitë sipas një mënyre të caktuar: nuk u hiqte kokën plotësisht nga trupi, por e linte një pjesë ngjitur me trupin dhe priste derisa i gjithë gjaku të dilte nga bagëtia. Pas kësaj, ajo ishte e gatshme për t'u konsumuar. Sekreti i kësaj mënyre therjeje sqarohet nga zbulimet e reja shkencore në mjekësinë e sotme. Shkenca ka vërtetuar se bagëtia e therur sipas mënyrës islame zbrazet prej mikrobeve dhe baktereve dhe është më e sigurt për t'u konsumuar. Dijetarët sot vërtetësojnë se kur bagëtisë i këputet koka nga trupi, nga trupi del veçse një sasi e paktë gjaku; një pjesë e gjakut mbetet në trupin e bagëtisë.

1 E përktheu nga origjinali h. Vullnet Merja.

Çfarë dëmi sjell ky gjak i mbetur? Dijetarët kanë zbuluar se gjaku është mjedisi më i mirë për zhvillimin e mikrobeve. Kur gjaku mbetet në trupin e bagëtisë së therur, bën që të grumbullohen dhe të shtohen mikrobet e nuk mund të largohen. Madje, ato qëndrojnë deri edhe pas gatimit, sepse temperatura e zjarrit mund të mos hyjë në të gjitha pjesët e mishit të gatuar. Ka mundësi që një pjesë e mishit të mos zihet mirë. E këtu qëndron rreziku.

Disa të pafe e kundërshtojnë mënyrën islame të therjes së bagëtive me pretekstin se torturohet bagëtia. Prandaj sipas tyre duhet të shkëputet plotësisht koka nga trupi i bagëtisë. Mirëpo e vërteta shkencore thotë se dhembja te kafsha e therur nuk vazhdon më shumë se disa sekonda ngaqë të gjitha enët e gjakut janë në punë për furnizimin e trurit me gjak. Nervat, p.sh., marrin urdhra nga truri për furnizimin e tij me gjak për shkak të mangësisë së gjakut, kur theret bagëtia. Muskujt e trupit reagojnë me lëvizje të ndryshme, e kështu, gjaku shtyhet me forcë drejt zemrës. Pastaj, këtë gjak zemra e çon drejt trurit. Por ky gjak del jashtë trupit sepse bagëtia është e therur. Ky proces bën që sasi të mëdha gjaku të dalin jashtë pa dhembje. Kjo do të thotë se Islami është i mëshirshëm deri edhe me kafshët.

Më e mira që kemi lexuar është se kur thuhet "Bismilah! Allahu Ekber!" kur theret bagëtia, (ajo) bagëtia është e zbrazët nga këto mikrobe.

Betohemi në Allahun se Islami na kushton rëndësi të madhe neve dhe shëndetit tonë. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë: **"Tashmë, ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër, që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i Butë e i Mëshirshëm me besimtarët."** (Sure "Teube", ajeti 128).

## Gjumi i ditës

Askush nuk i dinte dobitë e gjumit të ditës. Mirëpo studiuesit kanë zbuluar sekrete të mahnitshme për gjumin e ditës. Në një studim të botuar në një revistë shkencore amerikane në vitin 2015, është sqaruar se gjumi i ditës, qoftë edhe gjysmë ore, është shumë i domosdoshëm dhe shumë i rëndësishëm. Ai është njëlloj si gjumi i natës. E vërteta shkencore është se gjumi është një mrekulli, me qëllim që njeriu të gëzojë shëndet të mirë, kujtesë të fortë dhe të jetojë gjatë.

I lartësuar është Allahu, i Cili na e ka thënë këtë të vërtetë në Librin e Tij, Kur'anin e Shenjtë: **"Të tjera Shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që dëgjojnë."** (Sure "Rr Rrum", ajeti 23).

## Gjumi pastron trurin

Dijetarët në Universitetin "Rochester" në Nju Jork kanë zbuluar se gjumi pastron qelizat e trurit prej helmeve dhe mbetjeve, që grumbullohen gjatë ditës. Prandaj gjumi konsiderohet si procesi i mirëmbajtjes së përditshme të qelizave të trurit dhe i ruajtjes së tyre nga helmet. Në një studim të mëparshëm është sqaruar se gjumi është i domosdoshëm për riaktivizimin e mendjes: për rregullimin dhe depozitimin e të dhënave në të. Dijaetarët mahniten me këtë gjendje të habitshme të njeriut. Vallë, kush është arkitekti i kësaj gjendjeje (gjumit)? A është natyra apo është Allahu? Sigurisht që është Allahu i Madhëruar, i Cili thotë në Kur'an: **"Të tjera Shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa e juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që**

**dëgjojnë."** (Sure "Rrum", ajeti 23).
Ky ajet i bekuar dëshmon dhe vërteton mrekullinë e gjumit. Kjo mrekulli është prej mirësive të Allahut të Madhëruar.

## Ndikimi negativ i smirës

Smira është ndjenja e lakmisë ose e keqdashjes për të tjerët. Islami e ndalon smirën. Madje Allahu i Madhëruar na urdhëron që të strehohemi te Ai dhe t'i kërkojmë mbrojtje Atij prej të keqes së smirakëve. Në Kur'an thuhet **"Dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë."** (Sure "Felek", ajeti 5). Disa dyshimtarë e mohojnë të vërtetën e smirës që përmendet në Kur'an. Por dijetarët kanë konstatuar se smira ekziston dhe është e dëmshme për trurin.

Në një studim të ri (qershor 2013), dijetarëve u është qartësuar se gjatë smirës truri funksionon në mënyrë shumë të ndërlikuar. Gjaku lëviz në tru nëpërmjet pjesëve të tij sipas gjendjes emocionale të njeriut. Kur njeriu është i lumtur, truri është aktiv në pjesë të pakta e të kufizuara dhe është e lehtë të dallohet kjo gjendje. Ndërsa, kur është i mërzitur, truri lodhet ngaqë bën më shumë përpjekje, sepse në të funksionojnë shumë pjesë. Prandaj, dijetarët këshillojnë që njerëzit të mos mërziten: mërzitja shkakton vdekjen e qelizave të trurit. Ajo shkakton edhe pleqëri të parakohshme dhe sëmundjen e humbjes së kujtesës.

Dijetarët kanë vënë re se smira e dëmton trurin dhe shkaton shqetësime te njeriu. Pas eksperimentimeve të gjata rreth trurit të njeriut nëpërmjet skanerit magnetik, dijetarëve u është sqaruar se truri është i çoroditur kur ka smirë. Prandaj ata thonë se smira është ndjenjë e keqe dhe e dëmton trurin.

Ky zbulim shkencor dëshmon se Kur'ani nuk është në kundërshtim me shkencën. Ateistët dyshojnë te magjia, smira,

gjuha e milingonës, ngritja e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në qiell. Mirëpo çdo ditë shkencëtarët zbulojnë të vërteta të reja që dëshmojnë se Kur'ani është Libër që i drejtohet zemrës dhe mendjes.
I Lartësuar është Allahu dhe Atij i takon falënderimi që na ka mirësuar me Islamin e pastër.

## Peshku i tejdukshëm

Vërtet, ai është shenjë prej Shenjave të Allahut të Madhëruar e të Lartësuar, që e fton çdo besimtar pesimist që të jetë optimist për Mëshirën e Allahut. Ai i Cili e mban gjallë këtë peshk në thellësi të oqeanit, është i Plotfuqishëm që ta furnizojë atë njeri që thotë: "O Zot!"

Kur shkencëtarët zbritën në thellësi të oqeaneve dhe me nëndetëset e tyre arritën në më shumë se një mijë metra në thellësi të oqeaneve, zbuluan errësirë të plotë. Ata nuk e mendonin se do të gjenin ndonjë gjallesë që mund të jetonte në këtë errësirë të plotë. Por e papritura ishte kur shkencëtarët zbuluan kohët e fundit lloje gjallesash që jetojnë në det dhe e ndriçojnë vetë mjedisin e tyre. Qelizat e këtyre gjallesave prodhojnë energji ndriçuese dhe e përhapin deri në atë largësi që u nevojitet atyre. Ky ndriçim u tregon atyre rrugën e drejtë dhe i udhëzon të gjejnë ushqimin e tyre. Ka peshq të tejdukshëm që përcjellin dritë e që shfaqet mrekullueshëm. Kjo tregon madhështinë e Krijuesit të këtij peshku. Peshqit kanë disa pjesëza ndriçuese në gushë dhe në sipërfaqen e barkut. Drita që lëshojnë, ka ngjyrë blu dhe e përdorin për tërheqjen e gjahut.

Peshqit ndriçues janë shenjë prej Shenjave të Allahut të Madhëruar.

Çdo ditë dijetarët zbulojnë lloje të reja peshqish ndriçues në thellësi të oqeaneve. Prej llojeve më të rëndësishme të këtyre

peshqve janë: peshku sëpatë. Ai jeton në thellësi të mëdha. Ai lëshon dritë të forteë, e cila vepron si zbuluese për peshqit që gjuan; peshku gjarpër: gjendet në thellësinë 80 - 1600 metra nën ujë; prodhon dritë mahnitëse për të tërhequr peshqit e tjerë. Ka edhe shumë lloje të tjera, nga të cilat dijetarët kanë zbuluar veçse një pakicë të tyre. Si ka mundësi që këto gjallesa të prodhojnë dritë, edhe pse jetojnë në thellësi të errëta? Përgjigjen e kësaj e gjejmë në Kur'anin e Shenjtë, që thotë: **"**(Faraoni) **tha: 'E, kush është Zoti juaj, o Musa?'** (Musai) **tha: 'Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.'"** (Sure "Taha", ajetet 49, 50). Po. Allahu, i Cili i ka krijuar këto gjallesa, ua ka përgatitur dhe ua ka siguruar rrugën dhe i ka udhëzuar për ta gjetur ushqimin e tyre. Ai ka vënë në dispozicion të tyre mjetet që ato të vazhdojnë jetën. Nëse nuk do të ishte kjo dritë, ato do ishin zhdukur.

## Portat e Xhenetit dhe portat e Xhehenemit në Kur'an: Numri 15

Portat të Xhenetit janë tetë, sipas thënies së Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Vërtet, në Xhenet ka tetë porta dhe njëra prej tyre quhet Rejjan, në të cilën nuk hyn askush përveç agjëruesve." (Transmeton Buhariu). Kurse portat e Xhehenemit janë shtatë, siç thotë Allahu i Madhëruar në Kur'an: **"Pa dyshim, Xhehenemi është vendi i premtuar për të gjithë ata. Ai ka shtatë dyer e për çdo derë do të ketë një pjesë të caktuar."** (Sure "Hixhr", ajetet 43, 44). Me një llogaritje të thjeshtë, na del se numri i portave të Xhenetit dhe të Xhehenemit është: 8 + 7 = 15.

Habia është këtu: po të kërkojmë fjalën "el ebuabu" (dyer, porta), në Kur'anin e Shenjtë, do të shohim se ajo fjalë përsëritet 15 herë. Numri është i barabartë e numrin e portave të Xhenetit dhe të Xhehenemit. I Lartësuar është Allahu. Më poshtë po ju sjellim pesëmbëdhjetë ajetet:

**1- "...Hyni në shtëpi nga dyert e tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni."** (Sure "Bekare", ajeti 189)

**2- "Kur ata i harruan paralajmërimet Tona, Ne ua hapëm dyert e çdo mirësie..."** (Sure "En'am", ajeti 44).

**3- "Me të vërtetë, atyre, që i mohuan shenjat Tona me mendjemadhësi, nuk do t'u hapen dyert e qiellit..."** (Sure "A'raf", ajeti 40.)

**4- "Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshte në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert..."** (Sure "Jusuf", ajeti 23).

**5- "O djemtë e mi, mos hyni nga e njëjta portë** (e qytetit)**, por nga dyer të ndryshme..."** (Sure "Jusuf", ajeti 67).

**6- "Ai** (Xheneti) **ka shtatë dyer e për çdo derë do të ketë një pjesë të caktuar.**(Sure "Hixhr", ajetet 44).

**7- Hyni në dyert e Xhehenemit, ku do të mbeteni përgjithmonë!"** (Sure "Nahl", ajeti 29).

**8- "Në Xhenetet e Adnit, dyert e të cilit janë të hapura për ta."** (Sure "Sad", ajeti 50).

**9- Jobesimtarët do të shtyhen grupe-grupe në Xhehenem dhe, kur të arrijnë atje, do të hapen dyert e tij..."** (Sure "Zumer", ajeti 71).

**10- "Atyre u thuhet: 'Hyni në dyert e Xhehenemit, ku do të qëndroni gjithmonë!'"** (Sure "Zumer", ajeti 72).

**11- "Ndërsa ata që i janë frikësuar Zotit të tyre, do të çohen grupe-grupe në Xhenet. Kur t'i afrohen atij, dyert e tij do të hapen..."** (Sure "Zumer", ajeti 73).

**12- "Hyni në <u>dyert</u> e Xhehenemit, për të qëndruar përherë në të…"** (Sure "Gafir", ajeti 76).

**13- "Edhe <u>dyert</u> e shtëpive të tyre…"** (Sure "Zuhruf", ajeti 34).

**14- "Dhe Ne i hapëm <u>dyert</u> e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm."** (Sure "Kamer", ajeti 11).

**15- "<u>Dyert</u> e qiellit do të hapen"** (Sure "Nebe", ajeti 19).

Vallë, a ka ardhur rastësisht kjo përputhje numerike?! Jo. Vërtet, kjo përputhje është nga Allahu dhe dëshmon për vërtetësinë e Fjalës së Tij.

## Shkenca konstaton se njeriu është krjuar nga dheu dhe uji

A e besoni, i dashur lexues se çdo njeri është një çerek fuçi uji dhe grumbull dheu? Po. Kjo është përbërja e njeriut.

Shkencëtarët vërtetojnë se të gjitha elementet prej të cilave përbëhet trupi i njeriut gjenden te dheu. Kjo është ajo që na e thotë Kur'ani i Shenjtë: **"Një prej Shenjave të Tij është që Ai ju krijoi prej dheut, pastaj ja, tashmë ju jeni njerëz të shpërndarë në të gjitha anët."** (Sure "Rrum", ajeti 20). Allahu e ka krijuar çdo gjallesë prej ujit. Dijetarët kanë zbuluar se përqindja e ujit në përbërjen e gjallesave arrin në më shumë se 70%.




Mendoni, i dashur lexues se një ditë ti ke qenë disa qeliza të vogla, që nuk shihen me sy. Kjo foto është e embrionit 48-orësh, marrë me mikroskop elektronik. Vallë, si

shndërrohen këto qeliza të vogla e të pavlera në një njeri të plotë? Sigurisht, me fuqinë e Allahut.

Kjo foto është e foshnjës shtatë javësh. Ajo është shumë



më e vogël se kokrra e qershisë. Mirëpo ajo ka të dëgjuarit, të shikuarit, zemrën, mendjen, aparatin tretës, aparatin e frymëmarjes etj. Kush të krijoi ty, o i dashur njeri? Prandaj Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë: **"…Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë. Ende nuk besojnë?!"** (Sure "Enbija", ajeti 30) Dhe: **"Allahu e ka krijuar çdo lloj kafshe prej ujit…"** (Sure "Nur", ajeti 45)

Dijetarët vërtetojnë se dukuria më e habitshme në natyrë është krijimi i njeriut. Një qelizë e vetme rritet dhe bëhet më shumë se njëqind miliardë qeliza. Si ndodh ky proces? Kush e drejton këtë program të përkryer? A është natyra apo Krijuesi i natyrës? Për këtë, dijetarët kanë zbular se trupi i njeriut përbëhet prej të njëjtash elemente që gjenden te dheu.

Dijetarët e agjencisë "Nasa" vërtetojnë se Toka jonë është formuar nga tymi kozmik. Ky tym formoi dheun e Tokës dhe po ashtu, ujin. Kjo, për miliona vjet. Pastaj u krijua njeriu nga ky dhê e nga ky ujë. Pra, e vërteta shkencore përforcon se në thelbin e tij, njeriu përbëhet nga dheu dhe nga uji. Kur dheu përzihet me ujin, formohet balta, që është zanafilla e njeriut. Allahu i Madhëruar thotë: **"Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës."** (Sure "Mu'minun", ajeti 12). Kjo tregon përputhshëmrinë e plotë mes shkencës dhe thënies që ka ardhur në Kur'anin e Shenjtë para më shumë se 14 shekujsh. I Lartësuar qoftë Allahu!

Qani Banaj

# PËR ÇDO SËMUNDJE KA ILAÇ


**Abstrakt**

*Xhabir ibn Abdullahu ka transmetuar se Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:* **"Për çdo sëmundje ka ilaç. Kur ilaçi e godet sëmundjen, shërohet me lejen e Allahut."** *(Muslimi)*

*Në artikull jepen vetitë shëruese të ballotës, helmarinës, mërqinjës, shtrapnit, cënukut, ushunjëzës pa kërcell, lotzonjës, lidhnaqit, fierit mashkull, gjineshtrës ngjyruese etj.*


## Ballota

Kjo bimë përdoret kundër sëmundjeve të tëmthit dhe të mëlçisë, kundër sëmundjeve nervore, kundër migrenës, kundër provokimeve të të vjellave etj.

## Helmarina

Kjo bimë ka veprim antispazmatik. Ajo përdoret edhe si qetësuese e dhimbjeve të stomakut, e dhimbjeve që shkaktohen nga gurët në tëmth dhe në veshka etj. Bima përdoret edhe kundër qelbëzimit të bronkeve, kundër tuberkulozit, kundër epilepsisë, astmës, paralizës, reumatizmës, pagjumësisë etj.

## Melqinja

Në mjekësinë popullore, kjo bimë përdoret si laksativ, diuretik, koleretik, antementik e spozmolitik. Ajo përdoret kundër infeksionit në veshka, gjithnjë me doza të vogla dhe në mbikëqyrjen e mjekut. Tejkalimi i dozës dëmton veshkat dhe mund të ngacmojë sistemin nervor.

## Shaja

Kjo bimë përdoret për të nxitur urinimin dhe kundër pezmatimeve të rrugëve urinare.

## Shtrapni

Kjo bimë përdoret kundër hemoragjive të mitrës e kundër menstruacioneve të zgjatura. Bima ndikon edhe në ngushtimin e enëve të gjakut në muskulaturën e mitrës.

## Zogu

Kjo bimë përdoret kundër sëmundjeve të zemrës.

## Speci

Speci ka shumë vitaminë C. Prandaj ai përdoret për parandalimin e sëmundjes së skorbutit. Ai vepron mirë në aparatin tretës, nxit veprimtarinë e stomakut dhe përmirëson procesin e tretjes. Speci zgjeron enët e gjakut. Në formë përvëlese, përdoret për lyerjen e flokëve dhe për parandalimin e rënies së tyre. Në formë pomade, përdoret për lyrje lokale, në rastin e dhimbjeve reumatizmale e muskulore. Speci përdoret edhe si polivitaminik në raste anemie.

## Cnuku

Kjo bimë ndihmon veprimtarinë e stomakut dhe ndalon zhvillimin e baktereve.

## Gjembgomari

Po të shohim me kujdes gjembgomarin, vërejmë se ai ka një ngjashmëri me mëlçinë. Prandaj ai përdoret për kurimin e cirozës hepatite dhe kundër rrjedhjes së tëmthit. Kjo bimë përdoret edhe kundër verdhëzës, majasëllit dhe ngërçit të venave.

## Ushunjëza pa kërcell

Lëngu i përftuar nga zierja e kësaj bime përdoret kundër dhimbjeve të veshkave, kundër majasëllit, kundër çrregullimeve të menstruacioneve, kundër çrregullimeve nervore etj.

## Lotzonja

Kjo bimë përdoret për rregullimin e veprimtarisë së zemrës (kundër çrregullimeve nervore të aktivitetit kardiak). Ajo përdoret edhe kundër epilepsisë, kundër çrregullimeve nervore, kundër sëmundjeve akute të mëlçisë së zezë dhe të veshkave.

## Idhnaqi

Kjo bimë përdoret kundër bronkitit, kundër astmës, kundër reumatizmws etj. Kurse lëngu që përftohet nga zierja e bimës përdoret kundër zgjebes.

## Efedra

Kjo bimë ndihmon frymëmarrjen në astmën bronkiale dhe në kollën e mirë.

## Fshesa e keqe

Kjo bimë përdoret kundër diarresë, kundër dizenterisë, kundër bronkitit, kundër reumatizmës. Bima ka veti të ndalojë rrjedhjen e gjakut dhe të nxisë formimin e rruazave të bardha të gjakut. Esenca e bimës përdoret kundër parazitëve dhe askarideve.

## Gjemë (gjem) landha

Kjo bimë përdoret kundër sëmundjeve të veshkave: kundër urinimit me vështirësi dhe kundër rërës dhe gurëve në veshka.

## Eupotorja kërpore

Kjo bimë frenon veprimtarinë e sëmundjeve tumorale. Ajo përdoret edhe kundër paraziteve, kundër dispepsisë dhe kundër dobësimit të përgjithshëm.

## Eufraze

Kjo bimë përdoret për mjekimin e mahisjeve dhe gjendjeve me ethe. Kështu ajo pakëson sekretimet.

## Gjineshtra ngjyruese

Kjo bimë ka veti të pakësojë acarimet e rrugëve urinare. Bima përdoret në rastet e pezmatimit të fshikëzës së urinës, në rastet e gurëve në veshka ose në fshikëz.

**Fatme Chehab**

# VENDE, POPUJ, NJERËZ E NGJARJE QË PËRMENDEN NË KUR'AN

## XHAMIA "EL AKSA"

**Abstrakt**

*Xhamia "El Aksa" ka qenë kiblja e parë e myslimanëve. Kjo xhami është brenda qytetit të vjetër të Kudsit -Jeruzalemit, i cili ndodhet afërsisht në qendër të Palestinës. Allahu e ka përshkruar Xhaminë "El Aksa" në Kur'an si tokë e bekuar. Në Kur'an thuhet:* **"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij** *(Muhamedin)* **natën nga Xhamia e Shenjtë** *(në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit)*, **rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai** *(Allahu)*, **me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë."** *(Sure "Isra", ajeti 1).*

*El Aksa është një ndër tri Xhamitë, në të cilat shkohet për vizitë. Profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: "Asnjë udhëtim nuk duhet të ndërmerret (për vizitë), përveçse në tri Xhamitë: Xhamia e Shenjtë (Qabja), Xhamia e Profetit në Medinen e Ndritur dhe Xhamia "El Aksa"."*

Pas Qabes, xhamia "El Aksa" është xhamia e dytë e ndërtuar në Tokë për adhurimin e Allahut. Ajo është prej vendeve të shenjta të myslimanëve. Ajo ka qenë kiblja e parë e tyre. Kjo xhami është brenda qytetit të vjetër të Kudsit

-Jeruzalemit, i cili ndodhet afërsisht në qendër të Palestinës.

Kudsi është 750 metra mbi nivelin e detit Mesdhe dhe 1150 metra mbi nivelin e Detit të Vdekur. Ai rrethohet nga pesë male. Në të gjenden katër lugina. Qyteti është 52 km larg nga deti Mesdhe, 22 km nga Deti i Vdekur, 252 km nga Deti i Kuq, 88 km nga Omani, 388 km nga Bejruti dhe 290 km nga Damasku. Sipas statistikave të muajit dhjetor, 2007 qyteti i Kudsit numëronte 747600 banorë.

Qyteti është ndërtuar në mijëvjeçarin e katërt p.e.r. nga kena'nët (emri i vjetër i popullsisë palestineze). Ai është zgjeruar dhe rindërtuar disa herë gjatë historisë, duke filluar në kohën e profetit Sulejman, në kohën e halifit të dytë, Umer ibn Hatab, në kohën e Mervan ibn Hakemit (viti 72 i hixhrit), në kohën e halifit të shtatë, Fatimij (viti 425 i hixhrit), në kohën e memalikëve (viti 651 i hixhrit), në kohën e sulltan Kanunijit (viti 963 i hixhrit).

Kudsi përmendet edhe në Kur'anin e Shenjtë, në suren "Isra", ajeti 1: "**I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij** (Muhamedin) **natën nga Xhamia e Shenjtë** (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit)**, rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë."** Në këtë ajet përmendet një prej mrekullive madhështore për profetin Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, që është ngritja në qiell (Israja dhe Miraxhi) nga ky vend i shenjtë.

El Aksa është një ndër tri xhamitë, në të cilat shkohet për vizitë. Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Asnjë udhëtim nuk duhet të ndërmerret (për vizitë), përveçse në tri xhamitë: Xhamia e Shenjtë (Qabja), Xhamia e Profetit në Medinen e Ndritur dhe Xhamia "El Aksa"."*

Xhamia "El Aksa" është ndërtuar dyzet vjet pas Qabes, siç vërtetësohet nga hadithi i Ebu Dherrit *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)*, kur ai e pyeti Profetin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: *"Cila është xhamia e parë e ndërtuar mbi tokë?"* Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: "*Xhamia e Haremit (Qabja).*"
Ebu Dheri e pyeti: "*Pastaj cila xhami?*"
Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: "Xhamia "El Aksa"."
Ebu Dheri e pyeti përsëri: "*Sa vjet ka midis të dyjave?*"
Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u përgjigj: "*Dyzet vjet.*"
Për shkak të periudhës së shkurtër midis ndërtimit të këtyre dy xhamive, disa dijetarë kanë mendimin që profeti Ibrahim i ka ndërtuar të dyja. Historianët kanë përmendur që profeti Jakub *(Paqja qoftë mbi të!)* e ndërtoi xhaminë afër gurit, nga ku profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u ngrit në qiell.

Sipërfaqja e xhamisë "El Aksa" është 144 mijë metra katrorë (sa një e gjashta e hapësirës së qytetit të vjetër të Kudsit). Përmasat e xhamisë janë: muri nga ana e jugut është 281 metra; muri nga ana e veriut, 310 metra; muri nga ana e lindjes, 462 metra; muri nga ana e perëndimit, 491 metra. Kjo Xhami ka katër minare, që ndodhen në anën jugperëndimore, perëndimore, veriperëndimore dhe veriore. Xhamia ka katërmbëdhjetë kupola: kupola e Sulejmanit, kupola e Hidrit, kupola e Miraxhit, kupola e Musait, kupola e shpirtrave etj. Ajo ka pesëmbëdhjetë porta, pesë prej të cilave janë të mbyllura.

Kuptimi i fjalës "El Aksa" është "i largët". Thuhet se e ka marrë këtë emër për shkak të largësisë së saj me Xhaminë e Shenjtë në Mekë - Qaben. Para përmendjes së saj në Kur'an, ajo quhej "Bejtul Makdis".

Në këtë vend kanë jetuar shumica e të dërguarve dhe

profetëve, si profeti Daud, profeti Sulejman, profeti Jakub, profeti Musa, profeti Isa dhe babai i monoteizmit, profeti Ibrahim *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*. Gjithashtu, në këtë vend ka shërbyer edhe hazreti Merjemja (Maria), nëna e profetit Isa *(Paqja e Allahut qoftë mbi ta!)*. Hazreti Merjemja ka qenë nën kujdestarinë e profetit Zekerija. Historia e saj përmendet në Kur'anin e Shenjtë në suren "Ali Imran" dhe në suren "Merjem". Pra, Bejtul Makdes është vatra e të gjitha feve qiellore dhe nderohet e respektohet nga të gjithë besimtarët. Të gjithë besimtarët janë të lirë ta vizitojnë këtë vend të shenjtë.

**Allahu e ka përshkruar Xhaminë "El Aksa" në Kur'an si tokë e bekuar.** Në Kur'an thuhet: **"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij** (Muhamedin) **natën nga Xhamia e Shenjtë** (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit)**, rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë."** (Sure "Isra", ajeti 1)

Përderisa Allahu thotë në Kur'an se ky vend është i bekuar, atëherë edhe njerëzit në këtë vend duhet të jetojnë në paqe e siguri. Namazi në të është më i vlefshëm se në xhamitë e tjera, përveç Qabes dhe Xhamisë së Profetit. Në hadithe thuhet se vlera e një namazi në këtë Xhami është sa një mijë namaze në xhamitë e tjera a sa 500 namaze në xhamitë e tjera, a sa 250 namaze në xhamitë e tjera.

**"El Aksa" është Kiblja e parë e myslimanëve**, ashtu siç është kumtuar nga El Bara: "*I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është falur në drejtim të el Bejt el Makdisit për gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë muaj.*"

Kudsi dhe Aksaja janë në zemrën e çdo myslimani dhe myslimaneje. Këtë e cilëson Kur'ani i Shenjtë:

**"O populli im! Hyni në Tokën e shenjtë që Allahu e ka caktuar për ju dhe mos u ktheni prapa, sepse atëherë do të ktheheni të humbur!"** (Sure "El Maide", ajeti 21)

Dhe: **"Ndërsa popullit të përndjekur Ne i dhamë në zotërim viset lindore dhe perëndimore të tokës që kishim bekuar. Kështu u përmbush premtimi i bukur i Zotit tënd ndaj izraelitëve, për shkak të durimit që treguan. Ndërsa ndërtesat dhe kullat e Faraonit dhe të popullit të tij Ne i shkatërruam."** (Sure "A'raf", ajeti 137)
Dhe: **"Edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve, u kemi shpallur; prandaj, i pyesni njerëzit e shkrimeve** (të mëparshme)**, nëse ju nuk dini!"** (Sure "Nahl", ajeti 43)

Dhe: **"Ne e shpëtuam atë** (Ibrahimin) **dhe Lutin** (dhe i çuam) **në tokën, të cilën e kemi bekuar për njerëzit."** (Sure "El Enbija", ajeti 71)
Dhe: **"Sulejmanit i dhamë erën e fortë, që të fryjë sipas urdhrit të tij, drejt tokës, të cilën Ne e kemi bekuar."** (Sure "Enbija", ajeti 81)
Dhe: **"Midis atyre dhe qyteteve që i kemi bekuar, Ne vendosëm vendbanime të dukshme buzë rrugës dhe e bëmë të lehtë udhëtimin** (duke u thënë)**: "Udhëtoni të sigurt nëpër to natë e ditë!"** (Sure "Sebe", ajeti 18)

Dhe: **"Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje."** (Sure "En Nur", ajeti 36)

Dhe: **"Kush është më fajtor sesa ai që pengon të përmendet në xhamitë e Allahut Emri i Tij dhe përpiqet për shkatërrimin e tyre? Ata nuk duhet të hyjnë në to, përveçse të frikësuar. Për ata, në këtë jetë ka poshtërim, kurse në Jetën Tjetër,** *dënim të madh."* (Sure "El Bekare", ajeti 114)

Në mbyllje, do të donim të tërhiqnim vëmendjen e

myslimanëve se Mesxhidi Aksa nuk është ajo kubeja e artë, pamja e së cilës paraqitet shpesh nëpër mediat vizive. Ajo quhet Kubbetu-s Sakhra (Kubeja e Shkëmbit). Mesxhidi Aksa (xhamia "Aksa") është xhamia e vjetër, e cila ndodhet pranë saj.

Lusim Allahun e Madhëruar të na e mundësojë vizitën në kiblen e parë të myslimanëve. Gjithashtu, e lusim Allahun që mbarë njerëzit të jetojnë në paqe, në dashuri dhe në harmoni.

Nasir Mekarim Shirazi

# DHJETË URDHËRESA
## KOMENTIMI I AJETEVE 151-153, TË SURES "EN'AM"

**Abstrakt**

*Në ajetet 151-153 të sures "En'am" janë dhjetë urdhëresa shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me mohimin e dispozitave të ndryshme nga politeistët. Urdhëresat përmendin gjynahet e mëdha në dhjetë pjesë, në mënyrë të përmbledhur. Ato i ftojnë politeistët që të shkojnë te Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e të dëgjojnë atë që u lexohet për të ndaluarat nga Allahu. Në ajetin 151 të sures "En'am" thuhet:* **"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij askënd e asgjë** *(në adhurim)*; **që të silleni mirë me prindërit; që të mos i vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos u afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia** *(e ligji)*. **Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.'"**

**"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar All'llahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë** (në adhurim); **që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato**

**të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën All'llahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia** (e ligji)**. Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni."**
**"Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të mbërrijë pjekurinë! Kryejeni drejt matjen dhe peshimin; Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij! Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj! Plotësojani besën e dhënë All'llahut! Këto ju porosit Ai që ju të kujtoni."**
**"Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij! Kjo është ajo që ju porosit Ai që të jeni të devotshëm."**

## Komentimi

Këto ajete përmendin gjynahet e mëdha në dhjetë pjesë, në mënyrë të përmbledhur. Ato i ftojnë politeistët që të shkojnë tek Profeti e të dëgjojnë atë që u lexohet atyre rreth të ndaluarave të All'llahut dhe të lënë ndalesat e ndryshme në anën tjetër.
Ajeti thotë: **"Thuaju: 'Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar All'llahu...'**

1- **'...që të mos i shoqëroni Atij asgjë** (në adhurim)**...'**

2- **'...që të silleni mirë me prindërit...'**

3- **'...që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë...'**, pra për arsye të varfërisë e ngushticës **'...sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata...'**.

4- **'...që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta...'**, pra mos iu afroni atyre!

5- **'...dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të**

**cilën All'llahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia...'**. Pra, mos derdhni gjak të pafajshëm; mos i vrisni qëniet njerëzore, për të cilat All'llahu e ndaloi vrasjen, vetëm në rast se janë brenda ligjeve dënuese të All'llahut. Vetëm në këtë rast ju lejohet ta vrisni atë. Më pas, pas përmendjes së këtyre pesë pjesëve, për ta përforcuar më shumë, All'llahu thotë: **'... Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni.'** Kështu që, mos i vepronit ato!

6- **'Dhe mos iu qasni pasurisë së jetimit, përveçse për ta rregulluar, derisa të arrijë pjekurinë...',** pra, mos iu afroni pasurisë së jetimit, vetëm se me qëllim ndreqjeje a pajtimi, deri sa të arrijë pjekurinë e tij.

7- **'...Kryejeni drejt matjen dhe peshimin...'** pra, mos mos matni mangët e as mos peshoni mangët kur shisni. Ka raste që njeriu, sado i saktë të jetë në matje e në peshë, mund të shtojë ose lërë mangut dhe nuk mund t'i saktësojë matjet e peshat. Për këtë ajeti thotë në vijim: **'...Ne nuk ngarkojmë askënd përtej mundësisë së tij...'**

8- **'...Kur të flisni, thoni të vërtetën, qoftë edhe për të afërmit tuaj...'** Mos devijoni nga rruga e drejtë në dëshmi, gjykim apo çështje tjetër edhe nëse është një i afërm i juaji, kështu që dëshmoni të vërtetën dhe gjykoni me drejtësi!

9- **'...Plotësojani besën e dhënë All'llahut...'** Mos e thyeni atë! Por, çfarë është besa e All'llahut që përmendet në këtë ajet? Komentuesit kanë dhënë disa mundësi për të, por kuptimi i ajetit përmbledh të gjitha besët "krijuese"[1], "legjislative", urdhrat e All'llahut dhe ç'do premtim, zotim e betim. Më pas, në mbyllje të këtyre katër pjesëve dhe si përforcim, i Lartësuari thotë: **'... Këto ju porosit Ai që ju të kujtoni.'**

10- **'Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t'ju shmangin nga rruga e Tij...'** Pra, All'llahu thotë në këtë ajet se rruga e Tij, është rruga

1 Besa që mori Allahu nga njeriu që në fillimin e krijimit të tij.

e njësimit, rruga e vërtetë dhe e drejtë, rruga e pastërtisë dhe e devotshmërisë. Kështu që, ecni në të, pasojeni dhe ndiqeni atë! Mos ndiqni rrugët e devijuara e të ndara që t'ju largojnë nga All'llahu dhe t'ju çojnë në mosmarrëveshje, përplasje, përçarje e ndarje, e të mbjellin tek ju farën e ndarjes e të hipokrizisë!

Më pas i përmbyll të gjitha këto pjesë duke përsëritur për herë të tretë thënien e Tij, me qëllim përforcimi: **'...Kjo është ajo që ju porosit Ai, që të jeni të devotshëm.'"**

## Hulumtime

Këtu janë disa pika ku do të ndalemi:

**1- Fillimi me njësim dhe fundi me heqjen dorë nga kontradikta**

Në këto ajete vihet re se këto dhjetë mësime e urdhëresa fillojnë me ndalimin e politeizmit (*shirkut*), i cili është burimi kryesor i përhapjes së të gjitha të këqijave shoqërore dhe i të ndaluarave të All'llahut. Ato përfunduan, gjithashtu, me thirrjen për heqjen dorë nga përçarja e mosmarrëveshja, që konsiderohen si një lloj politeizmi praktik.

Kjo çështje zbulon rëndësinë e çështjes së njësimit (teuhidit) në të gjitha bazat dhe degët islame, si dhe, zbulon se njësimi nuk është thjesht vetëm një bazë ideologjike, por ai përfaqëson shpirtin e mësimeve islame në tërësi.

**2- Përforcimet e njëpasnjëshme**

Fraza **"...Kjo është ajo që ju porosit Ai..."** është përsëritur për përforcim në përfundim të çdo ajeti nga tre ajetet në fjalë; natyrisht me ndryshime në përmbajtje. Ajeti i parë përfundon me thënien **"...me qëllim që të kuptoni"**. Ajeti i dytë mbyllet me fjalinë: **"...që ju të kujtoni."** Ajeti i tretë përfundon me fjalinë: **"...që të jeni të devotshëm."**

Me sa duket këto përshkrime të ndryshme tregojnë se faza e parë kur merret një dispozitë prej dispozitave, është etapa "**e të logjikuarit**", pra kuptimi dhe perceptimi i asaj dispozite.

Faza e dytë është faza "**e të kujtuarit**", që është bluarja e kësaj dispozite, përthithja e dobive të saj dhe asimilimi i përmbajtjes së saj.

Faza e tretë, që është edhe e fundit, është ajo e praktikimit dhe e zbatimit, të cilën Kur'ani e ka quajtur faza e **"devotshmërisë."**

Është e vërtetë se secila nga këto faza ka ardhur pas përmendjes së disa mësimeve nga këto dhjetë mësime. Mirëpo, është e qartë se këto faza nuk i përkasin dispozitave të caktuara, sepse çdo dispozitë prej dispozitave dhe çdo udhëzim prej urdhëzimeve ka nevojë për mendim, kujtesë, devotshmëri dhe veprim. E gjithë kjo për ruajtjen e anëve të letërsisë e retorikës, në bazë të të cilave u bë shpërndarja e këtyre përforcimeve (dhe fazave) përgjatë këtyre dhjetë udhëzimeve.

## 3- Udhëzimet dhe urdhrat e përhershëm

Ndoshta nuk është e nevojshme të përmendim se këto dhjetë mësime e urdhra nuk i përkasin vetëm fesë islame, sepse të ngjashme me to kanë qenë në të gjitha legjislacionet e mëparshme, pavarësisht se në fenë islame u është kushtuar më shumë vëmendje.

Në të vërtetë, këto dhjetë urdhëresa i percepton ashtu siç janë mendja e ekuilibruar dhe ndërgjegjja e shëndoshë. Thënë ndryshe: Ato janë prej të pavarurave logjike dhe për këtë, ashtu siç përmenden në Kur'an, ato vihen re në një formë apo në një tjetër edhe në legjislacionet e profetëve të tjerë.[2]

## 4- Rëndësia e mirësjelljes ndaj prindërve

Përmendja e bamirësisë kundrejt prindërve - menjëherë

2 Sure "Shura", ajeti 13.

pas luftimit të politeizmit dhe para përmendjes së udhëzimeve e mësimeve të rëndësishme si: ndalimi i vrasjes së njeriut dhe urdhri për zbatimin e drejtësisë - tregon për rëndësinë e madhe që ka e drejta ndaj prindërve në mësimet islame.

Kjo çështje sqarohet më tepër kur shohim se Kur'ani fisnik ka përmendur në vend të ndalimit të bërjes keq prindërve, i cili përshtatet me rrjedhën e këtij ajeti që tregon gjërat e ndaluara, përmend mirësjelljen ndaj prindërve. Kjo do të thotë se jo vetëm shqetësimi i prindërve dhe keqbërja ndaj tyre janë të ndaluara, por ne duhet të sillemi mirë me ta.

Dhe më e bukura nga të gjitha këto, është se fjala "*ihsan*" në këtë ajet është e shoqëruar me germën *"be"* që do të thotë *me*, ku në ajet thuhet: **"...që të silleni mirë me prindërit..."**. Dihet që fjala "*ihsan*", në gjuhën arabe, mund të shoqërohet me germën "*be*" dhe me germën "*ila*". Nëse shoqërohet me germën "*ila*", që do të thotë *për*, kuptimi i saj është: Mirësi për tjetrin, qoftë në mënyrë direkte apo indirekte. Por kur ajo shoqërohet me "*be*", që do të thotë *me*, kuptimi i saj është: Mirësia të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pa ndërmjetësim.

Bazuar në këtë, ky ajet përforcon se çështja e mirësjelljes ndaj prindërve është shumë e rëndësishme dhe e detyron njeriun që ai, në mënyrë të drejtpërdrejtë, të jetë i sjellshëm ndaj prindërve.

**5- Vrasja e fëmijëve për shkak të varfërisë e të urisë**

Përftohet nga këto ajete se arabët, në kohën e injorancës (para Islamit) nuk janë mjaftuar vetëm me vrasjen e vajzave dhe varrosjen e tyre të gjalla, por ata kanë vrarë edhe djemtë e tyre që konsideroheshin një thesar madhështor në shoqërinë e asaj kohe. Këtë e bënin për shkak të fukarallëkut e frikës nga varfëria. All'llahu i Lartësuar ua kthen shikimin atyre tek tryeza e gjerë e begative të Tij, nga e cila përfitojnë prej saj, madje edhe krijesat më të dobëta.

Për fat të keq, kjo vepër e injorancës përsëritet edhe sot në kohën tonë në një formë tjetër, ku vërejmë se si njerëzit qëllimisht i vrasin fëmijët e tyre të pafajshëm me anë të abortit me argumentin e vështirësisë ekonomike.

Kjo çështje dhe çështje të tjera të ngjashme me të na tregojnë se koha e injorancës përsëritet në një formë tjetër dhe se injoranca e shekullit të njëzetë është më e egër se injoranca para Islamit.

**6- Çfarë synohet me fjalën *"feuahish"*?**

*"El Fauahish"* është shumësi i fjalës "*fahishe*" që nënkupton madhësinë e së keqes së gjynaheve. Bazuar mbi këtë, thyerja e premtimit, matja dhe peshimi mangut, politeizmi e të ngjashme me këto, edhe pse janë prej mëkateve të mëdha, përmendja e tyre përballë veprave të shëmtuara është për arsye të ndryshimit konceptual ndërmjet tyre.

**7- Mos iu afroni këtyre gjynaheve!**

Në ajetet në fjalë, fraza **"dhe mos iu afroni"** përmendet në dy vende. Kjo tematikë (ky ndalim) është përsëritur në Kur'an edhe për disa gjynahe të tjera gjithashtu, si: kurvëria, pasuria e jetimëve e të ngjashme me to. Për këtë, Kur'ani i paralajmëron njerëzit që të mos u afrohen këtyre gjynaheve, në mënyrë që të mos bien nën ndikimin e tyre.

**8- Gjynahet e jashtme dhe të brendshme**

S'ka dyshim se fjalia: **"...që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta..."** përfshin të gjitha gjynahet e shëmtuara të dukshme dhe të fshehta. Por në disa hadithe ka ardhur nga Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* se ka thënë: *"E jashtmja është kurvëria dhe e brendshmja është tradhëtia bashkëshortore."*[3] (pra, të kesh të dashura e mikesha

3 Tefsiri "Mexhmaul Bejjan", vëll. 4, f. 191, fundi i ajetit në fjalë.

në mënyrë sekrete e të fshehtë). Është e qartë se përmendja e këtyre transmetimeve është sqarim i vërtetimit të qartë dhe nuk nënkupton kufizimin e këtyre gjynaheve.

**9- Dhjetë këshillat tek jehudinjtë**

Vëmë re në Teurat, në kapitullin e njëzetë të "Seferul Khuruxh" dhjetë dispozita që njihen si këshilla tek jehudinjtë. Ato fillojnë nga fjalia e dytë dhe përfundojnë tek fjalia e shtatëmbëdhjetë e këtij kapitulli.

Por duke krahasuar dhjetë këshillat me ato që kanë ardhur në ajetet në fjalë, sqarohet se ka një dallim të madh ndërmjet këtyre dy programeve dhe për më tepër, nuk mund të jesh i sigurtë që Teurati i sotëm nuk është devijuar në këtë aspekt, ashtu siç është devijuar në pjesët e tjera. Por ajo që duhet të pranojmë është se dhjetë këshillat ekzistuese në Teurat, edhe pse janë të përmbledhura tek çështjet e domosdoshme, ato janë në një nivel shumë të ulët – për nga gjerësia dhe largësia morale, shoqërore e ideoligjike – me përftimin e ajeteve në fjalë.

**10- Si i ndryshuan këto ajete mendimet e njerëzve në Medinen e ndritur?**

Është transmetuar në librin "*Biharul Enuar*" dhe në librin "*E'alamul Uera*", një tregim i bukur që flet për ndikimin e këtyrë ajeteve në shpirtrat e dëgjuesve. Këtu ne po e paraqesim shkurtimisht këtë tregim, ashtu siç ka ardhur në librin "*Biharul Enuar*" të përcjellë nga Ali ibn Ibrahim:

"Es'ad ibn Zurareh dhe Dhekuan ibn Abdu Kajs shkuan në Mekë në një sezon prej sezoneve arabe dhe që të dy ishin nga fisi Khazrexh. Ndërmjet fisit Eus dhe fisit Khazrexh kishte luftë, e cila vazhdoi për një periudhë shumë të gjatë. Nuk i linin armët e tyre as natën dhe as ditën dhe lufta

e fundit ndërmjet tyre ka qenë ditën e dërgimit të Profetit.[4] Es'ad ibn Zurareh dhe Dhekuan shkuan në Mekë duke kërkuar marrëveshje me Eusët. Es'ad ibn Zurareh ishte shok me Utbe ibn Rabiun, kështu që shkoi tek ai dhe i tregoi atij se për çfarë kishte ardhur. Utbe ibn Rabiu i ktheu përgjigje Es'adit: 'Janë larg shtëpitë tuaja nga shtëpitë tona dhe ne jemi të zënë me punë e s'kemi kohë.' Es'adi i tha: 'Çfarë pune keni ju? Ju jeni në vendin e sigurinë tuaj.' Utbe i tha: 'Ka dalë prej nesh një burrë, i cili pretendon se është i dërguari i All'llahut, shan idhujt tanë, shkatërron të rinjtë tanë dhe përçan shoqërinë tonë.'

Es'adi i tha: 'Kush është ai prej jush?' Tha: 'Ibn Abdullah ibn Abdul Mutalib, nga më fisnikët ndër ne dhe me shtëpinë më të madhe.'

Kur e dëgjoi Es'adi dhe Dhekuani këtë, filluan të mendonin për të dhe ra në zemrën e tyre ajo që kishin dëgjuar nga jehudinjtë që ajo ishte koha e Profetit që do të lindte në Mekë e do emigronte në Medine.

Es'adi e pyeti: 'Ku është ai?'

Utbe i tha: 'Ulur mbi gur (guri i Ismailit). Ata (myslimanët) nuk dalin nga strofa e tyre, veçse në sezone, kështu që mos dëgjo prej tij e mos i fol, sepse ai është magjistar e të bën magji me fjalët e tij!' Kjo ishte në kohën e embargos së Beni Hashimit në Shuab.

Es'adi i tha Utbes: 'Atëherë si të veproj se unë kam ardhur për Umre dhe patjetër që duhet të bëj tavaf rreth Shtëpisë?'

I tha: 'Vendos pambuk në veshë!'

Kështu, Es'adi hyri në xhami. Ai i mbushi veshët me pambuk, u rrotullua rreth Shtëpisë dhe i Dërguari i All'llahut qëndronte ulur mbi gur me banorë të Beni Hashimit. Ai e pa atë me një vështrim dhe e kaloi.

Në momentin që ishte në rrethrrotullimin e dytë, tha me veten e tij: 'Nuk ka më injorant se unë. A ndodh një gjë

4 "Kamilun", i Ibn El Ethijr, vëll.1, f. 443.

e tillë në Mekë, që të mos e njoh atë, derisa të kthehem tek populli im e t'i lajmëroj ata?' Kështu që e hoqi pambukun nga veshët dhe e flaku. Ai i tha të Dërguarit të All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)*: 'Një mëngjes sa më të mrekullueshëm!'

I Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* e ngriti kokën drejt tij dhe i tha: 'Na e ka ndërruar All'llahu me një më të mirë sesa kjo që është përshëndetja e banorëve të Xhenetit: Es selamu alejkum *(Paqja qoftë mbi ju!)*?!'

Es'adi i tha: 'Për çfarë thërret, o Muhamed?'

Profeti *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* i tha: 'Për dëshminë se s'ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe unë jam i Dërguari i Tij dhe ju thërras ju ….' (më pas këndoi tre ajetet të cilat përfshijnë dhjetë urdhëresat).

Në momentin që e dëgjoi Es'adi këtë, i tha: 'Dëshmoj se s'ka Zot tjetër përveç All'llahut dhe se me të vërtetë, ti je i Dërguari i All'llahut. O i Dërguari i All'llahut, ti je babai im dhe nëna ime. Unë jam nga banorët e Jethribit (Medines) nga Khazrexhët dhe ndërmjet nesh dhe vëllezërve tanë Eus ka litarë të këputur (pra jemi në armiqësi), kështu që ndoshta All'llahu i lidh ato nëpërmjet teje. Askush nuk është më i lavdishëm sesa ti. Me mua është edhe një burrë nga populli im. Në qoftë se ai e pranon këtë çështje (thirrjen tënde), dëshiroj që All'llahu ta plotësojë çështjen tonë me ty.

Pasha All'llahun! O i Dërguari i All'llahut, kemi dëgjuar për lajmin tënd nga jehudinjtë. Ata na përgëzonin me ardhjen tënde e na lajmëruan për cilësitë e tua. Uroj që të jetë shtëpia jonë shtëpia e imigrimit tënd tek ne! Këtë na e kanë mësuar jehudinjtë. E falënderoj All'llahun që më mundësoi udhëtimin drejt teje. Pasha All'llahun! Nuk kam ardhur për gjë tjetër, veçse të kërkoj aleat për popullin tonë. Na ka dhënë All'llahu nga gjërat më të mira që jepen.'

Më pas, shoku i Es'adit, Dhekuani, gjithashtu e pranoi Islamin. Më pas, kërkuan nga i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* që të dërgonte bashkë me ta një burrë që t'i mësonte atyre Kur'anin, e t'i thërriste njerëzit në çështjen e tij e t'i shuante luftrat. Kështu, i Dërguari i All'llahut *(Paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)* dërgoi me ata të dy në Medine Mus'ab ibn Umejrin." Që në atë kohë u themeluan bazat e Islamit në Medine dhe ndryshoi fytyra e Jethribit (Medines).

**Muhsin Keraeti**

# TA NJOHIM MË TEJ KUR'ANIN
# Mësime nga surja "Bekare"

**Abstrakt**

*Në ajetet kur'anore ka shumë mësime. Në këtë artikull ka disa mësime nga surja "Bekare", si: Respektimi i drejtësisë është i nevojshëm edhe në luftë dhe nuk guxojmë t'i shkelim kufijtë e Zotit; Islami është fe e ekuilibrit dhe e mesatares; Këtë botë dhe Botën Tjetër i ka vendosur pranë njëra-tjetrës, në mënyrë që të mos mendohet se myslimani nuk mendon për zhvillimin dhe mirëqenien e tij e të shoqërisë; Paqja dhe qetësia e vërtetë mund të arrihen vetëm nën hijen e besimit të vërtetë në Zotin e Madhëruar; Pa besim lufta dhe pasiguria asnjëherë nuk do të largohen nga toka etj.*

**(Ajetet 190 – 199)**

**"Luftoni në rrugën e Allahut ndaj atyre që luftojnë kundër jush, por mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin."**

**"Vritini ata kudo që t'i gjeni dhe dëbojini prej vendeve, ashtu siç ju dëbuan ata ju. Mosbesimi është më i rëndë se vrasja. Mos luftoni me ata pranë Xhamisë së Shenjtë** (Qabesë)**, përveç rastit kur ata ju sulmojnë aty brenda! E, nëse ata luftojnë me ju aty, atëherë vritini ata! I këtillë duhet të jetë ndëshkimi për jobesimtarët."**

**"Por, në qoftë se ata heqin dorë, atëherë Allahu është**

**vërtet Falës dhe Mëshirëplotë."**

**"Luftojini ata derisa të zhduket mosbesimi dhe deri sa të mbretërojë besimi vetëm për Allahun! Por, në qoftë se ata heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë s'ka armiqësi, përveçse kundër keqbërësve."**

**"Shkelja e muajit të shenjtë do të shpaguhet me shkelje të muajit të shenjtë, por dhe shkelja e të shenjtave do të ndëshkohet në të njëjtën mënyrë. Pra, kushdo që ju sulmon, edhe ju keni të drejtë ta sulmoni atë, ashtu siç ju sulmoi ju! Frikësojuni Allahut dhe dijeni se Allahu është me ata që ruhen nga të këqijat."**

**"Shpenzojeni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit."**

**"Kryejeni Haxhin dhe Umren për hir të Allahut! Nëse në këtë rrugë pengoheni, atëherë therni kurban, sipas mundësisë, dhe mos i rruani kokat tuaja, derisa të arrijë kurbani në vend! Cilido prej jush që është i sëmurë ose që ka ndonjë plagë në kokë** (dhe si i tillë, nuk mund ta rruajë kokën)**, le ta zëvendësojë me agjërim, lëmoshë ose kurban. Kur të jeni të sigurt** (nga armiqtë)**, ai që prej jush kryen Umren deri në Haxh, le të therë kurban, sipas mundësisë. Ndërsa ai që nuk ka mundësi, është i detyruar të agjërojë tri ditë në Haxh dhe shtatë ditë pas kthimit nga Haxhi; këto janë dhjetë ditë të plota. Kjo është për ata që nuk banojnë në Mekë. Kijeni frikë Allahun dhe dijeni se Ai dënon ashpër."**

**"Koha e haxhillëkut është në muaj të caktuar. Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet** (me gruan)**, grindjet dhe sharjet. Ndërkaq, çdo vepër të mirë që bëni, Allahu e di. Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për**

**rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!"**

**"Nuk është gjynah të kërkoni nga Zoti juaj ndonjë të mirë. E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta! Përmendni Atë që ju ka udhëzuar në rrugën e drejtë, sepse ju më parë ishit të humbur!"**

**"Mandej, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët dhe kërkoni ndjesë prej Allahut! Se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë."**

*Nga këto ajete mësojmë se:*

1- Xhihadi duhet të kryhet në rrugën e Zotit dhe për Zotin, e jo për zgjerimin e shtetit apo në bazë të mosmarrëveshjeve etnike apo racore.

2- Respektimi i drejtësisë është i nevojshëm edhe në luftë dhe nuk guxojmë të shkelim kufijtë e Zotit.

3- Përballuni me ata të cilët shfrytëzojnë çdo mjet për t'i goditur dhe dëmtuar myslimanët dhe Islamin, dhe mos lejoni që ata të thurin komplote dhe të fusin përçarje midis jush.

4- Shtëpia e Zotit është e shenjtë dhe e vlefshme, mirëpo edhe respektimi i gjakut të myslimanët është i vlefshëm.

5- Për të përhapur fenë e Zotit në tokë duhet të luftojmë kundër sunduesve shtypës të cilët përhapin bindje të gabuara në shoqëri.

6- Për këdo dhe në çdo kohë, rruga e kthimit është e hapur për të gjithë, madje edhe për armikun jobesimtar, nëse ai ndryshon bindjen dhe sjelljen e tij, Zoti e falë atë.

7- Armiku është vazhdimisht në pritë. Nuk duhet të lejojmë që armiqtë të abuzojnë me rastet.

8- Marrëveshjet dhe rregullat shoqërore janë të respektuara, përderisa edhe pala tjetër i respekton dhe nuk përpiqet të abuzojë me to.

9- Drejtësia dhe sinqeriteti duhet të respektohet edhe në përballje me armikun dhe nuk na lejohet që t'i shkelim kufijtë.

10- Sa herë që në një shoqëri të mbisundojë koprracia dhe kapitalizmi, ajo shoqëri do të përballet me rrezikun e shkatërrimit.

11- Çdo vepër që dëmton shpirtin e njeriut dhe në njëfarë mënyrë shërben për shkatërrim, ajo është e ndaluar.

12- Në Islam nuk ka qorrsokak dhe në përputhshmëri me mundësitë dhe kushtet, ai parashtron rregulla dhe ligje. Personi, i cili nuk ka mundësi të vazhdojë ritualet e Haxhit, si kompensim mund të agjërojë, të japë lëmoshë (sadaka) apo të therë kurban.

13- Meka është qendra e sigurisë, unitetit dhe ibadetit. Pra, gjatë muajit të Haxhit, ky ambient duhet të ruhet i pastër nga çdo përleshje, mëkat apo kënaqësi seksuale me qëllim që të krijohen kushtet për afrimin më pranë Zotit.

14- Islami është fe globale dhe përkrah çështjeve spirituale dhe ato të adhurimit, i kushton rëndësi edhe jetës materiale dhe përfitimit të njeriut.

15- Gjatë udhëtimit duhet të përfitojmë nga begatitë material, mirëpo nuk duhet harruar Zoti.

16- Gjatë kryerjes së Haxhit, njerëzit duhet t'i lënë menjëanë postet dhe titujt e tyre, dhe të gjithë të bashkuar e përkrah njëri-tjetrit duhet ta kryejnë këtë ritual.

**(Ajetet 200 – 214)**

**"Pasi t'i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër! Disa njerëz thonë: 'Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!' Por, për këta, s'ka asnjë të mirë në Botën Tjetër.'"**

**"Por ka dhe të tjerë që thonë: 'Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në Botën Tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit** (të Xhehenemit)**.'"**

**"Këtyre do t'u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari."**

**"Dhe madhëroni Allahun në** (tre) **ditët e caktuara** (të Teshrikut)**. Por, edhe ata që nguten dhe rrinë vetëm dy ditë** (në Mina)**, nuk bëjnë gjynah; nuk bën gjynah as ai që rri më shumë, nëse i frikësohet vërtet Allahut. Ta keni frikë Allahun e ta dini mirë se vetëm tek Ai do të tuboheni!"**

**"Ka ndonjë njeri** (hipokrit)**, fjalët e të cilit në jetën e kësaj bote ta bëjnë qejfin dhe që betohet në Allahun për atë që mban në zemër, por që, në të vërtetë, është kundërshtari** (yt) **më i betuar."**

**"E, kur largohet, përpiqet të bëjë të këqija në tokë, duke shkatërruar të mbjellat dhe bagëtinë. Por Allahu nuk e do shkatërrimin."**

**"Kur atij i thuhet 'Kije frikë Allahun!', ai mburret dhe bën më shumë të këqija. Atij i mjafton Xhehenemi. Eh, sa vendbanim i keq është ai vend!"**

**"Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i Mëshirshëm me robtë e Vet."**

**"O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku**

**juaj i përbetuar."**

**"E, nëse i shmangeni së drejtës, pasi ju kanë ardhur prova të qarta, atëherë dijeni se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**

**"E ç'presin tjetër ata, që t'u vijë Allahu përmes hijeve të reve bashkë me engjëjt?! Atëherë merr fund puna! Tek Allahu kthehen të gjitha punët."**

**"Pyeti bijtë e Izraelit: sa shenja të qarta u kemi dërguar Ne atyre? Ata që mohojnë të mirat e Allahut, pasi u janë dërguar, do të dënohen. Vërtet, Allahu është i rreptë në ndëshkim."**

**"Ata që nuk besojnë, janë të joshur nga jeta e kësaj bote, prandaj tallen me besimtarët. Por njerëzit që i frikësohen Allahut, do të jenë mbi ata - në Ditën e Kiametit. Allahu begaton pa kufi kë të dojë."**

**"Dikur, të gjithë njerëzit përbënin një bashkësi të vetme. Pastaj Allahu u dërgoi profetët me lajme të mira dhe paralajmërime. Bashkë me ata, Ai zbriti edhe Librin me të vërtetën, për t'i gjykuar njerëzit në çështjet për të cilat nuk pajtoheshin. Mirëpo, njerëzit u grindën midis tyre, pasi u erdhën shenjat e qarta, nga zilia që kishin për njëri-tjetrin. Atëherë, me vullnetin e Vet, Allahu i udhëzoi besimtarët që ta kuptonin të vërtetën, lidhur me çështjet për të cilat të tjerët nuk pajtoheshin. Allahu shpie në Udhë të drejtë kë të dojë."**

**"Vërtet mendoni të hyni në Xhenet, pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjerimi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i dërguar dhe ndjekësit e tij, thirrën: 'Kur do të arrijë ndihma e Allahut?!' Ja, ndihma e Allahut është afër!"**

*Nga këto ajete mësojmë se:*

1- Në lutje dhe kujtimin e Zotit nuk duhet të mendojmë vetëm për disa ditë të kësaj bote.

2- Islami është fe e ekuilibrit dhe mesatares, këtë botë dhe Botën Tjetër i ka vendosur pranë njëra-tjetrës, në mënyrë që të mos mendohet se myslimani nuk mendon për zhvillimin dhe mirëqenien e tij e të shoqërisë.

3- Nga Zoti të kërkojmë vetëm të mira dhe lumturi, sepse ne nuk kemi njohuri për të ardhmen dhe për atë se ç'ka është e dobishme për ne.

4- Nëse njeriu është i devotshëm, Zoti ia lehtëson punët duke ia pranuar veprat, sadopak qofshin ato, si dhe ia mbulon të metat dhe gabimet e punëve të tij.

5- Nuk duhet të mashtrohemi nga pamja e bukur, fjalët e bukura dhe propagandat tërheqëse, por duhet të ndalemi dhe të shikojmë qëllimet që ndjek ai me këto fjalë, a na forcon materializmin me këto fjalë apo na orienton drejt Zotit.

6- Në përballje me të tjerët, nuk duhet të dëgjojmë vetëm fjalët e tyre, por duhet të shikojmë edhe veprimtarinë e tyre, a punojnë në interes të shoqërisë apo bëhen shkak për zgjerimin e çrregullimeve në shoqëri.

7- Prej arsyes të përsëritjeve të mëkatëve janë disa faktor si: kokëfortësia, mendjemadhësia dhe euforia përballë të vërtetës, këto bëhen shkak që njeriu në vend të pendimit, vazhdon të këmbëngulë në kryerje e mëkatëve.

8- Besimtari vepron, lidh besë dhe marrëveshje me Zotin dhe ai vazhdimisht është në kërkim të kënaqësisë së Zotit. Kurse hipokriti lidh besë dhe marrëveshje me botën dhe ai

është në kërkim të kënaqësive të kësaj bote.

9- Paqja dhe qetësia e vërtetë mund të arrihen vetëm nën hijen e besimit të vërtetë në Zotin e Madhërishëm. Pa besim dhe duke u mbështetur në ligjet njerëzore, lufta dhe pasiguria asnjëherë nuk do të largohen nga toka.

10- Djalli është armiku i unitetit dhe çdo ftesë përçarëse buron nga shpirti djallëzor.

11- Kërkesa për të parë Zotin është një kërkesë e kotë dhe vetëm një pretekst. Besimi në Zot ka vlerë atëherë kur të jetë i bazuar në logjikë dhe ndërgjegje.

12- Materializmi dhe dhënia pas kësaj bote sjell mendjemadhësi dhe bëhet shkak që njeriu t'i vështrojë me sy nënçmues të tjerët. Kurse besimi dhe devotshmëria sjell lumturinë e njeriut në këtë botë dhe Botën Tjetër duke mundësuar përfitimin nga begatitë e panumërta të Allahut.

13- Shoqëria ka nevojë për ligje dhe udhëheqës, kurse ligjet më të mira janë librat e shenjtë dhe udhëheqësit më të mirë janë Profetët dhe udhëheqësit fetarë.

14- Rruga më e mirë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis njerëzve në çështje të ndryshme familjare dhe shoqërore është dorëzimi përballë ligjeve të Zotit.

15- Pritja për të shkuar në Xhenet pa asnjë lloj vështirësie, është pritje e kotë.

16- Sprovat janë një traditë e pakontestueshme e Zotit për të gjithë njerëzit, në mënyrë që çdo njeri të kuptojë dhe të tregojë vlerën e tij të vërtetë.

**Ali Muhamed Ali Duhajjil - Dehili**

# HISTORI E PROFETËVE

## Historia e profetit Musa dhe Harun
*(Paqja qoftë mbi ta!)*[1]

**Abstrakt**

*Një ndër historitë më të shquara dhe madhështore që tregon Kur'ani, është ajo e profetit Musa (Paqja qoftë mbi të!). Historia e këtij Profeti tregohet në shtatëdhjetë e tri vende në Kur'an. Profeti Musa është nderuar nga Zoti, pasi i ka folur drejtpërdrejt, pa ndërmjetës. Zoti i Madhëruar thotë:* **"Trego në Libër edhe për Musanë! Njëmend, Ai ishte i përzgjedhur, ishte i dërguar dhe profet."** *("Merjem", 51) Musai (Paqja qoftë mbi të!) ishte i përzgjedhur prej Zotit dhe në shërbim të Tij, larg cytjeve dhe tundimeve të shejtanit. Lidhur me fuqinë dhe forcën e tij fizike, thuhet se ishte e barabartë me atë të dhjetë burrave. Musai (Paqja qoftë mbi të!) kishte vështirësi në të folur. Këtë fakt e përmend dhe Faraoni, i cili u drejtohet këshilltarëve duke e tallur Musanë:* **"Vallë, a nuk jam unë më i mirë se ky i mjerë, i cili mezi mund të shprehet?"** *("Zuhruf", 52). Por kjo e metë nuk e pengoi të zgjidhej i dërguar i Zotit dhe profet. Edhe vetë Musai e pranon këtë të metë në të folur në një ajet:* **"Vëllai im, Haruni, është më gojëtar se unë në të folur."** *("Kasas", 34) Profeti Musa dhe vëllai i tij, profeti Harun kishin si synim udhëzimin e beni israilëve.*

Pasi profeti Jakub *(Paqja qoftë mbi të!)* bashkë me familjen e tij vizituan Egjiptin, ata vendosën të jetonin atje. Egjipti ishte një vend i mirë dhe i përshtatshëm për ta. Profeti Jakub, njihej gjithashtu edhe me emrin Izrael, që ka kuptimin rob i Zotit,

1 Pjesa e parë e historisë. Vijon në numrin e ardhshëm.

kështu që në Egjipt bijtë e tij i quajtën bijtë e Izraelit. Në çastet e fundit të jetës, i shtrirë në shtrat, Jakubi thirri bijtë e tij dhe i pyeti: "Bijtë e mi! Unë po vdes, shpirti im po shtegton për në Botën Tjetër, kurse trupi im do bëhet dhé. Po unë kam një shqetësim. Pasi të vdes unë, ç'do të bëhet me ju? Ç'rrugë do ndiqni?"

- "Rrugën tënde e të të parëve të tu, baba. Të premtojmë se nuk do të ndahemi nga rruga e Zotit tënd, të Is'hakut, Ismailit, Ibrahimit, Zotit të vetëm, Krijuesit solid, që ne i jemi përkushtuar me gjithë qenien tonë!", - iu përgjigjën të bijtë.

I qetësuar nga këto fjalë, profeti Jakub dha shpirt. Kishte lënë porosi ta varrosnin në tokat e Palestinës. Pasi bijtë e dërguan trupin e tij dhe e varrosën në Palestinë, zgjodhën të ktheheshin sërish në Egjipt, pranë Jusufit. Begatia dhe pasuria e një shteti aq të fuqishëm për kohën, siç ishte Egjipti, ishte shumë tërheqëse. Atje u martuan e krijuan familjet e tyre, u bënë me fëmijë, e dita-ditës u shtuan më shumë.

Vitet rridhnin me shpejtësi. Baballarë, bij, nipër, stërnipër. Popullsia ishte shtuar. Mirëpo në ndjekje të përfitimeve të kësaj bote e të ndonjë pozite të mirë, ata i harruan plotësisht porositë e Jakubit. Numri i besimtarëve të devotshëm prej tyre ishte shumë i vogël. Ndërkohë, në krye të Egjiptit kishte ardhur një sundimtar tiran, Faraoni, që nuk i linte të merrnin frymë të qetë. Ushtronte dhunë mbi ta, i nënçmonte e nuk u jepte asnjë farë të drejte. Sjellja e këtij Faraoni ishte edhe sprovë për ata, por edhe një tërheqje vëmendjeje, që të shkundeshin e t'i ktheheshin rrugës së të parëve të tyre. Ndërsa Faraoni e familja e tij jetonin në luks të paparë ndonjëherë, izraelitët i kishte lënë në mjerim dhe i përdorte si skllevër.

Faraoni pretendonte se ishte perëndi, ndaj kërkonte që të gjithë t'i bindeshin e ta adhuronin.

Një ditë, orakujt kishin bërë një parashikim që mund të quhej fatal për Faraonin dhe për vendin. Sipas parashikimeve,

një djalë që do lindte nga izraelitët, në të ardhmen do të shkatërronte gjithë pushtetin e Faraonit. I zemëruar, u ngrit në këmbë dhe dha një urdhër që i kalli tmerrin të gjithëve: "Që tani, çdo djalë që do t'u lindë izraelitëve, do të vritet në vend!" Urdhri mori dhenë dhe nisi të zbatohej menjëherë. Nënat shtatzana ishin llahtarisur. Pikërisht, në njërën prej këtyre ditëve të tmerrshme, në një shtëpi të Izraelitëve lindi një djalë. Ai djalë, që kur të rritej, do të shkatërronte pushtetin e Faraonit, ishte Musai. Prindërit e tij ishin nga ata të paktë besimtarë të devotshëm që kishin mbetur nga bijtë e Izraelit. E ëma dridhej gjithë tmerr se mos ia shihnin beben e porsalindur e ia vrisnin. Një mbrëmje, nëna e re dëgjoi një zë të çuditshëm, një zë që më tepër i ngjante një frymëzimi të brendshëm që vjen nga thellësia e shpirtit: "*Sapo të shohësh se jeta e fëmijës tënd është në rrezik, lëshoje mbi ujë. Mos ki frikë, mos u merakos! Ne do e sjellim atë sërish te ti. Ai është njeri i zgjedhur, profet.*"

Bashkë me zërin heshtën edhe tmerret e nënës së re. Një qetësi e lumtur e pushtoi të tërën dhe i lidhi gjithë shpresat me atë zë të mëshirshëm. Pasi i dha birit të pijë gji për herë të fundit, e puthi fort dhe e vuri në kanistër. Tok me të shkoi në breg të Nilit dhe me guxim e lëshoi shportën në lumë.

Ajo e dinte se mëshira e Zotit do e ruante djalin e saj më së miri. Sapo kanistra ciku lumin, rrjedha u ngadalësua dhe me ëmbëlsi, lumi përkundi Musain si një djep. Zoti urdhëroi lumin të mos i bënte keq Musait, po ta mbarte me siguri deri në vendin e paracaktuar, në pallatin e Faraonit, ku e priste një qetësi e rehati e paimagjinueshme.

Në kopshtin e bukur që ndodhej në mes të pallatit dhe brigjeve të Nilit, gruaja e Faraonit kishte dalë si zakonisht për të bërë shëtitjen e mëngjesit. Një dëshirë e pakuptimtë e shtynte të ecte e ta zgjaste shëtitjen më tepër se zakonisht. Ajo ishte shumë ndryshe nga i shoqi. Faraoni ishte mohues dhe ateist, kurse ajo ishte një besimtare e bindur dhe e devotshme.

Ai ishte mizor dhe i pamëshirshëm, kurse ajo ishte e ëmbël dhe e dhimbsur. Ishte shumë e bukur, po në fytyrë gjithmonë i dalloheshin gjurmët e një trishtimi. As pasuria e pafund e pushteti i të shoqit, as dhuratat e shtrenjta që merrte, as bukuria nuk arrinin ta lumturonin. Sa dëshironte të kishte një fëmijë! Ndoshta një fëmijë kishte për ta lumturuar zemrën e saj të trishtuar. Zoti nuk i kishte falur fëmijë dhe ajo e vuante këtë.

Duke ecur, Asias i zunë sytë një kanistër që lundronte në Nil. Urdhëroi menjëherë shërbëtorët që e shoqëronin ta merrnin dhe t'ia sillnin atë kanistër. Kur e hapi, brenda pa fytyrën e bukur e të ndritshme të një foshnjeje. Ndjeu t'i dridhej zemra dhe një dashuri e jashtëzakonshme e pushtoi për foshnjën. Nuk i mbajti dot lotët. Foshnja nuk pushonte së qari, ndërsa Faraoni u çudit tek pa të shoqen me një foshnjë të vogël, të cilën e puthte gjithë dashuri. Faraoni i habitur, iu afrua dhe e pyeti se ç'ishte ai fëmijë? Kur Asia i tha se e kishte gjetur brenda një kanistre në breg të lumit, Faraoni u nxeh.

- "Mos e vrit, të lutem! Ndoshta bëhet një shkas lumturie dhe për mua dhe për ty. Le ta mbajmë, le ta rrisim ne këtë fëmijë. Të lutem! Ndoshta bëhet i mbarë, bëhet bir për ne!" - i tha Asia duke e shtrënguar foshnjën fort.

Faraoni kishte mbetur i shtangur nga sjellja e së shoqes. Si mund ta donte kaq fort një fëmijë të gjetur në lumë? Ai vendosi t'ia plotësonte së shoqes këtë dëshirë dhe e lejoi ta merrte e ta rriste në pallat.

Musai i vogël qante sërish. Atëherë ata u kujtuan se ai ishte i uritur. Faraoni urdhëroi që të sillnin menjëherë ato gra që kishin fëmijë në gji me qëllim që ta ushqenin, por Musai nuk pranonte të pinte. Asia u mërzit, po nuk ishte vetëm Asia ajo që qante e pikëlluar për djalin e vogël. Në brigjet e larta të Nilit qante zemërplasur edhe nëna e pikëlluar e Musait. Kushedi ku e kishin shpënë valët e lumit kanistrën me djalin e saj të vogël. Asnjë fjalë në lidhje me të, asnjë lajm. Thirri të bijën: "Shko

bijë, gjer te pallati i Faraonit dhe shih mos merr vesh ndonjë gjë për një bebe mbi ujë. Çfarëdo që të ketë ndodhur, lajmi aty shkon më parë! Po kujdes, se mos dyshojnë për ty!"

Motra e Musait shkoi gjer në pallat pa rënë në sy. Aty mësoi për beben e gjetur, e pa nga larg, i dëgjoi zërin e të qarat. Aty mësoi dhe për të qarat e tij të vazhdueshme prej urisë. Të gjithë në pallat shkonin e vinin të shqetësuar pa ditur ç'të bënin. Atëherë vajza iu afrua mbretëreshës.

"Madhëri, unë njoh dikë që ka qumështin shumë të mirë, ndoshta ajo mund të kujdeset për këtë fëmijë!"

"Në qoftë se ti gjen dikë që të mund ta mëndë këtë fëmijë, të premtoj se do të të shpërblej shumë mirë. Do të të plotësoj çfarëdo dëshire që ti të kesh."- i tha mbretëresha.

Vajza shkoi në shtëpi, mori të ëmën dhe me ngut erdhën në pallat. Sapo e ëma e afroi në gji, Musai, pa u grindur aspak, filloi të pinte qumësht i qetë. Mbretëresha sa nuk fluturonte nga gëzimi.

"Merreni, ju lutem, këtë fëmijë! Le të rrijë me ju për sa kohë ka nevojë për qumësht. Dhe unë do ju paguaj shumë mirë për këtë!"- tha Asia.

Zoti ia kishte kthyer prapë të birin nënës së përmalluar. Fëmija rritej më së miri. E ëma e mëndte, mbretëresha e shikonte e kënaqej me të sa herë donte. Kur e ndërpreu nga gjiri, e ëma ia dorëzoi Musanë sërish mbretëreshës. Rritja e Musait do të vazhdonte në pallat.

Logjika dhe vullneti hyjnor kishin bërë që gjithçka të organizohej më së miri e Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* të edukohej nga dijetarët më të mëdhenj të kohës, në kushtet më të mira, madje në pallatin e Faraonit. Aty mësoi shumë shkenca të kohës. Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* e dinte se nuk ishte biri i Faraonit. Një ditë, kishte dalë nga pallati dhe shëtiste nëpër rrugët e qytetit. Në një cep të zbrazët të rrugës pa dy njerëz që po ziheshin. Musai vendosi të ndërhynte për t'i dhënë fund

grindjes. Ai u afrua, e tërhoqi nga këmisha njërin prej tyre dhe e goditi. Njeriu u përplas në cep të rrugës dhe aty për aty, dha shpirt në vend. Musai nuk kishte pasur asnjë qëllim ta vriste. "O më i Larti! Pa dyshim që unë dëmtova më shumë vetveten. Më fal!" - u lut Musai.

Zoti i Dijes dhe i Mëshirës e dinte shumë mirë qëllimin e Musait, ia njihte shumë mirë zemrën. Pendesa e Musait u pranua dhe Zoti ia fali gabimin, se ai nuk kishte pasur për qëllim as krimin dhe as dhunën.

Faraoni e mori vesh lajmin. Ai mezi e kishte pritur këtë rast. Dha urdhër ta kapnin menjëherë Musanë dhe ta ekzekutonin.

Ndërkohë Musai vendosi të fshihej në një vend të sigurt jashtë qytetit dhe nuk ia tregoi askujt vendndodhjen e vet, veç një mikut besnik, i cili e furnizonte me ushqime dhe i sillte lajmet e fundit. Një ditë, miku vrapoi pa frymë te Musai: "Musa, kanë përgatitur gjithçka për të të gjetur. Kam frikë për ty. Po të gjetën, të zhdukin menjëherë. Largohu menjëherë nga Egjipti. Veç kështu mund të jesh i sigurt!"
Musai nuk e zgjati shumë, por dëgjoi mikun e vet dhe vendosi të largohej.
"O Zot, shpëtomë nga e keqja e mizorëve dhe e kriminelëve!" - u lut ai.

Pastaj mori rrugën. Largimi i tij kishte ndodhur shumë papritur. Nuk kishte asgjë me vete. As një kalë të kalëronte dhe as karvan që t'i bashkohej. E priste një rrugë e gjatë, plot rreziqe e të papritura nëpër shkretëtirën e egër. Musai kishte vendosur të shkonte në qytetin e Medjenit.

Lodhjen e kishte të papërshkrueshme, rrobat i ishin vjetruar, etja dhe uria e kishin shkatërruar. Iu afrua një pusi për të mbushur barkun me ujë, kështu uria mund t'i shuhej ndopak. Mes barinjve që ruanin dhentë, vuri re edhe dy vajza të reja, që me vështirësi mblidhnin bagëtitë e veta. Ata kishin

shumë nevojë për ndihmë, dhentë po u iknin, i ishin ngatërruar me tufat e të tjerëve e vajzat nuk po i ndanin dot.

Musait i bënë shumë përshtypje këto vajza, që megjithëse ruanin dhentë, kishin një brishtësi e delikatesë të jashtëzakonshme. Në përgjithësi barinjtë ishin djem, duke qenë se ishte punë e vështirë dhe e lodhshme. Më e vogla e vuri re habinë e Musait.

“Babai ynë është shumë i moshuar dhe nuk ia lejon shëndeti të dalë me ne në kullota. Vëllezër nuk kemi. Prandaj jemi vetëm.”

“Më lejoni ta bëj unë punën tuaj për sot” - u tha Musai. Vuri delet para dhe iu afrua pusit. Po barinjtë e tjerë, kishin mbaruar punën e vet dhe e kishin mbyllur grykën e pusit me një gur të rëndë, që të mos ndotej uji. Guri ishte aq i rëndë, sa mezi mund ta luanin nga vendi disa burra. Por Musai ishte në gjendje ta luante vetë. I dha deleve ujë, mbylli pusin prapë dhe u nis të kthehej pranë vajzave. Por etja edhe uria i vazhdonin me gjithë forcën.

-“O Zoti im, o më i Larti! Kam mbetur i pafuqishëm, i vobektë. Vetëm Ti mund të më ndihmosh, O Zoti im. Zgjate dorën Tënde të mëshirës drejt meje!” – lutej ai.

Kur u kthyen në shtëpi, i ati i pyeti vajzat dhe ato i treguan se si i kishte ndihmuar një i panjohur.

“Atëherë shkoni tek ai dhe i thoni se të kërkon babai ynë!” – tha babai i urtë. –“Duhet ta shpërblej për punën që ka bërë.”

Vajza vrapoi aty ku kishte lënë Musanë. Ndihej në ankth. Kur dëgjoi fjalët e vajzës, Musai u ngrit në këmbë dhe buzëqeshi. Nuk kundërshtoi dhe nga sjellja fisnike ecte para vajzës.

Arritën te shtëpia. Kur u takua me babanë e vajzave, që të dyve u ndritën sytë. Profeti Shuajb *(Paqja qoftë mbi të!)* dalloi në sytë e djalit që i kishte ardhur mik, atë vezullimin e

mahnitshëm, që askush nuk e njihte më mirë se ai.
Shuajbi u kthye nga Musai, që po bëhej gati të dilte:
"Musa, kam një propozim për ty. Në qoftë se rri këtu e bëhesh ndihmësi ynë për tetë vjet, do të të martoj me njërën prej vajzave të mia e do të të mbaj si bir. Po ndenje dhjetë vjet, kjo tregon mirësinë e bujarinë tënde. Po unë nuk dua të të mbaj të lidhur, ti e di vetë. Po as mirësia, as bujaria ime, nuk ka për të të munguar."

Musait *(Paqja qoftë mbi të!)* i qeshi fytyra. Ky propozim ishte dashamirësia e Zotit vetë. Ai nuk ngurroi aspak dhe pranoi. Ai u martua me vajzën e vogël dhe për dhjetë vjet me radhë i shërbeu Shuajbit me një zell shembullor. Dhjetë vite kaluan shpejt dhe koha e ndarjes erdhi. Musai bashkë me nusen e tij nisën përgatitjet për Egjipt.

Musai ishte rrugës bashkë me familjen e tij. Ishte dimër, ftohtë. Kishin humbur. Ai dhe familja kishin mbetur në mes të ftohtit të shkretëtirës së Sinas. Musai futi familjen e vet pas një dune rëre dhe me dy gurë u mundua të ndizte zjarr, po ishte e pamundur. Era i shuante menjëherë xixat e dobëta që lëshonin gurët. Gruaja dhe fëmijët po dridheshin nga të ftohtët. Ngriti kokën dhe hodhi vështrimin tej, në horizont. Diçka kërkonte. Diku larg dalloi një dritë. Me vrull kërceu nga vendi.
"Zjarr! Pashë zjarr!" – tha ai.

Pasi porositi të vetët ta prisnin aty pa luajtur nga vendi, u nis drejt dritës. Do shkonte të merrte pak zjarr dhe t'i pyeste ata njerëz, a karvan, a ç'të ishin se në ç'anë të shkretëtirës ishin dhe si mund ta gjenin rrugën sërish. Eci gjer në luginën Tuva, në të djathtë të kodrës Tur. Vendi ku arriti ishte shumë i çuditshëm. Aty nuk kishte as ftohtë, as shi. Një qetësi misterioze, e thellë, kishte mbuluar gjithçka. Më në fund, Musai arriti te burimi i dritës. Por një zë i fortë, që buçiste anembanë, shpërtheu në gji të natës:

*"Allahu, Zoti i botëve, më i Larti i të lartëve, është larg prej çdo*

*të mete dhe Pronar i vetëm i mrekullive pa fund.”*

Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* kishte shtangur në vend. Zemra i rrihte fort dhe gjithë trupi i dridhej. Zëri misterioz jehonte nga çdo anë. Kur e mblodhi veten disi dhe i hodhi sytë nga zjarri, habia iu shtua edhe më fort. Mu në mes të zjarrit ndodhej një pemë mrekullisht e gjelbër. Në mes të zjarrit ajo as digjej, as thahej, veçse bleronte magjishëm. Me gjithë ngrohtësinë e zjarrit që e ndiente aq afër e me djersët që i rridhnin çurg, Musai vazhdonte të dridhej. Pema ndodhej në të majtë të kodrës, nga lugina Tuva. Një dallgë e mrekullueshme drite kishte pushtuar çdo anë. Musai nuk rezistoi dot më, por mbuloi sytë me duar. “Ç’të jetë kjo, dritë a zjarr?” pyeti veten.

Papritur qielli e toka nisën të dridheshin me një forcë të paparë. Ishte Zoti i Plotfuqishëm, Krijuesi i qiellit e i Tokës, Ai që fliste.

-“Musa!”

-“Urdhëro!” - mezi tha me zë të mekur.

- “Unë jam Zoti yt!”.

-“Po. Unë besoj. Je Zoti im.”

“Gjendesh në Tokën e Shenjtë të Luginës Tuva, hiqi këpucët!”

Duke u përkulur me nderim të thellë, Musai hoqi këpucët.

“Ty të kam zgjedhur Profetin Tim! Prandaj dëgjoje me vëmendje shpalljen! Unë jam Zoti dhe nuk ka zot tjetër veç Meje. Prandaj adhurimin ma drejto vetëm Mua! Falu, për të më kujtuar Mua! Pa dyshim që ora e fundit e botës do të vijë, vetëm se Unë e kam fshehur atë. Po jua them që do të vijë dhe çdo njeri ta dijë mirë përfundimin e veprave që kryen në këtë botë dhe të sillet sipas kësaj. Ruaju, të mos të të tërheqin pas vetes ata njerëz që nuk i besojnë këto dhe që shkojnë pas dëshirave e joshjeve të vetvetes e të mos të të ndajnë ty nga rruga e Zotit! Se pastaj bëhesh edhe ti nga të shkatërruarit.”

- “Ç’është ajo gjë që mban në dorën e djathtë, o Musa?”

- "Është bastuni im", - u përgjigj Musai me zë të dridhur. - "E mbaj gjithmonë, mbështetem kur ec, më ndihmon për ndonjë punë…"
- "Lëshoje, Musa!"

Musai e lëshoi shkopin përdhé, por mbeti pa frymë nga ato që pa. Bastuni lëvizi si i gjallë, u përdrodh dhe u kthye në një gjarpër gjigant. Musait po i dridhej trupi dhe zemra. Nuk i rezistoi dot asaj pamjeje dhe nisi të vraponte së prapthi.

"Mos u tremb Musa! Profetët nuk kanë frikë. Afrohu sërish dhe qetësohu! Ji i sigurt në praninë Time!"

Musai ndaloi dhe u kthye të shihte ç'bëhej. Bastuni ende lëvizte.

"Kape!" - e urdhëroi Zoti. - "Dhe mos ki frikë! Do ta kthejmë atë në gjendjen e parë!"

Musai mezi qëndronte kur u zgjat për të prekur gjarprin. Sapo e ciku, ai u kthye sërish në shkopin e zakonshëm.

Zoti vazhdoi të fliste me Musanë.

"Tani fute dorën në gjoksin tënd, o Musa! Do të shohësh një tjetër mrekulli. Kur ta nxjerrësh prapë, ajo do jetë e shndritshme, marramendëse. Sapo t'i vendosësh duart mbi gjoks, frika jote do të shuhet."

Musai veproi siç iu tha. Futi dorën në gjoks. Kur e nxori, ishte e bardhë dhe e shndritshme si një hënë e plotë. Po sapo vuri dorën mbi zemër, u qetësua plotësisht, nuk i mbeti më asnjë gjurmë frike. Me t'u qetësuar, Zoti i tha të shkonte te Faraoni dhe ta ftonte atë për të besuar Zotin. Gjatë këtij misioni ai asnjëherë nuk do përdorte forcën fizike, por forcën e fjalës e të argumentit. Ai do t'i provonte Faraonit dhe njerëzve të tij se kush ishte Zoti i vërtetë.

Musai iu lut Zotit që ta ngarkonte edhe Harunin, vëllanë e tij me misionin e profetit. Haruni ishte një orator shumë i mirë, e kështu do ishte më e thjeshtë përballja me Faraonin. Zoti e pranoi lutjen e Musasë.

Ato momente Haruni ndodhej në Egjipt. Një melek i

posaçëm e vizitoi dhe i dha sihariqin që ishte zgjedhur si profet. Kjo detyrë sa e zorshme, aq edhe e nderuar, e emocionoi shumë Harunin. Në fakt, do ta kishin punën pak pisk, se nuk ishte e lehtë të përballeshe me perandorin më të madh të kohës, aq më shumë që ai e konsideronte veten perëndi. Por Zoti i kishte mbushur me qetësi e me besim zemrat e tyre.

Musai u kthye pranë familjes së vet.

Së bashku me të vëllanë, Harunin, Musai *(Paqja qoftë mbi të!)* shkoi te pallati i Faraonit. Ky ishte një urdhër i Zotit dhe profetët do t'i bindeshin pa diskutim. Kur Faraoni e njohu Musanë, që qëndronte përballë tij, u shastis. Menjëherë desh të urdhëronte ta varnin, por kureshtja nuk e la. Më mirë ta përdorte dhe për interesat e veta.

Faraoni e pyeti: "Kush është ky Zoti, o Musa?"

- "Zoti i qiellit dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që ekziston ndërmjet tyre. Ai, të cilit unë të ftoj t'i besosh."

Faraoni pa ata që kishte përreth dhe nënqeshi me tallje.

"E dëgjoni ç'thotë ky?"

Musai vazhdoi fjalën. Ato që po thoshte patën një ndikim rrufeje në sallon.

"Po, Faraon. Ai është Zoti im, Zoti yt dhe Zoti i të parëve tanë."

"Po ky qenka i çmendur! Ju paska rënë për pjesë një profet i çmendur!"

Musai nuk u nervozua. Zoti e kishte porositur të sillej pa nervozizëm.

"Po të mendosh, do e kuptosh se Ai është Zoti i lindjes dhe i perëndimit. Zoti i gjithçkaje!"

Ideja e Faraonit për ta mundur me fjalë Musain, nuk po i jepte rezultat. Ai ishte shumë i zgjuar. Më mirë të merrej me gjendjen e tij.

"Shiheni këtë varfanjak! Pse, Zotin e tij do besoj unë? Unë që jam kaq i pasur! Që jam zot vetë?!"

"Zoti i vërtetë është Zoti i botëve, Ai që ka krijuar gjithçka nga hiçi. Ai që ka në dorë jetën dhe vdekjen. Të ftoj të besosh, o Faraon!"

"Po të adhurosh dikë tjetër veç meje, do të të ndryj në qeli, do të të lë të kalbesh atje!"

Musai buzëqeshi.

"Po sikur të të tregoj një mrekulli?"

"Vërtet? Po na tregove ndonjë mrekulli nga Zoti yt, do të të besoj çfarë thua."

Musai i tregoi mrekullitë me bastunin dhe me dorën, që futi në gjoks.

Faraoni sikur ishte gurëzuar. Frika e kishte mpirë… Pa kaluar shumë kohë, ngjarja mori dhenë.

# FJALOR KUR'ANOR

## Ringjallja *(El Ba'thu)*

Allahu i Madhëruar thotë: **"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne?"[1]** Dhe: **"Allahu e fillon krijimin e pastaj e përsërit dhe pastaj tek Ai do të ktheheni."[2]**

Të gjithë të dërguarit dhe të gjithë librat e Allahut thonë se jeta e njeriut nuk përfundon me vdekjen. Pas kësaj jete botësore ka Jetë Tjetër. Jeta Tjetër është e vërtetë. Në Jetën Tjetër njeriu do të shohë rezultatin e veprave të tij. Sipas veprave që ka bërë, ose do të shpërblehet me Xhenet ose do të ndëshkohet me zjarrin e Xhehenemit.

Ringjallja përmendet në Kur'anin e Shenjtë në më shumë se 1200 ajete të tij[3]. Në Kur'an ka shembuj, shembullsime dhe tregime të ndryshme që tregojnë se Ringjallja është e patjetërsueshme. Islami është fe racionale. Logjika e shëndoshë e konsideron Ringjalljen të domosdoshme. Edhe zbulimet shkencore e vërtetojnë Ringjalljen[4]. Besimi në Ringjalljen është prej parimeve dhe shtyllave të besimit islam. Ai që e mohon

1 Sure "Mu'minun", ajeti 115.

2 Sure "Rrum", ajeti 11.

3 Shih *Tregues i Kur'anit,* H. Shehu (vepër për shtyp, pronë letrare e Fondacionit të Kur'anit).

4 Shih: *Neurokirurgu nga Harvardi konfirmon ekzistencën e jetës pas vdekjes*, në "Java Neës", 25/5/2015 dhe: *Studimi më i madh shkencor konfirmon se pas vdekjes ka jetë*, gazeta "Shekulli", 08/10/2014.

këtë parim është i dalë nga feja.

Gjuhësisht, fjala "*el ba'thu*" (Ringjallje) përdoret kryesisht në dy kuptime - me kuptimin e "dërgimit" (*el irsalu*), i cili përmendet në shumë ajete të Kur'anit, si p.sh.,: **"...Ne dërguam Musanë..."**[5] dhe me kuptimin e "Ringjalljes" (*el ihjau*) pas vdekjes, siç thotë Allahu i Madhëruar: **"...S'ka dyshim dhe se Allahu do t'i ringjallë ata që janë në varre."**[6]

Në terminologjinë fetare, fjala «*el ba'thu*", është "ringjallje e të vdekurve dhe nxjerrja e tyre nga varret, për të dhënë llogari për punët dhe veprat e tyre që kanë bërë në këtë jetë".

## Emrat e Ditës së Ringjalljes në Kur'an

Në Kur'an Ringjallja përmendet me emra të ndryshëm. Secili prej emrave përfaqëson një karakteristikë të caktuar. Ata janë: Dita e Kiametit *(Jeumul Kijame),* Dita e Gjykimit *(Jeumud Dijn),* Dita e Fundit *(Jeumul Akhir),* Dita Madhështore *(Jeumun Adhijm),* Dita e Madhe *(Jeumun Kebijr),* Dita Gjithpërfshirëse *(Jeumun Muhijt),* Dita e Dëshpërimit *(Jeumul Hasreti),* Dita e kohës së caktuar *(Jeumul Uaktil Ma'lum),* Dita e Vërtetë *(Jeumul Hakk),* Dita e Ringjalljes *(Jeumul Ba'th),* Dita e Ndarjes *(Jeumul Fasl),* Dita e Llogarisë *(Jeumul Hisab)*, Dita e Takimit *(Jeumu Telakij),* Dita e Afërt *(Jeumul Azifeh),* Dita e Mjerimit *(Jeumu Tenad),* Dita e Tubimit *(Jeumul Xhem'i),* Dita e premtuar për dënim *(Jeumul Uaijd),* Dita e Përjetshme *(Jeumul Khulud),* Dita e daljes nga varret *(Jeumul Khuruxh),* Dita e Vështirë *(Jeumun Asijr),* Dita e fitmit dhe e humbjes *(Jeumun Tegabun),* Dita e Premtuar *(Jeumul Meuud),* Dita e Vrenjtur *(Jeumen Abusen),* Dita e Njohur *(Jeumun Ma'lum),* Dita për të cilën nuk ka dyshim *(Jeumun la rejbe fijhi),* Dita e Triumfit *(Jeumul Fet'h).*

5 Sure "A'raf", ajeti 103.

6 Sure "Haxh", ajeti 7.

Dita e Ringjalljes fillon kur t'i fryhet Surit. Kjo është shenja e shkatërrimit të përgjithshëm të botës dhe të tërë gjithësisë. Ky është zëri që shpall se jeta e kësaj bote ka marrë fund për të gjithë dhe se jeta e vërtetë ka filluar. Ky është zëri fillestar që do të ngjallë një frikë dhe huti të vazhdueshme në zemrat e jobesimtarëve. Fillojnë ditët e vështira për jobesimtarët. Këtë vështirësi të tyre e përmend edhe Kur'ani në suren "Mudethir", ajetet 8-10: **"Kur t'i fryhet Surit, do të jetë një ditë e rëndë. Për jobesimtarët nuk do të jetë aspak e lehtë."** Një dridhje e tmerrshme dhe një zë shurdhues pason Surin. Në këtë moment, njerëzit kuptojnë se po përballen me një katastrofë të tmerrshme. Bota dhe jeta janë gati të shuhen. Për pak çaste gjithçka në Tokë e humb vlerën e vet. Frika është e madhe dhe çdokush është i preokupuar vetëm me vetveten. Të gjitha lidhjet do të shkëputen. Për këtë në Kur'an thuhet: **"Por, kur të vijë Ushtima, atë Ditë, njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë."**[7] Pas dridhjes së fuqishme, toka do të nxjerrë gjithçka që mban brenda saj. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani: **"Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj** (të fundit)**, kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj."**[8]

Njerëzit, kafshët dhe natyra - të gjitha shkatërrohen. Malet nuk janë madhështore. Oqeanet nuk janë të pafund. Qiejt nuk janë aq të paarritshëm si në të kaluarën. Dielli, yjet dhe e tërë gjithësia janë të mbërthyera nga frika e Ditës së Ringjalljes. Ato të gjitha i nënshtrohen Krijuesit të tyre. Në Kur'an thuhet: **"Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjyesit Allah."**[9]

7 Sure "Abese", ajetet 33-37.
8 Sure "Zelzele", ajetet 1-2.
9 Sure "Ibrahim", ajeti 48.

Ky është momenti kur njerëzit do të ringjallen, do të tubohen dhe do të presin për të dhënë llogari për veprat e tyre që kanë bërë në këtë jetë. Këtu do të mësojnë se ku do të shkojnë. Atëherë do t'i fryhet Surit për herë të dytë dhe njerëzit ringjallen. Kur'ani i Shenjtë na e përshkruan mrekullueshëm ringjalljen dhe daljen e njerëzve nga varret në ajete e sure të ndryshme:

**"…Pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin."**[10] **"Me sy të përulur do të dalin nga varret, sikur të ishin karkaleca të shpërndarë."**[11]

**"…Pastaj, kur t'ju thërrasë Ai, me një të thirrur, ju përnjëherë do të dilni nga toka** (të ringjallur).**"**[12] **"Atë Ditë, toka do të hapet e ata do të dalin me nxitim. Për Ne është e lehtë t'i mbledhim ata të gjithë."**[13] **"Dhe, kur t'i fryhet Surit, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: 'Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?'"** (Do t'u thuhet): **'Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit kanë thënë të vërtetën!' Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh."**[14]

Këto ajete e të tjera, të ngjashme me to dëshmojnë dhe vërtetojnë se Ringjallja është e patjetërsueshme dhe të gjithë njerëzit do të ringjallen për të dhënë llogari për veprat e tyre. Kohën e Ringjalljes e di vetëm Allahu i Gjithëditur dhe Fuqiplotë.

10 Sure "Zumer", ajeti 68.
11 Sure "Kamer", ajeti 7.
12 Sure "Rrum", ajeti 25.
13 Sure "Kaf", ajeti 44.
14 Sure "Jasin", ajetet 51 – 53.

## Ringjallja do të jetë me trup dhe me shpirt

Ringjallja nuk do të jetë krijim i ri. Jo se kjo është e pamundur, sepse për Allahun asgjë nuk është e pamundur, por se Allahu dëshiron që të ndodhë ringjallja e po atij trupi që ka qenë në jetën e kësaj bote. Sipas Kur'anit të Shenjtë, njerëzit do të ringjallen me shpirt dhe me trup. Këtë e dëshmojnë shumë ajete. Prej tyre përmendim: **"Sot Ne do t'ua vulosim atyre gojët e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë."**[15] Dhe: **"Ata që s'besojnë në shenjat Tona, Ne pa dyshim, do t'i djegim në zjarr. Sapo t'u digjet lëkura, Ne do t'ua ndërrojmë atë me lëkurë tjetër, për të përjetuar dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë."**[16]

## Shembullsimet kur'anore për Ringjalljen

Allahu i Gjithëditur thotë se Kur'ani është sqarues i gjithçkaje: **"…Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje…"**[17] Allahu thotë se Kur'ani është i lehtë për t'u kuptuar: **"Vërtet, Ne e kemi bërë Kur'anin të lehtë për t'u kuptuar…"**[18] Sekreti i lehtësisë së Kur'anit për t'u kuptuar është se çështjet që kanë lidhje me të padukshem, veçanërisht me Ringjalljen e me Jetën e Përtejme, Allahu i Madhëruar i shembullson me çfarë sheh njeriu çdo ditë në jetën e tij. Kur flet për Xhenetin, Allahu e përshkruan si një vend të bukur, të gjelbër, ku rrjedhin lumenj të kthjellët: **"Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra**

15 Sure "Jasin", ajeti 65.
16 Sure "Nisa", ajeti 56.
17 Sure "Nahl", ajeti 89.
18 Sure "Kamer", ajeti 22.

**të mira, Ne do t'i çojmë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë."**[19]

Kur flet për banorët e zjarrit, Allahu thotë: **"Dhe atë Ditë, do t'i shohësh keqbërësit të lidhur në pranga; rrobat do t'i kenë prej katrani e zjarri do t'ua mbështjellë fytyrat."**[20]

Dhe: **"Pema e Zekumit do të jetë ushqim i gjynahqarit. Si tunxh i shkrirë ajo do të vlojë në barkun e tij, ashtu siç vlon uji i nxehtë."**[21]

Edhe për Ringjalljen Allahu ka dhënë shembullsime në Kur'anin e Shenjtë. Ndër to përmendim:

**"O njerëz, nëse ju dyshoni në Ringjalljen, mendoni si Ne ju kemi krijuar prej dheut, pastaj prej pikës së farës, pastaj prej droçkave të gjakut, pastaj prej një cope mishi me trajtë të plotë ose jo të plotë, për t'jua bërë të qartë! Dhe Ne e mbajmë në mitër atë që duam deri në kohën e caktuar. Pastaj ju nxjerrim si fëmijë e pas kësaj do të arrini moshën e pjekurisë. Disa nga ju vdesin e disa ngelin deri në pleqëri të thellë, që të mos dinë asgjë nga ajo që kanë ditur më parë. Dhe ti e sheh tokën të tharë, por, kur Ne lëshojmë ujë mbi të, ajo trazohet dhe gufon dhe prej saj mbijnë gjithfarë lloj bimësh të mrekullueshme në çift."**[22]

**"Ndër shenjat e Tij është edhe ringjallja e tokës. Ti e sheh tokën të thatë e të shkretë, por, kur zbresim shi mbi të, ajo lëviz dhe gjallërohet. Pa dyshim, Ai që e ngjall atë, i ngjall edhe të vdekurit. Ai është, vërtet i Pushtetshëm për çdo gjë."**[23]

**"Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurme**

19 Sure "Nisa", ajeti 57.
20 Sure "Ibrahim", ajetet 49–50.
21 Sure "Dukhan", ajetet 43-46.
22 Sure "Haxh", ajeti 5.
23 Sure "Fusilet", ajeti 39.

**të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën, si ushqim për robtë Tanë. Në këtë mënyrë, Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe ringjallja."**[24]
Allahu i shembullson vdekjen dhe Ringjalljen me gjumin dhe zgjimin, kur thotë: **"Ai jua merr shpirtrat** (ju vë në gjumë) **natën, duke e ditur ç'keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t'ju tregojë gjithçka që keni bërë."**[25]

Për ta sqaruar më mirë çështjen e Ringjalljes Allahu përmend në Kur'an edhe disa histori. Ja disa nga ato:

## 1- Historia e Uzejrit *(Paqja qoftë mbi të!)*

Kur'ani thotë se Allahu e vdiq Uzejrin *(Paqja qoftë mbi të!)* për njëqind vjet e pastaj e ringjalli atë.: **"Po për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha: 'Si mund ta kthejë tani në jetë Allahu këtë qytet, që ai është i vdekur?!' Dhe Allahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti: 'Sa kohë ke ndenjur këtu?' - Ai u përgjigj: 'Një ditë ose gjysmë dite'. – 'Jo' - i tha Allahu, - 'por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd** (si do ta ringjallim), **që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit! Vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!' Kur atij iu bë e qartë, ai tha: 'Tashmë e di se Allahu është i Fuqishëm për gjithçka.'"**[26]

24 Sure "Kaf", ajetet 9-11.
25 Sure "En'am", ajeti 60.
26 Sure "Bekare", ajeti 259.

## 2- Historia e banorëve të shpellës

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Vallë, a mendon ti se banorët e Shpellës[27] dhe të Rakimit[28] ishin një çudi nga mrekullitë Tona? Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë "O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!", Ne ua mbyllëm veshët atyre** (duke i lënë të flinin) **në shpellë për shumë vjet. Pastaj i ngritëm, për të marrë vesh se cili nga të dyja grupet do ta vlerësonte më mirë sa kohë kishin qenë të strehuar. Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcuam në rrugën e drejtë. Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: "Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe. Ky populli ynë ka zgjedhur në vend të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtra për Allahun? Kur ju t'i lini ata dhe gjithçka që adhurojnë në vend të Allahut, gjeni strehë në shpellë: Zoti juaj do t'ju mbulojë me mëshirën e Tij dhe do t'ju përgatisë mënyrën, nga e cila do të keni dobi". Ti** (o Muhamed) **do**

27 Banorët e Shpellës ishin disa të rinj monoteistë, të arratisur nga qyteti i tyre, për t'i shpëtuar persekutimit të një tirani pagan, që donte t'i detyronte të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Për të ruajtur pastërtinë e këtij besimi, ata u strehuan në një shpellë jashtë qytetit dhe iu dorëzuan mëshirës hyjnore. Allahu i Madhëruar i bëri të flenë për treqind vjet dhe i zgjoi, kur gjendja në qytet kishte ndryshuar: banorët e tij ishin bërë monoteistë dhe qyteti qeverisej nga një mbret i urtë e i devotshëm. Ringjalljen e tyre Allahu e bëri mrekulli për banorët e qytetit (dhe për tërë njerëzimin) që vërtetonte ringjalljen e plotë, ngaqë ata ishin ndarë në dy grupe: njëri grup thoshte se ishte veç shpirti ai që ringjallej, kurse grupi tjetër thoshte se ringjallej edhe trupi.

28 *Rakim* mund të jetë emri i një lumi që kalonte pranë Shpellës ose një tabelë në hyrje të Shpellës me emrat e banorëve të saj, ose emri i qenit të tyre.

**ta kishe parë Diellin kur lindte se si anohej nga e djathta e Shpellës së tyre dhe, kur perëndonte, i linte ata në anën e majtë, ndërkohë që ata gjendeshin në mesin saj. Kjo është nga shenjat e Allahut. Sa për atë, që Allahu e udhëzon në rrugë të drejtë, pikërisht ai është i udhëzuari. E sa për atë, që Ai e lë në humbje, ti, me siguri, nuk do të mund t'i gjesh mbrojtës që ta udhëzojë. Dhe** (po të kishe qenë atje), **do të mendoje se ata ishin zgjuar, por ata ishin në gjumë. Ne i rrotullonim ata herë në krah të djathtë e herë në krah të majtë, kurse qeni i tyre rrinte shtrirë me dy këmbët e para në hyrje të shpellës. Sikur t'i kishe parë, ti do të ikje nga ata dhe do të të kaplonte frika. Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesnin njëri-tjetrin. Njëri nga ata tha: "Sa keni ndenjur** (në gjumë?)**" - U përgjigjën: "Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës". Disa thanë: "Zoti juaj e di më mirë se sa keni ndenjur. Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër! Le t'ju sjellë diçka prej tij, le të sillet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju! Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t'ju gjuajnë me gurë ose do t'ju kthejnë** (me forcë) **në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kurrsesi." Dhe kështu, Ne bëmë që ata të zbuloheshin, me qëllim që të dihej se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe, që të mos ketë asnjë dyshim për Orën** (e Kiametit se ajo do të vijë). **Kur ata** (banorët e qytetit) **po haheshin me njëri-tjetrin për këtë rast, disa thoshin: "Ndërtojuni atyre** (në hyrje të shpellës) **një ndërtesë! Zoti i tyre i njeh më mirë ata". Ata që e fituan çështjen e tyre, thanë: "Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta!" Do të thonë: "Ata ishin tre veta e qeni i tyre ishte i katërti". Disa do të thonë: "Ata ishin pesë veta e qeni i tyre ishte i gjashti", duke hamendësuar për atë që është e fshehtë; kurse të tjerë do të thonë: "Ata ishin shtatë veta e**

**qeni i tyre ishte i teti". Thuaj** (o Muhamed)**: "Zoti im e di më mirë numrin e tyre. Vetëm pak veta dinë diçka rreth tyre". Dhe mos polemizo rreth tyre, përveçse në mënyrë të përciptë dhe për ata mos pyet askënd! Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se "Me siguri që nesër do ta bëj këtë", pa shtuar "Në dashtë Allahu!" Dhe, kur të harrosh** (të thuash "në dashtë Allahu") **- kujtoje Zotin tënd e thuaj: "Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo". Ata qëndruan në shpellën e tyre treqind vjet** (diellorë)**, duke shtuar nëntë** (për vitet hënore)**. Thuaj** (o Muhamed)**: "Allahu e di më mirë sa kanë qëndruar. Atij i përket fshehtësia e qiejve dhe e Tokës. Eh, sa mirë sheh Ai çdo gjë dhe sa mirë që dëgjon! Njerëzit nuk kanë tjetër mbrojtës përveç Atij dhe Ai nuk e ndan me askënd pushtetin e Vet."**[29]

## 3- Historia e ringjalljes së shpendëve të Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)*

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Kur ibrahimi tha 'O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!', Zoti i tha: 'A nuk beson?' – 'Besoj' - iu përgjigj Ibrahimi, - 'por dëshiroj të më qetësohet zemra.' Allahu i tha 'Merr katër zogj dhe copëtoji! Shpërndaj në çdo kodër nga një copë prej tyre, pastaj thirri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.'"**[30]

**Vullnet Merja**

29 Sure "Kehf", ajetet 9-26.
30 Sure "Bekare", ajeti 260.

# 15 VJET NË SHËRBIM TË KUR'ANIT

Falënderimi është vetëm për Allahun e Madhëruar, i Cili është Zoti Një dhe i Vetëm. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi profetin Muhamed, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasuan, e pasojnë dhe do ta pasojnë deri në Ditën e Kiametit!

Fondacioni i Kur'anit u themelua në vitin 2000. 15 vjet më parë ky fondacion nisi misionin e tij me moton "Fondacioni i Kur'anit, në shërbim të Kur'anit". Qenë përpjeket e shumta të shumë personave që të arrihej ky qëllim madhor. Sot, Fondacioni i Kur'anit luan një rol të rëndësishëm në përhapjen e Fjalës së Allahut të Lartësuar në vendin tonë. Është kënaqësi dhe detyrim njëkohësisht, t'u shprehim mirënjohjen tonë të thellë të gjithë atyre që hodhën themelet e këtij institucioni, që tashmë njihet fare mirë në Shqipëri për punën dhe shërbimin që i ofron besimtarit mysliman shqiptar. Një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij Fondacioni kanë luajtur drejtuesit e tij, që me punën e tyre të palodhur hapën dyert për këdo që shprehte dëshirën për t'u njohur me Librin epokëbërës, Kur'anin e Shenjtë. Ishte drejtori i parë i këtij Fondacioni z. Zijai, që nisi punën e tij për t'i shërbyer Kur'anit me mbështetjen e pakursyer të kolegut të tij z. Ahmed Abol Ghasemi, një mjeshtri të rrallë në këndimin, leximin dhe mësimdhënien e Kur'anit Kerim. Z. Ahmed Abol Ghasemi është fituesi i çmimit të parë në rang botëror në këndimin e Kur'anit. Ndërkohë që po përpiqemi t'ju njohim edhe ju lexues të nderuar me punën dhe aktivitetin e Fondacionit të Kur'anit në Shqipëri, na vjen në mendje çasti

i parë i takimit me profesor Ahmed Abol Ghasemin, i cili e nisi prezantimin e tij me këndimin e disa ajeteve të Kur'anit, ku besojmë se jo vetëm ne, por të gjithë të pranishmit filluan të rrënqetheshin nga zëri melodioz i tij. Dëshirojmë të flasim pak më shumë për këtë njeri, pasi ai është themeluesi dhe njeriu që i dha shumë këtij Fondacioni. Ju ndoshta nuk e keni patur fatin ta takoni apo të merrni pjesë në orën e mësimit të tij, por jemi të bindur se shumë prej jush kanë dëgjuar për të, pasi regjistrimi i shumë CD-ve apo kasetave me këndim Kur'ani me zërin e tij, janë shpërndarë pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Njëkohësisht, z. Abol Ghasemi ka qenë edhe drejtor i Fondacionit. Për një periudhë të shkurtër kohore, drejtimin e Fondacionit e mori z. Sadrai, i cili në atë kohë ishte me detyrën e përfaqësuesit të përgjithëm të disa fondacioneve kur'anore në Ballkan. Këto fondacione ishin dhe janë në varësi të qendrës kryesore, që në atë kohë mbante emrin "Qendra 'Al Mustafa'" dhe më vonë kjo qendër u kthye në universitet. Tashmë, njihet me emrin universiteti "Al Mustafa", me seli në Kum të Iranit. Z. Sadrai ka meritat e tij në ecjen përpara të punës në këtë institucion. Tashmë Fondacioni sa vinte e rritej me aktivitetin e tij dhe një tjetër këndues e lexues i njohur i Kur'anit mori drejtimin e tij. Drejtor i Fondacionit u emërua z. Hossein Asadi. Ishte pikërisht çasti i duhur për një lexues, këndues dhe njohës kaq të denjë të Kur'anit, sa z. Hossein Asadi, që ky institucion të bëhej kaq i suksesshëm në punën e tij. Puna e palodhur e drejtuesve të Fondacionit, gjithnjë në bashkëpunim me stafin e tij, hapi një dritare të re në mesin e besimtarëve myslimanë në vendin tonë. Bashkëpunimi me institucione shtetërore, fetare e kulturore në Shqipëri ka qenë i frytshëm. Falë bashkëpunimit me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, Fondacioni ndërmori hapa madhorë në përhapjen e Fjalës së Allahut: duke hapur klasa për mësimin e leximit të Kur'anit; duke botuar libra, gazeta, revista, e shkrime në

disa gazeta ditore në raste festash; duke zhvilluar programe radiofonike dhe televizive; duke mbajtur simpoziume, seminare; duke zhvilluar kurse trajnimesh, si: kurse kompjuteri, kurse gazetarie, kurse kualifikimi për mësimdhënien e Kur'anit, kurse të kërkimit shkencor për komentimin e Kur'anit etj. Për të gjitha këto, do t'ju njohim në këtë shkrim. Jemi të bindur se e gjithë kjo vjen falë mbështetjes në të Madhin Zot. Është, pa dyshim, Allahu që u jep sukses njerëzve. Kush beson në Allah dhe zbaton ato çka urdhëron Ai në Kur'an, suksesin e ka të sigurt. Falënderimi është vetëm për Allahun. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **"Vërtet, ky** *(Kur'ani)* **i udhëzon në atë që është më e drejtë."** Të mbështetesh te Kur'ani, do të thotë se je mbështetur tek Allahu. Mbështetja te Kur'ani i dha forcë dhe vullnet të pathyer Profetit tonë të dashur, Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për të përballuar të gjitha sfidat që i solli jeta. Pikërisht kështu e gjetën forcën, kurajën dhe vullnetin edhe drejtuesit e Fondacionit, për ta bërë atë një institucion të denjë për përhapjen e Mesazhit që solli i Dërguari i Zotit. Vitet kaluan dhe njëkohësisht edhe drejtuesit ia lanë radhën njëri-tjetrit për drejtimin e Fondacionit, duke ruajtur dhe çuar përpara misionin e tij. Pas z. Hossein Asadi, drejtor i Fondacionit të Kur'anit, emërohet dr. Mohammed Reza Aram, i cili, para se të vinte në Shqipëri, mbante postin e zëvendësministrit të Arsimit në Iran. Dr. Arami qe një tjetër mundësi e mirë për ngritjen e nivelit të punës së Fondacionit. Sikurse e thamë edhe më lart, personat që mbanin postin e drejtorit, patën një afat të caktuar kohor, kështu që, një tjetër zë i njohur në fushën teologjike dhe atë kur'anore ishte z. Mohammed Reza Haxh Khezr, që u emërua drejtor i Fondacionit të Kur'anit. Edhe z. Haxh Khezr nuk reshti së punuari për ta çuar më tej mesazhin që përcollën pararendësit e tij. Pas z. Haxh Khezr, drejtimin e Fondacionit për një periudhë kohore jo shumë të gjatë, e mbikëqyri dr.

Golizadeh, i cili është përfaqësuesi i përgjithshëm i universitetit "Al Mustafa" në Shqipëri. Të gjithë këta drejtues kanë bërë një punë të shkëlqyer në mbarëvajtjen e Fondacionit. Aktualisht, postin e drejtorit të Fondacionit të Kur'anit e mban z. Vullnet Merja. Z. Merja, për një periudhë të gjatë kohore, ka mbajtur postin e nëndrejtorit të këtij Fondacioni. Falë përpjekjes, mundit dhe sakrificës së të gjithë atyre që kanë punuar, kanë bashkëpunuar, punojnë dhe bashkëpunojnë me Fondacionin e Kur'anit, ai ka arritur deri këtu ku është sot. Ai tashmë, është bërë mik i pandashëm i një pjese të mirë të shoqërisë shqiptare. Lexues të nderuar! Më lart ju njohëm shkurt me punën, programet dhe aktivitetin që ka kryer deri më tani ky Fondacion. Tani po ju njohim më në brendësi.

## Njohje me veprimtarinë e Fondacionit

*** Departamenti i arsimit kur'anor**
*** Departamenti i studimeve dhe i kërkimeve kur'anore**
*** Departamenti i propagandës së Kur'anit**

*Departamenti i arsimit është i ndarë në dy degë:*
**a) Arsimi i përgjithshëm**, i cili përfshin klasat për mësimin e Kur'anit.
Nga koha e themelimit e deri tani, në mësimin e Kur'anit ka pasur një pjesëmarrje të gjerë nga grupmosha të ndryshme, në qytete e fshatra të ndryshëm të Shqipërisë. Numërojmë mbi 7200 nxënës Kur'ani.
**Arsimi i përgjithshëm** bazohet në këto lëndë:
- *"Albumi i Mësimit të Kur'anit Kerim."* Në këtë libër ka gjithsej 19 tema mësimi.
- *"Përpikëria e leximit të Kur'anit"* (Metodë e re në paraqitjen e rregullave të texhuidit).
- *"Komentimi i sures 'Llukman'* dhe *"Burime rrezatuese"*

(*"Komentimi i sures 'Huxhurat'"*).
- Njohuri të përgjithshme kur'anore.
- Mësimi përmendsh i Kur'anit.

**a- Arsimi profesional**

- Kurs kualifikimi për mësuesit e Kur'anit. Deri më tani janë zhvilluar pesë kurse. Numri i pjesëmarrësve në këto kurse kualifikimi ka arritur në 145 persona, ku 90 prej tyre janë pajisur me dëshmi të lëshuara nga Fondacioni i Kur'anit në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.
- Kurs gazetarie në bashkëpunim me Radio "Kontakt".
- Kurs për kërkime shkencore kur'anore në bashkëpunim me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë.
- Kurse kompjuteri për mësuesit dhe nxënësit më të mirë të klasave etj.

**Departamenti i kërkimeve dhe i studimeve kur'anore përmban:**

- Bibliotekë me literaturë për studimet e fesë islame në përgjithësi dhe të Kur'anit në veçanti.
- Literatura është në gjuhë të ndryshme, si: arabisht, persisht, anglisht, frëngjisht, turqisht, italisht, shqip. Numri i librave në këtë bibliotekë është mbi 2200 copë. Në këtë bibliotekë ka edhe CD të ndryshme islame dhe kur'anore në gjuhë të ndryshme.
- Literatura në gjuhën shqipe të botuara nga Fondacioni. Numërojmë 31 titujt librash të botuar nga Fondacioni deri më tani. Ndër to, përmendim: *"Albumi i mësimit të Kur'anit"*, *"Metoda e hifzit të Kur'anit"*, *"Përpikëria e leximit të Kur'anit (Metoda e re e rregullave të texhuidit)"*, *"Burime rrezatuese (Komentimi i sures "Huxhurat")"*, *"Komentimi i sures 'Llukman'"*, *"Njeriu në Kur'an"*, *"Çelësat e kuptimit të Kur'anit"*, *"1000 tema, 1000 ajete"*, *"Muhamedi, i Dërguari i Allahut"*, *"Kur'ani i Shenjtë dhe shkencat e*

*natyrës", "Njohje me suret e Kur'anit"* dhe libra të tjerë me tematikë kur'anore, të cilat do t'i gjeni në faqen tonë të internetit.

- Ringjallja e trashëgimisë kur'anore në Shqipëri me ribotimin e disa veprave madhore. Janë botuar librat: *"Ajka e kuptimeve të Kur'ani Kerijmit"* e patriotit, komentuesit, teologut shqiptar, Hafiz Ibrahim Dalliu; *"A ka dyshim në qenien e Zotit?"* e patriotit, filozofit, teologut, Hafiz Ismet Dibra dhe *"303 fjalët e imam Aliut"* e patriotit, komentuesit, teologut, Hafiz Ali Korça.

**Departamenti i predikimit të Kur'anit**

- Shpërblimi për mësimin përmendsh të sureve "Jasin", "Vakia" dhe të xhuzit 30 për të gjithë dashamirësit e Kur'ani Famëlartë.
- Botimi i revistës "KËSHILLA" dhe i revistës "SELAM". (Më parë revista "Këshilla" ka qenë botuar në format gazete me 28 numra.)
- Botimi i revistës kur'anore – shkencore "DRITA E KUR'ANIT".

- Botimi i artikujve në gazetat e shtypit të përditshëm, në raste të veçanta, siç janë: festat e Bajramit, ditëlindja e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ditëlindja e Profetit Isa *(Paqja e Allahut qoftë mbi të!)* etj.
- Përgatitje kasetash dhe CD me lexim a këndim të Kur'anit në gjuhën arabe dhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe.
- Përgatitje kasetash dhe CD me ilahi dhe lutje në gjuhën arabe dhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe. Regjistrimi i CD dhe i kasetave me sure të ndryshme në këndimin e Kur'anit dhe ilahive deri tani është 30 copë. Numri i shumëfishimit të tyre ka arritur deri në 55.000.
- Organizimi i konkurseve dhe olimpiadave kombëtare kur'anore të moshave të ndryshme e në degë të ndryshme, si: hifzi, leximi, këndimi dhe komentimi i Kur'anit, ezani, mësimi

përmendsh i haditheve, kaligrafi, punime artistike etj. Janë organizuar gjithsej 11 takime të tilla dhe numri i pjesëmarrësve ka arritur në 7.180 konkurues.

- Organizimi i seminareve, simpoziumeve e sesioneve të ndryshme shkencore. Janë organizuar gjithsej 18 takime të tilla.
- Transmetimi i emisioneve radiofonike në radio "Nacional", 93.6 Mhz.

Janë dy emisione: "Flladi i mëshirës" dhe "Nektari i xhumasë". Emisioni "Flladi i mëshirës" transmetohet çdo ditë gjatë muajit të begatë të Ramazanit dy orë para iftarit. Ky emsion ka filluar transmetimin e tij në vitin 2004. Numërojmë rreth 360 tema të përcjellura gjatë këtij emisioni. Sigurisht, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe shumë rubrika të tjera plotësuese të këtij emisioni. Ato janë përzgjedhur me shumë kujdes për të zgjuar interesin e dëgjuesve.

Emisioni "Nektari i xhumasë" ka filluar transmetimin e tij në nëntor të vitit 2005. Nga vetë emri që mban ky emision, kuptohet se ai trasmetohet çdo ditë të xhuma, nga ora 9:00 -10:30 minuta. Emisioni "Nektari i xhumasë" është në vitin e 11-të të transmetimit të tij dhe numëron rreth 537 tema të përcjellura. Gjithashtu, në këtë emision janë përcjellur edhe mjaft rubrika të tjera që e kanë bërë edhe më të larmishëm për dëgjuesin. Shpresojmë që t'ia kemi arritu qëllimit. Nuk mund të lëmë pa kujtuar kohën kur në këtë frekuencë transmetohej ezani në pesë kohët e tij (Bëhet fjalë për vitet 2001-2002).

- Bashkëpunimi me radio "Kontakt". Emisioni i Ramazanit "Flladi i mëshirës", në vitin 2007 u transmetua në frekuencën 89.3 MHz, të radio "Kontaktit". Gjatë këtij emisioni u zhvillua një pyetësor, nga i cili u përzgjodhën një numër i caktuar fituesish. Ky emision u mbyll me një aktivitet të zhvilluar në ambientet e radio "Kontakt", falë bashkëpunit të Fondacionit me radion.
- Programe të tjera radiofonike. Fondacioni i Kur'anit, në

bashkëpunim me radio "Nacional" kanë transmetuar programe radifonike të veçanta me rastin e festave si: Fiter Bajrami, Kurban Bajrami dhe ditëlinda e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*.

- Programe televizive. Me rastin e ditëlindjes së Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*, Fondacioni i Kur'anit, në bashkëpunim me TV 2000, transmetuan programin "Piedestali i moralit". Gjatë muajit të Ramazanit, në TV Shijak është transmetuar programi "Flladi i mëshirës".

